

Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik për P/KEDH në Shqipëri



Një Qasje e Bazuar
në Hulumtim



Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik për P/KEDH në Shqipëri: Një Qasje e Bazuar në Hulumtim

Autorë

Arjan DYRMISHI
Mandrit KAMOLLI
Mirsada HALLUNAJ
Anila SHEHI (DOLLANI)

Dizajni dhe Faqosja

Ergys TEMALI

© Shkurt 2021, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

Mirënjohje

Ky raport është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me mbështetjen e Hedayah, Qendrës Ndërkombëtare të Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, financuar nga Bashkimi Evropian. Raporti nuk do të ishte i njëjtë pa recensimin nga Charlie Einter, Irene Belmonte dhe Sara Zeiger.

Për dijeni

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve, dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e Hedayah, Bashkimit Evropian, apo të Qendrës së Koordinimit për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

KAPITULL I	
Përmbledhja dhe rekomandimet kryesore	1
KAPITULL II	
Hyrje	7
KAPITULL III	
Konceptet kryesore të përdorura në këtë studim	12
Përkufizimi i radikalizimit dhe nxitësit e tij	13
Përkufizimi dhe Kuptimi i Ekstremizmit të Dhunshëm	16
Lufta ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe propagandës së tij (P/KEDH)	18
KAPITULL IV	
Metodologjia	22
Mbledhja e të dhënave	25
KAPITULL V	
Radikalizimi në Shqipëri: nxitësit, shkalla e përhapjes dhe përpjekjet për ta luftuar atë	28
Feja në Shqipëri	29
Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi në Shqipëri	31
Nxitësit e radikalizimit në Shqipëri	33
KEDH në Shqipëri	38
Përpjekjet e riatdhesimit nga Qeveria e Shqipërisë	41
“Lufta e komunikimit” e ekstremizmit të dhunshëm	42
Prirjet e Radikalizimit në Bashkinë e Tiranës	44
Analiza PESTL	45
KAPITULL VI	
Analiza e Audiencës së Shënjestruar	51
Demografia	52
Besimet fetare	53
Përvoja dhe njohja e të anketuarve më ekstremizmin e dhunshëm	56
Aktorët që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm	61
Faktorët që ndikojnë te njerëzit për të përqafuar ekstremizmin e dhunshëm	77
Pozicionimi në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm	81
Sistemi i të kuptuarit si baza e radikalizimit	83
Tensionet fetare si nxitës potencialë të ekstremizmit	89
Qasjet për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm	98
Burimet e informacionit	103
Përdorimi i rrjeteve sociale	106
Aktorët e besueshëm dhe qasjet e komunikimit të mesazheve	111
Spektri i Audiencës në Shqipëri	115
Sistemi i të kuptuarit të Ekstremistëve të Dhunshëm në Shqipëri	119

KAPITULL VII

Kërcënimi nga EDH dhe nevojat e politikave KEDH në Shqipëri 126

Sfondi i koordinimit dhe komunikimit strategjik në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (SKLEDH)	127
Kanalet dhe Mjetet e Komunikimit	130
Koordinimi dhe kapacitetet	134

KAPITULL VIII

Përfundime 137

KAPITULL IX

Rekomandime 140

Për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit	141
Për dhënien e mesazheve dhe narrativave	141
Për përfshirjen e aktorëve kryesorë	142

Bibliografia 143

Shtojca 151

Shtojca 1 - Kampioni i sondazhit publik	151
Shtojca 2 - Pyetësi i sondazhit publik	152
Shtojca 3 - Shtrirja kohore e ngjarjeve dhe masave kryesore të ndërmarra në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri	167
Shtojca 4 - Pyetjet e intervistave	169
Shtojca 5 - Punonjësit e intervistuar nga institucionet publike	182
Shtojca 6 - Pjesëmarrësit e diskutimeve në grup	183

LISTA E SHKURTIMEVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
APKB	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
BIRN	Rrjeti i Raportimit Investigativ Ballkanik
BP	Ballkani Perëndimor
CETS	Seria e Traktatit të Këshillit të Evropës
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
CTED	Drejtoria Ekzekutive e Komitetit për Luftën ndaj Terrorizmit
CTITF	Task-Forca për Zbatimin e Luftës ndaj Terrorizmit
EDH	Ekstremizmi i Dhunshëm
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISIS	Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
KE	Komisioni Evropian
KEDH	Lufta kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
KMSH	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
LH	Luftëtar i Huaj
LHT	Luftëtar i Huaj Terrorist
LT	Luftimi i Terrorizmit
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
P/KEDH	Parandalimi dhe Lufta kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
QKEDH	Qendra e Koordinimit për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri
SKLEDH	Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

PARATHËNIE

Përhapja e propagandës ekstremiste është një ndër nxitësit kryesorë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. E vetëdijshme për këtë sfidë, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), si institucioni kryesor publik politik-bëres në nivel kombëtar, ka për mision të ruajë vlerat e bashkëjetesës dhe harmonisë fetare, duke mbrojtur shoqërinë shqiptare nga fenomene ekstremiste të dhunshme dhe duke zhvilluar kapacitetet e aktorëve të ndryshëm në kundërshtim të ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.

Institucioni ynë udhëheq dhe orienton përpjekjet e institucioneve shtetërore të nivelit qendror dhe vendor për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit, si dokumentet më të rëndësishme për t'u zbatuar në këtë drejtim.

Një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare është zhvillimi i Komunikimit Strategjik i cili ka për qëllim kundërshtimin e propagandës ekstremiste dhe promovimin e vlerave demokratike në shoqërinë tone. Në përgjigje të fenomenit në rritje të përhapjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes përdorimit të internetit në Shqipëri, institucioni ynë në bashkëpunim me institucione të linjës, po përmirëson kapacitetet e tij reaguese në internet, duke shtuar kështu përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të luftuar ndikimet e shumëllojshme që mund të çojnë në radikalizëm të mëtejshëm.

Ky studim, realizimi i të cilit nuk do ishte bërë i mundur pa mbështetjen e Qendrës CVE dhe partnerëve të kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë, mbetet një hap i parë në këtë drejtim, i cili mund të konsiderohet si një gur i fortë themeli në drejtim të mekanizmave mbrojtës që shteti dhe shoqëria shqiptare po ngrë, për të mbrojtur vlerat demokratike, shtetin e së drejtës dhe liritë dhe të drejtat themelore të individëve, në drejtim të parandalimit dhe kundërshtimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.



Lejdi DERVISHI

Drejtor

Kapitull I: Përmbledhja dhe rekomandimet kryesore



Ky studim analizon prirjet e fundit në lidhje me rolin e propagandës islamike në nxitjen e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në Shqipëri. Së pari, në këtë studim shqyrtohet EDH në Shqipëri me politikën dhe masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH). Më pas vijohet me një analizë më të thellë të rolit dhe ndikimit të propagandës si një nga faktorët kryesorë të radikalizimit. Qëllimi i studimit është të gjenerojë të dhëna kërkimore për të mbështetur përpjekjet e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (QKEDH) për zhvillimin dhe zbatimin e komunikimeve strategjike efektive në P/KEDH (strategjitë e komunikimit P/KEDH).

EDH është bërë një pjesë e rëndësishme e diskutimeve të politikave në Shqipëri gjatë viteve të fundit. Kjo çështje mori më shumë vëmendje gjatë viteve 2012-2014, kur disa qytetarë shqiptarë, shumë prej të cilëve bashkë me familjet e tyre, udhëtuan drejt Sirisë dhe Irakut për t'u bashkuar me Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS) dhe organizatat e tjera ekstremiste.

Një sërë studimesh, të nxitura kryesisht nga shfaqja e fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT), janë përqendruar në analizimin e faktorëve të radikalizimit dhe nxitësve në kontekstin shqiptar. Përfundimet e këtyre raporteve tregojnë kombinim faktorësh, që ndër të tjera përfshijnë formimin arsimor, kushtet ekonomike, përgatitjen fetare dhe ndikimin e huaj fetar, propagandën radikale dhe pamjaftueshmërinë e reagimit qeveritar, të cilët cilësohen si ndikues në radikalizimin e qytetarëve shqiptarë.

Për t'iu përgjigjur problemit të LHT-ve, qeveria shqiptare ndërmori një sërë hapash për të forcuar politikën dhe kuadrin e saj institucional duke themeluar QKEDH-në, si dhe duke miratuar Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (SKLEDH), e cila përfshin tre përparësi dhe dhjetë masa. Duke pranuar se përhapja e propagandës së EDH është një nga faktorët kryesorë të radikalizimit, një nga tre përparësitë e SKLEDH-së synon *luftimin e propagandës ekstremiste duke promovuar vlerat demokratike*, e cila përfshin përdorimin e veprimeve të komunikimit për të ndikuar në qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve ndaj EDH.

Ndërkohë që ka pasur progres në zbatimin e dy prej përparësive të SKLEDH-së, përkatësisht *Shtrirja dhe angazhimi i komunitetit dhe Hartimi i politikave afatgjata gjithëpërfshirëse KEDH*, janë hasur sfida në zbatimin e përparësisë për të luftuar propagandën ekstremiste.

Analiza paraprake e kryer nga QKEDH-ja dhe aktorët ndërkombëtarë tregoi se për zhvillimin e një strategjie komunikimi për të luftuar propagandën e EDH-së, nevojitet një analizë e thellë, që ndër të tjera, të kuptohen faktorët që e bëjnë këtë propagandë efektive, faktorët që promovojnë propagandën e EDH-së dhe faktorët që e bëjnë atë të rezonojë tek audiencat e ndryshme, qëndrimi i këtyre audiencave në lidhje me çështje të ndryshme që lidhen me fenë dhe shtetin, si dhe kanalet e informimit dhe komunikimit që përdoren për të përçuar mesazhet. Për më tepër, zhvillimi dhe zbatimi i strategjive efektive P/KEDH kërkon kapacitetet e duhura dhe praktika bashkëpunimi të mirëvendosura nga institucionet qeveritare dhe palët e përfshira.

Në këtë kontekst, ky studim u krye për të mbështetur QKEDH-në në përmirësimin e njohurive dhe ekspertizës së saj për të zhvilluar dhe dërguar mesazhe dhe narrativa që synojnë parandalimin dhe luftimin e propagandës së EDH-së, dhe për të siguruar në këtë mënyrë zbatimin e përparësisë përkatëse të SKLEDH-së. Studimi u krye në kuadrin e një projekti të mbështetur nga Hedayah, Qendra e Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, nën Programin Global STRIVE të financuar nga BE-ja. Huluntimi u hartua në mënyrë që të rritë kapacitetet kërkimore dhe të zhvillojë veprimet bashkëpunuese në lidhje me strategjitë P/KEDH të QKEDH-së, ministrive përkatëse dhe agjencive të përfshira në proceset e zbatimit të SKLEDH-së.

Metodat e përdorura për të mbledhur të dhënat parësore në këtë studim përfshijnë një sondazh me 800 banorë të Bashkisë së Tiranës, intervista me 26 zyrtarë të qeverisë dhe diskutime në grup me 95 individë ku përfshiheshin mësues, nxënës, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe zyrtarë të institucioneve qeveritare.

Studimi tregon se pavarësisht masave të marra për të luftuar EDH, veçanërisht që nga miratimi i SKLEDH-së pesë vjet më parë, EDH mbetet i pranishëm në Shqipëri. EDH duket se përbën një problem në të gjithë vendin, por është më i përhapur dhe më shqetësues në Bashkinë e Tiranës. Megjithatë, për shkak të mungesës së studimeve të mëparshme në këtë fushë, nuk është e mundur të përcaktohet nëse prirja e EDH ka qenë në rënie apo në rritje.

Gjetjet kryesore të këtij studimi përfshijnë:

- 68.8% e qytetarëve janë të mendimit se radikalizimi është një proces që vijon dhe grupet ekstremiste vazhdojnë të rekrutojnë njerëz. Në lidhje me personat që janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të radikalizimit, shumica e të anketuarve (71.1%) besojnë se të rinjtë e moshave 16-25 vjeç janë më të rrezikuar për t'u radikalizuar, ndërsa 18.5% besojnë se edhe të rriturit e moshave 26-45 vjeç janë gjithashtu të rrezikuar për t'u radikalizuar.
- Shumica dërrmuese e të anketuarve (71.4%) besojnë se rekrutuesit kanë më shumë gjasë ta kthejnë një individ në ekstremist të dhunshëm në zonat që jetojnë në varfëri, dhe 35.1% mendojnë se radikalizimi mund të ndodhë në objektet fetare të paautorizuara. Mjedise të tjera më pak të rrezikuara janë familja dhe rrethi miqësor (5.7%), interneti dhe rrjetet sociale (5.4%) si dhe mjediset arsimore (4.5%).
- Shumica dërrmuese e të anketuarve besojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë te njerëzit për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm përfshijnë kushtet e vështira ekonomike dhe mungesën e mundësive (84%), arsimimin e dobët (80%), korrupsionin dhe keqqeverisjen (72%), si dhe shtrembërimin dhe keqpërdorimin e besimeve (58%).
- Të anketuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit theksojnë se ambienti i burgjeve është i favorshëm për përhapjen e radikalizimit, jo vetëm për shkak të pranisë së personave të dënuar për ekstremizëm të dhunshëm, por edhe për shkak të reagimit të të burgosurve ndaj disa aspekteve të cilat lidhen me mungesën e perceptuar të drejtësisë,

keqmenaxhimin ose trajtimin e padenjë. Të anketuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit besojnë se edhe pse personeli i burgjeve është i trajnuar dhe i mirëinformuar për çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, të burgosurit ose nuk kanë fare ose pak informacion, i marrë nga televizioni, rreth kësaj teme.

- Të anketuarit besojnë se personat më të besueshëm për të përcjellë mesazhe kundër radikalizimit janë: (1) njerëzit që mund t'u drejtohen një audience të madhe (65%), (2) personalitetet kulturore (63%) dhe përfaqësuesit zyrtarë fetarë (57%). Vlen të përmendet fakti se personalitetet politike ose përfaqësuesit e shtetit kanë numrin më të ulët të përgjigjeve "jam dakord" (23%).
- 62.3% e të anketuarve mendojnë se monitorimi më i kujdesshëm i grupeve ekstremiste nga policia dhe shërbimet infomative do të zvogëlonte ndjeshëm kërcënimin nga ekstremizmi i dhunshëm.
- Mënyrat më të përshtatshme për dërgimin e mesazheve pozitive janë identifikuar: fushatat e ndërgjegjësimit (82% janë dakord ose plotësisht dakord), ligjëratat fetare (80% janë dakord ose plotësisht dakord), mediat sociale (58% janë dakord ose plotësisht dakord) dhe masmediat kryesore (50%) janë dakord ose plotësisht dakord).
- Shumica e të anketuarve besojnë se anëtarët e grupeve ekstremiste u afrohen njerëzve për të promovuar ideologjinë e tyre dhe për t'i bindur ata që t'i mbështesin. Për më tepër, të anketuarit janë të mendimit se ata që përpiqen të rekrutojnë njerëzit janë shqiptarë që jetojnë në Shqipëri.
- Për sa i përket përvojave personale, vetëm 2.1% e të anketuarve konfirmojnë se kanë pasur akses në materiale propagandistike që nxisin ekstremizmin, ndërsa 12.7% thonë se kjo u ka ndodhur miqve ose të afërmeve të tyre. Përqindja e të anketuarave femra që kanë pasur qasje në këto materiale është pak më e lartë se te meshkujt.
- Sipas kuadrit "të bazuar te lidhjet"¹, studimi ka shqyrtuar narrativat që përdoren për të promovuar radikalizmin në kontekstin shqiptar. Gjetjet sugjerojnë që mesazhet e radikalizimit përqendrohen në krijimin e perceptimit të një krize fetare në të cilën myslimanët kërcënohen nga laiciteti dhe mungesa e përfaqësimit të duhur e të institucionalizuar në shoqërinë shqiptare, si dhe përhapja e idesë që Perëndimi është armiqësor ndaj islamit. Zgjidhja që propozon propaganda e dhunshme ekstremiste përmes narrativës të saj është ndryshimi i rendit ekzistues politik në Shqipëri dhe vendosjen një modeli islamik qeverisjeje, që udhëhiqet nga sheriat.

¹ Haroro J. Ingram, "A 'Linkage-Based' Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners," International Centre for Counter-Terrorism (2016)

- Nga mbledhja dhe analiza e mesazheve, mund të arrihet në përfundimin se grupet ekstremiste islamike në Shqipëri përdorin narrativë të ngjashme si ISIS-i dhe al-Kaeda, megjithëse mesazhet që përhapen në Shqipëri janë përshtatur për rrethanat unike të kontekstit shqiptar. Mesazhet kryesore për ekstremizëm të dhunshëm përfshijnë mesazhe kundër demokracisë/laicitetit; nxitësit fetarë (interpretimi ekstrem i islamit - pro ISIS; "ne kundër tyre"); solidariteti me vëllezërit/motrat myslimanë (si dhe diskriminimi i perceptuar); dhe stimujt financiarë.
- 6.2% e të anketuarve besojnë se Shqipëria nuk duhet të ketë një orientim politik perëndimor. 20% janë dakord që Perëndimi është armiqësor me vendet dhe kulturën myslimane, 8% janë dakord që ISIS-i ishte përfaqësuesi i vërtetë i islamit dhe 7.6% janë dakord që nëntë myslimanët e arrestuar nga autoritetet shqiptare nën akuzën e ekstremizmit të dhunshëm, u arrestuan padrejtësisht për shkak të fesë së tyre.
- Duke qenë se strategjitë P/KEDH duhet të marrin në konsideratë audienca të ndryshme kur zhvillojnë dhe dërgojnë mesazhe, studimi është përqendruar gjithashtu në identifikimin e audiencave të ndryshme në Bashkinë e Tiranës. Gjetjet tregojnë se shumica e qytetarëve janë kundër EDH-së. Sidoqoftë, disa numra të papërfillshëm shpërndahen përgjatë boshtit matës që është përdorur si kornizë analitike në këtë hulumtim, që përfshin njerëz që janë kureshtarë për ide radikale, ose që shprehin shkallë të ndryshme mbështetjeje, ata që përhapin ide të tilla duke shprehur mbështetjen e tyre për grupet ekstremiste të dhunshme, ose që përfshihen në veprime të dhunshme ekstremiste. Ata që janë në intervalin nga kureshtarë të mbështetës aktivë vlerësohet të jenë në nivelin 15-20%. Sidoqoftë, duke qenë se këto vlerësime bazohen vetëm në të dhënat e nxjerra nga sondazhi, nevojiten kërkime shtesë për të plotësuar njohuritë rreth këtyre audiencave.
- Studimi tregon se ekziston një konsensus i përgjithshëm nga ata që kundërshtojnë EDH-në se ai është i dëmshëm për kohezionin social, sigurinë dhe demokracinë e vendit dhe se duhet parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive. Aktorët institucionalë qeveritarë, por edhe aktorët fetarë dhe studentët/nxënësit bien dakord që veprimet duhet të ndërmerren përmes një qasjeje të strukturuar strategjike.
- Intervistat dhe diskutimet në grup zbulojnë se ka një mungesë komunikimi zyrtar të strukturuar midis ministrive dhe institucioneve të tjera përkatëse, të përfshira në zbatimin e SKLEDH-së dhe Planit të Veprimit. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për të kuptuar më mirë rëndësinë e komunikimit strategjik në përgatitjen dhe shpërndarjen e mesazheve kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe rolin udhëheqës të QKEDH-së në këtë drejtim.
- Në përputhje me çdo qasje të komunikimit të mirë, u identifikuan disa elementë me ndikim të rëndësishëm në zbatimin më të mirë të Masës 5 të strategjisë, duke përfshirë angazhimin dhe koordinimin e të gjithë aktorëve (krijimin e një grupi pune); forcimin e kapaciteteve njerëzore (posaçërisht kryerja e trajnimit të personelit); rritja e kapaciteteve financiare,

duke përfshirë krijimin e një buxheti të dedikuar; përcaktimin e procedurave specifike në rastet kur komuniteti nuk bashkëpunon; ndërgjegjësimin dhe takimet me komunitetin; dhe riformulimin e dokumentit strategjik.

- Banorët e zonave rurale duket se i kushtojnë më shumë rëndësi fesë. Ata kanë përqindjen më të lartë të frekuentimit javor të ceremonive fetare dhe e njohin shumë më pak termin "ekstremizëm i dhunshëm".
- Sondazhi tregon se rajonet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës, Fierit dhe Kukësit, konsiderohen se kanë një prani më të lartë të ekstremizmit të dhunshëm. Tirana renditet më lart se të tjerat, pasi gati një në dy të anketuar besojnë se ekstremizmi i dhunshëm është më shqetësues në këtë rajon.
- Të anketuarit besojnë se ekstremistët shënjestrojnë tensionet shoqërore për të radikalizuar njerëzit, ndërsa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale i konsiderojnë stimujt materialë dhe financiarë si me ndikim më të madh në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm.
- Toleranca fetare vlerësohet si një tipar themelor i shqiptarëve në ligjërimin publik, dhe të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e të anketuarve, veçanërisht brezat e rinj, bien dakord me këtë.
- 7% e qytetarëve janë dakord ose plotësisht dakord se është detyra e të gjithëve të luftojnë për fenë e tyre, edhe me anë të përfshirjes në veprime të dhunshme nëse është e nevojshme, për të mbrojtur bindjet fetare.
- Shumica e të anketuarve janë dakord (25.7%) ose plotësisht dakord (47.6%) që autoritetet shqiptare duhet të riatdhesojnë shtetasit shqiptarë të cilët kanë mbetur në kampet në Irak dhe Siri. Megjithatë, 41% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord se të rikthyerit nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak do të përbënin një kërcënim për sigurinë e komuniteteve të tyre.
- 73% e të anketuarve, veçanërisht gratë, besojnë se anëtarët e grupeve të dhunshme ekstremiste mund të kryejnë veprime të dhunshme terroriste në Shqipëri.

Ky është studimi i parë empirik i kryer në Shqipëri që ka për qëllim kryesor të luftojë propagandën e dhunshme ekstremiste, dhe si i tillë ai mund të përdoret nga punonjësit e institucioneve përkatëse qeveritare. Studimi ka në fokus kryesor punonjësit e institucioneve qeveritare dhe të gjithë aktorët e shoqërisë që janë përfshirë në veprimet P/KEDH, por edhe studiuesit dhe fushën akademike në përgjithësi. Studimi është një kontribut i rëndësishëm, sepse vendos gurin themelor në studimin empirik të kësaj fushe në Shqipëri dhe siguron një bazë të qëndrueshme për kërkime të mëtejshme.

Kapitull II: Hyrje



Ky studim eksploron propagandën e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe audiencat që përballen me këtë propagandë në Bashkinë e Tiranës, me qëllim që të identifikohen narrativat dhe mesazhet që do të zhvillohen dhe dërgohen në kuadër të veprimeve P/KEDH nga QKEDH-ja.

Shqipëria u përball për herë të parë me problemin e radikalizimit në dekadën e parë pas rënies së regjimit komunist në vitet 1990, kur rrjetet terroriste depërtuan nëpërmjet kamuflimit, në shumë organizata fetare të huaja që mbërritën në Shqipëri për të mbështetur përpjekjet e vendit në rikthimin e institucioneve fetare. Pas shpërbërjes të qelizave të al-Kaedës që vepronin në vend, Qeveria e Shqipërisë ndërmoi një qasje më të qëndrueshme politike kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit.²

Kohët e fundit Shqipëria, ashtu si shumë vende të tjera, është përballur me një valë radikalizimi të shkaktuar nga propaganda e ISIS-it. Të joshur nga kjo propagandë, shumë persona u bënë simpatizues të ISIS-it dhe përllogaritet se 144 shtetas shqiptarë iu bashkuan ISIS-it dhe grupeve të tjera që luftonin në Siri dhe Irak. Prej tyre, 27 janë konfirmuar të vdekur, 50 janë rikthyer dhe 75 mbeten ende në fushën e betejës ose të burgosur nga Forcat Demokratike Siriane.³

Për t'iu përgjigjur prirjeve të fundit, qeveria shqiptare ka rritur përpjekjet e saj për të trajtuar problemin duke forcuar politikën dhe kuadrin institucional. Përgjigja e Shqipërisë përfshin një zhvendosje të politikave nga qasja e përqendruar në luftën kundër terrorizmit drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse ndaj gjithë shoqërisë, që përfshin masa për P/KEDH-në që në fazat e hershme.

Veprimet e përgjithshme për P/KEDH koordinohen nga QKEDH-ja, e cila u themelua në vitin 2017.⁴ SKLEDH-ja e miratuar në vitin 2015 është dokumenti kryesor politik që drejton veprimet e përgjithshme të P/KEDH-së. Ai përcakton katër objektiva strategjike, të grupuara në tre përparësi dhe dhjetë masa.⁵

Përgjatë tre viteve të ekzistencës së saj, QKEDH-ja ka kryer një punë të mirë për sa i përket zbatimit të prioritetëve 1 dhe 3 të SKLEDH-së, përkatësisht *Shtrirja dhe angazhimi i komunitetit dhe Hartimi i politikave afatgjata gjithëpërfshirëse*. Si rezultat i sa më lart, është nxitur bashkëpunimi dhe sinergia që përfshin një sërë institucionesh qeveritare në nivel qendror dhe lokal, si dhe aktorët joqeveritarë, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare. QKEDH-ja ka një bazë të dhënash me mbi 2,400 kontakte dhe nëpërmjet projekteve të shumta, të zbatuara gjatë kësaj periudhe, më shumë

² Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit 2008-2013 dhe Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit 2013-2020.

³ European Commission, Albania 2019 Report: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>. Sqarim: Autorët e këtij studimi i kanë përditësuar numrat e raportuara nga raporti i KE 2019, pasi grupi i parë prej pesë personash u riatdhesuan nga Shqipëria në fund të tetorit 2020 dhe pasi një grua (MD) u raportua e vdekur.

⁴ Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm <https://cve.gov.al/?lang=sq>

⁵ Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (2015) https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/strategjia_kombetare_per_luften_kunder_ekstremizmit.pdf

se 12,000 punonjës të vijës së parë janë përfshirë në trajnime, aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese, si dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve.

Megjithatë, zbatimi i përparësisë 2 të SKLEDH-së, *Luftimi i propagandës ekstremiste duke promovuar vlerat demokratike* ka mbetur përgjithësisht prapa dhe po ashtu edhe kapacitetet dhe ekspertiza për të ndërtuar ura strategjike komunikimi, kanë mbetur të pazhvilluara.

Ndër shkaqet kryesore të identifikuar përfshihet moskuptimi si duhet i rëndësisë së strategjive P/KEDH nga institucionet e përfshira në procesin e zbatimit të SKLEDH-së. Kjo ka ndikuar negativisht në kohezionin e veprimeve për të gjeneruar prova dhe partneritete të përshtatura, të cilat do të ndikonin në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes, si dhe në zhvillimin e një qasjeje strategjike gjithëpërfshirëse të komunikimit.⁶

Duke pasur parasysh rëndësinë e komunikimit në përpjekjet e përbashkëta për P/KEDH, zbatimi i një strategjie efektive dhe të shpejtë komunikimi është i nevojshëm për të adresuar mangësitë në lidhje me zbatimin e përparësisë 2 të SKLEDH-së.

Kjo domosdoshmëri është bërë edhe më e rëndësishme nga trysnia në rritje e publikut për të rikthyer në Shqipëri luftëtarët e huaj terroristë (LHT) me kombësi shqiptare dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngelur në kampe të ndryshme në Siri dhe Irak. Për më tepër, trajtimi i të rikthyerve do të kërkojë një qasje të përcaktuar dhe përpjekje të intensifikuara. Rastet studimore në vendet e tjera kanë treguar se disa të rikthyer, menjëherë pas rikthimit në vendin e tyre, kanë vijuar angazhimin me rrjete terroriste në internet.⁷

Në këtë kontekst, dhe në përputhje me rekomandimet e Rrjetit Evropian të Komunikimit Strategjik,⁸ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)⁹ u angazhua në një projekt të mbështetur nga Hedayah¹⁰, që synon mbështetjen e QKEDH-së për të zbatuar përparësinë 2 të SKLEDH-së.

Projekti përfshiu kryerjen e një studimi të përqendruar në të kuptuarit e audiencave në Bashkinë e Tiranës, që do të përdorej më pas si bazë për identifikimin e mesazheve dhe narrativave të përshtatshme për P/KEDH, si dhe të aktorëve të besueshëm dhe kanaleve të duhura për t'i dërguar këto mesazhe dhe narrativa. Gjithashtu, studimi eksploron edhe fushat e ndërhyrjes për forcimin e kapaciteteve dhe praktikave koordinuese midis QKEDH-së dhe institucioneve përkatëse qeveritare të angazhuara në zbatimin e përparësisë 2 të SKLEDH-së.

⁶ European Strategic Communication Network, Albania Post Visit Report, Consultancy. July 2019

⁷ New Battlegrounds: Extremist groups' activity on social networks in Kosovo, Albania and FYROM (2017)

http://www.qkss.org/repository/docs/New_Battlegrounds_Extremist_Groups_in_Social_Media_738865.pdf. Arsla Jawaid (2017) From Foreign Fighters to Returnees: The Challenges of Rehabilitation and Reintegration Policies, Journal of Peacebuilding & Development, 12:2, 102-107, DOI: 10.1080/15423166.2017.1323660; Stevan Weine et al. Rapid Review to Inform the Rehabilitation and Reintegration of Child Returnees from the Islamic State. (2020).

⁸ <https://www.escn.be/>

⁹ <http://csdgalbania.org/>

¹⁰ <https://www.hedayahcenter.org/>

Për më tepër, projekti u hartua me një teknikë të të mësuarit-përmes-praktikës, në mënyrë që të rriten kapacitetet kërkimore dhe të zhvillohen veprimet bashkëpunuese në lidhje me strategjinë e komunikimit P/KEDH të QKEDH-së, ministrive përkatëse dhe agjencive të përfshira në zbatimin e SKLEDH-së.

Studimi do të ndihmojë në hartimin dhe zbatimin e një projekti pilot rreth mesazheve P/KEDH për t'iu përgjigjur ekstremizmit të dhunshëm specifik në kontekstin e Bashkisë së Tiranës dhe për të mbështetur përpjekjet e përgjithshme për të zbatuar përparësinë 2 të SKLEDH-së.

Hulumtimi bazohet në qasjen e Ingram-it "e bazuar te lidhjet"¹¹, që sugjeron që një strategji efektive komunikimi për P/KEDH duhet të adresojë spektrin e plotë të audiencave të shënjestruara të cënueshme nga propaganda e EDH dhe të trajtojë të ashtuquajturin "sistemin konkurrues të të kuptuarit"¹² i cili përqendrohet në dinamikat "brenda grupit" dhe dinamikat "jashtë grupit"¹³. "Sistemi i të kuptuarit" thekson rëndësinë e një krize identiteti për një bashkësi (brenda grupit), e një krize që shkaktohet nga një bashkësi e identifikuar (jashtë grupit) dhe e cila mund të zgjidhet vetëm nga bashkësia brenda grupit. Bashkësia brenda grupit portretizohet si më e lartë moralisht dhe propagandohet një lojë me shumë zero nga tre lloje të rëndësishme të narrativave të ekstremizmit të dhunshëm: vlerat, dikotomia, dhe forcimi i krizave (përshkrimi i hollësishëm i kuadrit konceptual jepet në seksionin e metodologjisë më poshtë).

Ky është studimi i parë empirik i kryer në Shqipëri që bazohet në një kuadër kërkimor tashmë të testuar dhe që është hartuar me qëllimin për të drejtuar krijimin dhe dërgimin e mesazheve dhe narrativave P/KEDH në kontekstin specifik shqiptar. Si i tillë, ai ofron një themel të mirë për QKEDH-në, ministrinë e linjës dhe agjencinë e përfshira në zbatimin e SKLEDH-së në përpjekjet e tyre për të thelluar njohuritë në drejtimin e veprimeve P/KEDH. Përveç kësaj, ai ofron një bazë për kërkime të mëtejshme dhe mund të përdoret nga organizatat e shoqërisë civile për të përshtatur projekte specifike në lidhje me luftimin e propagandës së EDH, por po ashtu edhe nga media, sektori i biznesit dhe palët e tjera të interesit të përfshira në kryerjen e veprimeve P/KEDH.

Raporti është strukturuar si më poshtë: Seksioni vijues (Seksioni III "Konceptet kryesore të përdorura në këtë studim") ofron një përmbledhje të literaturës dhe praktikës ndërkombëtare mbi fenomenet e radikalizimit dhe EDH. Seksioni IV "Metodologjia" trajton kuadrin konceptual të

¹¹ * Shënim i përkthyesit: Qasja "e bazuar te lidhjet" (anglisht: linkage-based approach) synon të shpërbëjë "sistemin e të kuptuarit" të militantëve islamikë duke përdorur një larmi mesazhesh që shënjestron lidhjet që kanë krijuar ekstremistët e dhunshëm midis tyre, zgjidhjet që ata ofrojnë, si dhe armiqtë dhe krizave ku ata venë theksin. Ekstremistët e dhunshëm e kuptojnë se sa më shumë që një individ joshet nga përvetësimi i "sistemit të tyre të të kuptuarit", aq më i ndjeshëm do të jetë ai individ për të mbështetur grupin e tyre.

¹² * Shënim i përkthyesit: Një sistem i të kuptuarit (anglisht: system of meaning) është një set i marrëdhënieve midis një grupi të variablave (si fjalët, sjelljet, simbolet fizike, etj.) dhe kuptimet që u bashkëngjiten atyre.

¹³ Haroro J. Ingram, "A 'Linkage-Based' Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners," International Centre for Counter-Terrorism (2016). * Shënim i përkthyesit: "Brenda grupit" dhe "jashtë grupit" (anglisht: "in group" dhe "out group" janë dy koncepte të përdorura në këtë studim. Në sociologji dhe psikologji, me termin "brenda grupit" nënkuptohet një grup shoqëror në të cilin një person identifikohet psikologjikisht si anëtar. Ndërsa, me termin "jashtë grupit" nënkuptohet një grup shoqëror me të cilin një individ nuk identifikohet.

këtij studimi dhe ofron një përshkrim të metodologjisë së përdorur për të mbledhur dhe analizuar të dhënat. Seksioni V "Radikalizimi në Shqipëri: nxitësit, shkalla e përhapjes dhe përpjekjet për ta luftuar atë" hulumton prirjet e radikalizimit në Shqipëri. Seksioni VI "Analiza e audiencës së shënjestruar" ofron një analizë të të dhënave nga sondazhi publik i kryer me qytetarë të Bashkisë së Tiranës. Ai ndiqet nga një seksion mbi gjendjen aktuale të aftësive dhe kapaciteteve institucionale për të hartuar dhe zbatuar komunikimin strategjik me qëllim P/KEDH. Dy pjesët e fundit japin konkluzionet dhe rekomandimet e studimit.

Kapitull III: Konceptet kryesore të përdorura në këtë studim



Ky seksion eksploron radikalizimin dhe EDH në një kontekst më të gjerë ndërkombëtar. Nënseksioni i parë përqendrohet në përkufizimin e radikalizimit dhe nxitësit që çojnë drejt tij. Nënseksioni i mëposhtëm shtjellon përkufizimet e EDH, ndërsa nënseksioni i fundit "Lufta kundër EDH dhe propagandës së tij" hulumton kundër-narrativat ndaj EDH dhe komunikimin strategjik të përdorur në këtë drejtim.

Përkufizimi i radikalizimit dhe nxitësit e tij

Ky nënseksion shqyrton përkufizimet e radikalizimit sipas literaturës ndërkombëtare, si dhe historinë dhe rrugët e radikalizimit. Rrënjët e radikalizimit mund të gjenden në vitet e para të shekullit XVIII, ku teori të shumta që përpiqen ta shpjegojnë atë.¹⁴ Në përgjithësi, studimet kanë treguar se nuk ekziston vetëm një rrugë drejt radikalizimit. Argumentohet se radikalizimi dhe terrorizmi arrihen duke i bashkuar individët në grupe të vogla.¹⁵ Në një grup të vogël është e vështirë të ndahet morali personal nga normat e grupit, sepse morali personal zakonisht drejtohet nga një lloj konsensusi në grup. Në një grup të vogël individët gjenden ballë për ballë dhe secili anëtar dhe sjellja e tyre njihet nga të tjerët. Po ashtu, shpërblimet shoqërore për pjesëmarrjen apo ndëshkimet shoqërore për vullnetin e lirë mundet të racionalizojnë sjelljen e anëtarëve. Kur grupet mund të lidhen përmes anëtarëve ose udhëheqësve të përbashkët në një organizatë më të madhe me shumë grupe, veprimi shoqëror bëhet i mundur në një shkallë më të gjerë.¹⁶ Sipas Komisionit Evropian (KE) radikalizimi është një proces kompleks me disa faza, në të cilin një individ ose grup përqafon një ideologji ose besim radikal që pranon, përdor ose miraton dhunën, duke përfshirë edhe aktet e terrorizmit.¹⁷ Megjithëse ky nuk është një fenomen i ri, prirjet, mjetet dhe modelet e radikalizimit kanë evoluar gradualisht me kalimin e kohës. KE deklaroi se aktorët e vetmuar vendas dhe luftëtarët e huaj terroristë që rikthehen vendosin në pikëpyetje sigurinë dhe sfidat specifike për punën e P/KEDH, në një kohë kur interneti dhe mediat sociale u japin grupeve ekstremiste dhe terroriste apo simpatizantëve të tyre mundësi të reja për t'u mobilizuar dhe komunikuar.¹⁸ Të gjitha modelet akademike e konceptojnë radikalizimin si një proces i cili zhvillohet gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe përfshin faktorë dhe dinamika të ndryshme.¹⁹

¹⁴ Për më tepër shih: Peter R. Neumann, "The trouble with radicalization" *International Affairs* 89, no. 4 (2013) 73-893; Alex P. Schmid, "Radicalization, De-Radicalization, Counter-Radicalization: A Conceptual Discussion and Literature Review" *International Center for Counter Terrorism* (March 2013); Craig Calhoun, *The Roots of Radicalism Tradition, the Public Sphere, and Early Nineteenth-Century Social Movements* (The University of Chicago Press Book, 2002)

¹⁵ Clark McCauley, Sophia Moskalenko, "Mechanisms of Political Radicalization: Pathways Toward Terrorism" *Terrorism and Political Violence* 20, no. 3 (2008): 415-433

¹⁶ Po aty

¹⁷ Shih: https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/crisis-and-terrorism/radicalization_en

¹⁸ Po aty

¹⁹ Për më tepër shih: James Khalil, John Horgan and Martine Zeuthen, "The Attitudes-Behaviors Corrective (ABC) Model of Violent Extremism" *Terrorism and Political Violence* (2019), Peter Neumann, "The Trouble", *International Affairs*, op. cit., p. 874.

Megjithëse nuk ka vetëm një rrugë drejt radikalizimit, nuk ka vetëm një nxitës të tij ose vetëm një profil të terroristëve - ekspertët kanë identifikuar një numër faktorësh dhe dinamikash të përsëritura. Peter Neumann i ka grupuar faktorët dhe dinamikat si më poshtë: (a) zemërimet - të gjitha format e radikalizimit bazohen në tensione shoqërore, të cilat mund të shkaktojnë mosarritjen e pritshmërive, konfliktet e identitetit, ndjenjat e padrejtësisë, marginalizimin, izolimin ose përjashtimin; (b) nevojat - të qenët pjesë e një grupi ekstremist plotëson nevojat emocionale të ndjekësve, siç janë nevoja për përkatësi, për t'u ndjerë pjesë e një komuniteti, lavdia, aventura, fuqia, rëndësia dhe në disa raste përfshin edhe shfrytëzimin e cenueshmërive psikologjike; (c) idetë - nevojiten idetë që kanë kuptim për ta kthyer pakënaqësinë në një projekt politik, prandaj ata identifikojnë një "kokë turku" dhe ofrojnë zgjidhje - kur këto ide përmbushin një botëkuptim koherent ato quhen ideologji; (d) njerëzit - në shumicën e rasteve radikalizimi është një proces shoqëror në të cilin udhëheqësit karizmatikë, figurat autoritare ose grupet e ngushta miqësore janë thelbësore në forcimin e besimit, besnikërisë, trysnisë dhe përkushtimit; dhe (e) dhuna - të qenët i ekspozuar ndaj dhunës të bën të dhunshëm - në këtë mënyrë individët kërkojnë hakmarrje ose bëhen mizorë.²⁰

Nga ana tjetër, radikalizimi mund të ndodhë në nivele të ndryshme. McCauley dhe Moskalenko kanë identifikuar tre nivele të radikalizimit: a) radikalizimi individual - individë të radikalizuar nga zemërimet personale ose politike, viktimizimi, ose nga pjesëmarrja në një grup radikal; b) radikalizimi i grupit; dhe c) radikalizimi masiv - individë në forma të ndryshme konfliktesh me një grup të jashtëm.²¹

Robert Wintrobe përdor një përkufizim më gjithëpërfshirës të radikalizimit, duke deklaruar se radikalizimi është një pjesë normale e jetës njerëzore. Ai është pronë e individëve, grupeve, shteteve dhe shoqërive dhe nuk është gjithmonë e keqe.²² Së pari, autori skicon problemet e vendosjes së kufijve, duke argumentuar se konceptet e radikalizimit, ekstremizmit dhe terrorizmit varen nga normat historike dhe shoqërore, prandaj, nuk mund të jepet asnjë përkufizim i përgjithshëm. Së dyti, ai sugjeron se anashkalimi i kësaj çështjeje na lejon të mendojmë për radikalizimin ose lëvizjen drejt konfliktit duke përfshirë një mori të tërë procesesh shoqërore, të vogla dhe të mëdha, si dhe duke përfshirë politikën si normale, nën konceptin e mikro-radikalizimit. Së treti, ai demonstroi se si radikalizimi i ndërsjellë, ku individët ose grupet lëvizin drejt konfliktit në përgjigje të lëvizjes së të tjerëve,²³ mund të ndodhë në të gjitha nivelet dhe jo vetëm në këto konflikte që karakterizohen nga grupet ekstremiste. Autori e përfundon shpjegimin duke rikonsideruar politikën e luftës kundër radikalizimit, duke bërë thirrje për një diskutim më të thellë politik rreth shoqërisë së mirë, kufijve të lirisë dhe etikës së ndërhyrjes, si dhe duke bërë thirrje për parimet kryesore të drejtësisë, transparencës dhe proporcionalitetit.

²⁰ Peter Neumann, "Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region," Report, London: OSCE (2017)

²¹ Clark McCauley, Sophia Moskalenko, "Mechanisms of Political Radicalization: Pathways Toward Terrorism" *Terrorism and Political Violence* 20, no. 3 (2008): 415-433

²² Ronald Wintrobe, *Rational Extremism: The Political Economy of Radicalism* (Cambridge University Press, 2006)

²³ Shih gjithashtu fenomenin e njohur si "Efekti pigmalion" i cili nënkupton se ekstremizmi i njërit krah nxit ekstremizmin e krahut tjetër.

Për sa i përket rrugëve që çojnë drejt radikalizimit, ato mund të ndryshojnë nga personi në person pasi procesi i radikalizimit është shumë kompleks. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm mbi individin, grupin dhe nivelet makro që e shtyjnë një person drejt një grupi ekstremist të dhunshëm ose e tërheqin një person nga një grup i tillë. Faktorët mund të përfshijnë shembuj të tillë si përjashtimi social, heqja e të drejtës së votës, varfëria, ksenofobia, apo abuzimet me të drejtat e njeriut. Plani i Veprimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm bën dallimin midis dy kategorive të nxitësve: kushtet dhe konteksti strukturor i favorshëm për EDH (faktorët shtytës) dhe përvojat dhe motivet individuale që forcojnë proceset e radikalizimit, duke çuar përfundimisht në veprime të dhunshme ekstremiste (faktorët tërheqës).²⁴

Faktorët shtytës	<ul style="list-style-type: none"> · Mungesa e mundësive ekonomike: varfëria, papunësia, pabarazia, korrupsioni · Margjinalizimi dhe diskriminimi: mobiliteti i kufizuar politik, shoqëror dhe ekonomik · Qeverisja e dobët, shkelja e të drejtave të njeriut dhe çështjet e shtetit të së drejtës: politika shtypëse, mbikëqyrja · Konfliktet e zgjatura dhe të pazgjidhura: vakumi i sigurisë, paqëndrueshmëria, zemërimet me rrënjë të thella · Radikalizimi në burgje: trajtimi i ashpër, kushtet e burgjeve, veprimtaria e bandave, mungesa e sigurisë, përdorimi i drogës
Faktorët tërheqës	<ul style="list-style-type: none"> · Historia dhe motivimi individual: përvojat negative me institucionet shtetërore · Zemërimet kolektive dhe viktimizimi: shtypja, nënshtrimi, ndërhyrja e huaj · Shtrembërimi dhe keqpërdorimi i besimeve, ideologjive politike dhe dallimeve etnike dhe kulturore · Udhëheqja dhe rrjetet sociale: udhëheqësit karizmatikë, familjet informale dhe rrjetet sociale

*Tabela 1. Faktorët shtytës dhe tërheqës të radikalizimit.*²⁵

Megjithatë, njerëzit e radikalizuar nuk janë në vetvete të dhunshëm dhe pavarësisht se ata mund të kenë disa karakteristika të ngjashme me ekstremistët (e dhunshëm), ata kanë edhe ndryshime të rëndësishme.²⁶

Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) argumenton se radikalizimi në vetvete nuk është domosdoshmërisht një kërcënim për shoqërinë nëse nuk lidhet me dhunën ose

²⁴ UNGA, Plan of Action to Prevent Violent Extremism (2015) A/70/674; Shih edhe: Erin Marie Saltman and Melanie Smith, "Till Martyrdom Do Us Part' Gender and the ISIS Phenomenon" Institute for Strategic Dialogue (2015) https://www.isdglobal.org/wp-content/uploads/2016/02/Till_Martyrdom_Do_Us_Part_Gender_and_the_ISIS_Phenomenon.pdf

²⁵ Burimi: UN Plan of Action to Prevent Violent Extremism

²⁶ Shih: Alex P. Schmid, "Radicalization, De-Radicalization, Counter-Radicalization: A Conceptual Discussion and Literature Review" *International Center for Counter Terrorism* (March 2013); Ronald Wintrobe, *Rational Extremism: The Political Economy of Radicalism* (Cambridge University Press, 2006)

akte të tjera të paligjshme, si nxitja e urrejtjes.²⁷ OSBE argumenton se radikalizimi përbën një kërcënim për shoqërinë nëse një individ "pranon dhunën terroriste si një veprim të mundshëm, ndoshta edhe legjitim".²⁸ Radikalizimi në ditët e sotme lidhet ngushtë me ideologjinë dhe pikëpamjet fetare ose fundamentalizmin fetar.²⁹ Komisioni Evropian e përkufizon radikalizimin si "fenomeni në të cilin njerëzit përqafojnë mendime, pikëpamje dhe ide që mund të çojnë në terrorizëm".³⁰

EDH mund të përshkruajë ide që janë diametralisht të kundërta me vlerat thelbësore të shoqërisë, të cilat në kontekstin e OSBE-së mund të nënkuptojnë forma të ndryshme të epërsisë fetare ose racore ose ndonjë ideologji që mohon sistematikisht të drejtat themelore të njeriut.³¹ Ai mund t'i referohet gjithashtu metodave të pamëshirshme të ndjekjes së ideve politike, duke shpërfillur jetën, lirinë dhe të drejtat e njerëzve të tjerë. Nënseksioni vijues shtjellon më tej EDH.

Përkufizimi dhe Kuptimi i Ekstremizmit të Dhunshëm

Ndërkohë që nënseksioni i mëparshëm eksplori fenomenin e radikalizimit, ky nënseksion eksploron përkufizimin, historinë dhe elementet e EDH. Nuk ka një konsensus ndërkombëtar për të përkufizuar EDH ose terrorizmin, madje nuk ka konsensus as mbi dallimin midis terrorizmit dhe EDH. Është argumentuar se ekstremizmi i dhunshëm është i ndërlikuar dhe nuk është tipar i ndonjë race, feje ose shkolle politike të caktuar dhe mund të ketë pasoja të thella në shoqëri.³² Pavarësisht nga larmia e tyre, lëvizjet ekstremiste të dhunshme kanë elementë të përbashkët që ofrojnë një shteg për t'i kuptuar. J.M. Berger shpjegon se kuadri më i dobishëm për diskutimin e ekstremizmit njihet si teoria e identitetit shoqëror, një qasje për të kuptuar dinamikat ndërmjet grupeve. Teoria e identitetit shoqëror përcakton që njerëzit e kategorizojnë veten dhe të tjerët si anëtarë të grupeve shoqërore konkurruese. Grupi i brendshëm (in-group) është një grup njerëzish që kanë një identitet të njëjtë, të tillë si fetar, racor ose kombëtar. Ky është grupi të cilit i përket dikush - "ne" në mendësinë "ne kundër të tjerëve". Grupi i jashtëm (out-group) është një grup njerëzish që përjashtohen nga një grup specifik i brendshëm. Ata janë pjesë e "të tjerëve".

Haroro Ingram shpjegon se propaganda e ekstremizmit të dhunshëm është krijuar për t'i siguruar audiencës së saj një "sistem konkurrues të të kuptuarit" i cili shërben si një kornizë përmes së cilës

²⁷ Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), Preventing terrorism and countering violent extremism and radicalization that lead to terrorism: a community-policing approach (2014) 35

²⁸ Po aty

²⁹ Peter Neumann, "Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region," Report, London: OSCE (2017)

³⁰ Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Terrorist recruitment: addressing the factors contributing to violent radicalization, COM (2005)

³¹ Peter Neumann, "Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region," Report, London: OSCE (2017)

³² J.M. Berger, *Extremism* (Massachusetts, MIT Press, 2018) 26

mbështetësit perceptojnë dhe gjykojnë botën.³³ Në qendër të këtij "sistemi të të kuptuarit" vendoset zakonisht një deklaratë e vetme gjithëpërfshirëse ose "tingull": "ne jemi përkrahësit dhe mbrojtësit e myslimanëve (që ndajnë të njëjtin botëkuptim) (identiteti i grupit të brendshëm), të gjithë jashtë këtij grupi të ngushtë identiteti janë armiq (d.m.th. identitetet e grupit të jashtëm ose "të tjerët") të cilët janë përgjegjës për krizat e *umetit* (komunitetit të myslimanëve), kështu që na mbështesni ne dhe zgjidhjet tona (d.m.th. programin politik-ushtarak të militantëve islamikë)."³⁴

Alex P. Schmid ofron disa këndvështrime të dobishme që na ndihmojnë të kuptojmë EDH-në.³⁵ Schmid shpjegon se grupet ekstremiste (të dhunshme), lëvizjet apo edhe grupet e tyre priren të kenë shumë nga elementët e mëposhtëm:³⁶

- Anti-kushtetues, anti-demokratikë, anti-pluralistë, autoritarë;
- Fanatikë, intolerantë, jo-kompromentues, me botëkuptim të njëanshëm bardhezi;
- Refuzojnë sundimin e ligjit dhe besojnë në një filozofi ku qëllimet i justifikojnë mjetet;
- Synojnë të arrijnë qëllimet e tyre me çdo mjet, duke përfshirë, kur u jepet mundësia, përdorimin e dhunës së rëndë politike kundër kundërshtarëve.

Schmid argumenton se këto elementë, të kombinuar me një theks të fortë tek ideologjia janë karakteristikat kryesore të ekstremistëve. Për më tepër, ai konsideron se ekstremistët në të majtën dhe të djathtën politike, ata me një orientim fetar fundamentalist si dhe ata me natyrë politike etno-nacionaliste tregojnë një prirje për të ndjekur aspektet e mëposhtme në rrugën për të realizuar programet politike:³⁷

- Përdorimin e forcës/dhunës mbi bindjen;
- Uniformitetin mbi diversitetin;
- Qëllimet e përbashkëta mbi liritë individuale;
- Dhënien e urdhrave mbi dialogun.

Përkufizimi i EDH që përdoret në këtë studim është ai i miratuar nga UNESCO, i cili "i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën për të arritur qëllimet

³³ Haroro J. Ingram, "Deciphering Siren Call of Militant Islamic Propaganda: Meaning, Credibility and Behavioral Change" *International Center for Counter-Terrorism* (2016)

³⁴ Haroro J. Ingram, "A 'Linkage-Based' Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners," *International Centre for Counter-Terrorism* (2016) <https://icct.nl/wp-content/uploads/2016/11/ICCT-Ingam-A-Linkage-Based-Approach-Nov2016.pdf>

³⁵ Alex P. Schmid, "Radicalization, De-Radicalization, Counter-Radicalization: A Conceptual Discussion and Literature Review," *International Center for Counter Terrorism* (March 2013) <http://www.icct.nl/download/file/ICCT-Schmid-Radicalization-De-Radicalization-Counter-Radicalization-March-2013.pdf>

³⁶ Po aty, 9

³⁷ Po aty

ideologjike, fetare ose politike".³⁸ Ky përkufizim u zgjodh sepse OKB-ja ka një qasje më universale dhe gjithashtu ky përkufizim përdoret edhe nga institucionet shqiptare përgjegjëse për zbatimin e SKLEDH.

Lufta ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe propagandës së tij (P/KEDH)

Në vijim të trajtimit të mëparshëm të përkufizimeve, historisë dhe elementeve të EDH-së, ky nënseksion shtjellon literaturën dhe praktikën ndërkombëtare në luftën ndaj EDH-së dhe propagandës së tij.

Kuadri për bashkëpunimin botëror kundër terrorizmit është përcaktuar në shumë traktate ndërkombëtare. OKB-ja ka theksuar nevojën për të adresuar kushtet e favorshme për përhapjen e terrorizmit në strategjinë e rishikuar botërore kundër terrorizmit.³⁹ Në vitin 2013, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 68/127 i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar "të bashkohet kundër EDH në të gjitha format dhe manifestimet e saj".⁴⁰ Rezoluta 2178 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së hodhi themelet për bashkëpunimin KEDH në nivelin e OKB-së.⁴¹ Rezoluta nënvizon se "lufta kundër EDH, e cila mund të jetë e favorshme për terrorizmin është një element thelbësor në adresimin e kërcënimit ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të paraqitur nga luftëtarët e huaj terroristë". Rezoluta rendit një numër masash specifike që duhet të ndërmerren nga shtetet, duke përfshirë: parandalimin e hyrjes ose kalimit në territoret e tyre të individëve të dyshuar; ndërprerjen e mbështetjes financiare për Luftëtarët e Huaj Terroristë (LHT); zhvillimin e strategjive për të luftuar narrativat e dhunshme ekstremiste; miratimin e qasjeve të posaçme për ndërprerjen e rekrutimit; dhe promovimin e përfshirjes dhe kohezionit social.

Duke u bazuar në këtë rezolutë, si dhe në strategjitë dhe legjislacionin parandalues të disa vendeve evropiane, termi Lufta kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDH) është përdorur për të përshkruar këto qasje që synojnë të krijojnë qëndresë midis popullsisë që shihet si jo e cenueshme (parandaluese) ose të ndihmojnë individët që janë të prirur për t'u larguar nga ekstremizmi (de-radikalizimi).⁴²

³⁸ UNESCO. "Preventing Violent Extremism Through Education. A Guide for Policy-makers." (2017).

³⁹ UNGA, The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy Review (2018) A/RES/72/284

⁴⁰ UNGA, A world against violence and violent extremism (2013) A/RES/68/127

⁴¹ UNSC, Resolution 2178 (2014)

⁴² Për më tepër shih: Minerva Nasser-Eddine, Bridget Garnham, Katerina Agostino and Gilbert Caluya, "Countering Violent Extremism (CVE) Literature Review" Counter Terrorism and Security Technology Centre (2011)

<https://apps.dtic.mil/sti/pdfs/ADA543686.pdf>; Georgia Holmer, "Countering Violent Extremism: A Peacebuilding Perspective", United States Institute of Peace (2013) https://www.icnl.org/wp-content/uploads/Transnational_CVEUSIP.pdf ; Gielen, Amy-Jane, "Countering Violent Extremism: A Realist Review for

Assessing What Works, for Whom, in What Circumstances, and How?" *Terrorism and Political Violence* 31, no. 6 (2019) 1149-1167; Haroro J. Ingram, "A 'Linkage-Based' Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered

Fokusi i P/KEDH është i lidhur ngushtë me diskreditimin dhe delegitimimin e “ideologjisë që nxit EDH dhe mobilizon një rrymë të vazhdueshme të rekrutuarish në kauzat ekstremiste”.⁴³ Politikat P/KEDH synojnë të adresojnë shkaqet rrënjësore të radikalizimit, të tilla si ndjenja e mënjanimet nga shoqëria, privimi ekonomik, padrejtësitë e perceptuara, mohimi i të drejtave, ksenofobia dhe abuzimet me të drejtat e njeriut.

Rritja e ISIS-it dhe përdorimi i gjerë i propagandës së tij në internet kanë rritur ndërgjegjësimin e vetëdijes publike ndaj propagandës terroriste. Tani dihet që ekstremistët e dhunshëm kanë përdorur në mënyrë efektive internetin dhe mediat sociale për të ecur përpara drejt qëllimeve të tyre, qoftë përmes angazhimit, propagandës, radikalizimit ose rekrutimit.⁴⁴ Këshilli i Sigurimit të OKB-së e cilëson si thelbësore për konceptin e KEDH adresimin e "kushteve të favorshme" për përhapjen e terrorizmit, të cilat përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në Strategjinë Botërore kundër Terrorizmit të Kombeve të Bashkuara.⁴⁵

Nga ana tjetër, shumë aktorë dhe shtete besojnë fitimi i luftës së komunikimit është një pjesë thelbësore e P/KEDH.⁴⁶ Megjithëse kësaj të fundit i është kushtuar më shumë vëmendje së fundmi për shkak të kërcënimit bashkëkohor botëror nga terrorizmi, veçanërisht pas rritjes së ISIS-it, kjo nuk përbën një fenomen të ri. Përkundrazi, komunikimet bindëse kanë qenë të lidhura me luftën që në lashtësi.⁴⁷ Në ditët e sotme, shumica e vëmendjes i është kushtuar masave kufizuese për të fshirë përmbajtjet ekstreme në internet, ose për të ndaluar narrativat e jashtëligjshme përmes fshirjes dhe filtrimit.

Sidoqoftë, kjo përgjigje shfaq kufizime të mëdha në efektshmëri, duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën ngarkohen të dhëna të reja, si dhe kapacitetet e kufizuara të agjencive ligjzbatuese.⁴⁸

Framework for Practitioners,” *International Centre for Counter-Terrorism* (2016) <https://icct.nl/wp-content/uploads/2016/11/ICCT-Ingram-A-Linkage-Based-Approach-Nov2016.pdf>

⁴³ Shannon N. Green, “Changing the Narrative: Countering Violent Extremist Propaganda” (September 2015) <https://www.csis.org/analysis/changing-narrative-countering-violent-extremist-propaganda>

⁴⁴ United Nations Security Council Counter-Terrorism Committee Executive Directorate, Countering Violent Extremism and Terrorist Narratives https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2019/06/ctc_cted_fact_sheet_designed_cve_counter_narratives_december_2018.pdf; UN System Focal Point on PCVE <https://www.un.org/counterterrorism/preventing-violent-extremism>

⁴⁵ UNGA, The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy Review (2018) A/RES/72/284

⁴⁶ Këshilli i Sigurimit të OKB ka kërkuar nga Komiteti kundër Terrorizmit që “të identifikojë dhe përpilojë praktikatat e mira ekzistuese në luftën kundër narrativave terroriste, në koordinim me Zyrën e CTITF [Zyra e Task Forcës për Zbatimin e Përpjekjeve kundër Terrorizmit], Grupin Punues të CTITF për Komunikimin, dhe kur është e përshtatshme në konsultim me subjekte të tjera përkatëse jashtë Kombeve të Bashkuara. Komiteti kundër Terrorizmit dhe CTED do të vazhdojnë të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për të “zbatuar kuadrin gjithëpërfshirës ndërkombëtar për të luftuar narrativat terroriste, për të identifikuar dhe përpiluar praktikatat e mira ekzistuese”, dhe për të ofruar udhëzime dhe mbështetje teknike.

⁴⁷ Haroro J. Ingram and Alastair Reed, “Lessons from History for Counter Terrorism Strategic Communications.” *International Centre for Counter-Terrorism* (2016) <https://www.icct.nl/wp-content/uploads/2016/06/ICCT-Ingram-CTSC-June-2016-3.pdf>

⁴⁸ Rachel Briggs and Sebastian Feve, “Review of Programs to Counter Narratives of Violent Extremism: What Works and What are the Implications for Government?” *Institute for Strategic Dialogue* (2013)

Kohët e fundit, ka pasur një rritje të interesit për qasjet alternative ndaj këtij problemi. Si rezultat, ka lindur një interes i ri për të luftuar narrativat e organizatave terroriste, në vend që ato thjesht të ndalohen. Një zgjidhje e tillë e mundshme ofrohet nga 'kundër-narrativat'; përpjekje për të sfiduar mesazhet ekstremiste dhe ekstremiste të dhunshme, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes një sërë mjetesesh në internet dhe jashtë tij.⁴⁹

Termi 'kundër-narrativë' është kthyer në një term gjithëpërfshirës për një gamë të gjerë aktivitetesh.⁵⁰ Ai mund t'i referohet nismave të ndërmarra nga qeveria, strategjive të deradikalizimit, ose lëvizjeve të shoqërisë civile apo grupeve komunitare dhe mund t'u drejtohet një numri të gjerë audiencash, të tilla si ekstremistët, ata që janë të cenueshëm nga ekstremizmi, anëtarët e komuniteteve që përfshijnë ekstremistët, ose të gjithë popullsinë.⁵¹ Ai mund të përfshijë gjithashtu një numër të gjerë mesazhesh, të tilla si ato që përpiqen të diskreditojnë ose përqeshin ekstremistët, ose ato që përpiqen të fuqizojnë komunitetet duke promovuar histori të ndryshme.

Megjithatë, është e domosdoshme që para se të zhvillohet një strategji e integruar komunikimi P/KEDH, duhet që së pari të zërthehet propaganda e EDH dhe të kuptohet audienca e shënjestruar. Siç u përmend më parë, sipas teorisë së identitetit shoqëror, Ingram argumenton se propaganda e dhunshme ekstremiste është krijuar për t'i siguruar audiencës së saj një "sistem konkurrues të të kuptuarit, i cili vepron si një optikë përmes së cilës mbështetësit janë të detyruar të perceptojnë dhe gjykojnë botën."⁵²

Ingram argumenton se mënyra e saktë për të sfiduar "sistemet e të kuptuarit" ekstremist është sulmimi i lidhjeve që venë në lëvizje ciklin e tyre vetë-përforcues duke përdorur një strategji me dy nivele.⁵³ Niveli i parë përbëhet kryesisht nga ata që ende nuk e kanë përvetësuar "sistemin e të kuptuarit" të ekstremizmit të dhunshëm duke përdorur një kombinim të mesazheve negative që sulmojnë lidhjet midis ekstremistëve të dhunshëm dhe zgjidhjet e propozuara prej tyre, si dhe mesazhe pozitive që venë theksin te zgjidhjet e mundshme të krizave përtej ekstremistëve të dhunshëm. Niveli i dytë synon ata që tashmë janë brenda ciklit të ekstremistëve, për të cilët përdoren mesazhe negative si një strategji për mosangazhimin e tyre dhe për shpërbërjen e rrjetit. Spektri i audiencave të shënjestruara ilustron grafiki më poshtë. Qasja "e bazuar te lidhjet" përdor mesazhe të përshtatura për të shënjestruar ato lidhje thelbësore që krijojnë propagandën e

<https://www.dmeforpeace.org/peaceexchange/wp-content/uploads/2018/10/Review-of-Programs-to-Counter-Narratives-of-Violent-Extremism.pdf>

⁴⁹ Rachel Briggs and Sebastian Feve, "Review of Programs to Counter Narratives of Violent Extremism: What Works and What are the Implications for Government?" *Institute for Strategic Dialogue* (2013)

<https://www.dmeforpeace.org/peaceexchange/wp-content/uploads/2018/10/Review-of-Programs-to-Counter-Narratives-of-Violent-Extremism.pdf>

⁵⁰ Radicalization Awareness Network, Counter Narratives and Alternative Narratives (2015) https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalization_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_cn_oct2015_en.pdf

⁵¹ Po aty

⁵² Haroro J. Ingram, "A 'Linkage-Based' Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners," *International Centre for Counter-Terrorism* (2016) <https://icct.nl/wp-content/uploads/2016/11/ICCT-Ingram-A-Linkage-Based-Approach-Nov2016.pdf>

⁵³ Po aty

ekstremizmit të dhunshëm midis tyre dhe zgjidhjeve që ata ofrojnë, si dhe armiqve të tyre dhe krizave.

Ingram argumenton se niveli 1 ka qëllime të dyfishta. E para është shpërbërja e "sistemit të të kuptuarit" që përkrahet nga ekstremistët e dhunshëm. Kjo arrihet duke dërguar mesazhe që sulmojnë në mënyrë të ndryshme lidhjet që ekstremistët e dhunshëm kanë midis tyre dhe zgjidhjeve, armiqve dhe krizave. Kjo njihet si *përdorimi i mesazheve negative* sepse vë theksin në rrezikun që i paraqitet audiencës së shënjestruar nëse bën zgjedhje të caktuara dhe kërkon të zvogëlojë apelin e ekstremistëve të dhunshëm. Qëllimi i dytë është *përdorimi i mesazheve pozitive* që thekson përfitimet e zgjedhjeve të caktuara dhe kërkon të rrisë apelin e vetvetes (p.sh. qeverisë) dhe/ose aleatëve (p.sh. grupet e komunitetit). Përpyekjet e nivelit 1 adresojnë një spektër të gjerë të audiencës së shënjestruar nga "kundërshtarët" në "të angazhuarit." Këto lloj mesazhesh duhet që, sa më shumë që të jetë e mundur, të sinkronizohen me veprime mbështetëse në terren (p.sh. nismat KEDH). Nëse mesazhet dhe veprimet nuk koordinohen (d.m.th. kthimi i fjalëve në vepra), besueshmëria e të dyjave mund të dëmtohet ndjeshëm.

Niveli 2 ka gjithashtu dy qëllime. E para është përdorimi i strategjive të shpërbërjes së rrjeteve ekstremiste të dhunshme në internet dhe jashtë tij. Në kontekstin e internetit kjo përfshin mbylljen e llogarive të ekstremistëve të dhunshëm. Jashtë internetit, kjo kërkon që zyrtarët të shënjestrojnë rrjetet ekstremiste të dhunshme dhe mbështetësit e tyre duke përdorur mjetet e dhura shtetërore. E dyta është përdorimi i narrativave të mosangazhimit përmes mesazheve negative që shënjestrojnë mbështetësit e heshtur dhe ata aktivë të EDH për të shkaktuar ndryshime të sjelljes dhe zvogëlimin e mbështetjes së tyre ndaj grupeve ekstremiste. Në seksionin vijues shqyrtohet kuadri konceptual dhe metodologjia e këtij studimi.

Kapitull IV: Metodologjia



Ky studim është kryer në kuadër të projektit “Zhvillimi i hulumtimit për drejtimin e mesazheve P/KEDH në Bashkinë e Tiranës dhe mbështetja e QKEDH-së në rritjen e kapaciteteve të hulumtimit dhe komunikimit strategjik”, mbështetur nga Hedayah dhe zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me QKEDH-në, e cila është identifikuar si përfituesi kryesor i projektit. Metodologjia e zbatimit të projektit përfshin aktivitete hulumtuese dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Hulumtimi u përqendrua në dy aspekte kryesore: (1) njohja e audiencave në bashkinë e Tiranës dhe faktorët e radikalizimit me qëllim për të hartuar veprimet e komunikimit strategjik P/KEDH, dhe (2) vlerësimi i kapaciteteve të aktorëve kryesorë dhe palëve të interesuara që janë përfshirë në zbatimin e SKLEDH-së dhe që kanë rol në zhvillimin dhe zbatimin e veprimeve strategjike të komunikimit dhe monitorimit të rezultateve. Arsyeja që ky hulumtim u përqendrua në Bashkinë e Tiranës erdhi si pasojë e identifikimit paraprak të kësaj bashkie si një nga pikat e nxehta të radikalizimit në vend.

Institucionet e përfshira në aktivitetet hulumtuese dhe rritjen e kapaciteteve ishin QKEDH, Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe stafi i agjencive në varësi të këtyre ministrive. Për më tepër, procesi i mbledhjes së të dhënave përfshiu edhe nxënës nga shkollat e mesme, studentë të universiteteve, si dhe përfaqësues të komuniteteve fetare.

Fokusi i këtij studimi ka qenë rekrutimi dhe radikalizimi i EDH që promovohet nga lëvizjet dhe grupet radikale islamike (dhe jo nga grupet radikale të djathta apo grupet etno-nacionaliste).

Hapi i parë praktik për të zhvilluar strategjitë P/KEDH që shënjestrojnë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm islamik është njohja e audiencave që do të marrin mesazhet. Këto audiencia përbëhen nga persona të radikalizuar, ata që ka gjasë të radikalizohen, dhe ata që preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personat e radikalizuar.

Kjo kërkon hartimin e proceseve hulumtuese që lejojnë njohjen e thellë të dy komponentëve të audiencave të përkohshme. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të merret në konsideratë që përshtatja e mesazheve kërkon një njohje në imtësi të personave të radikalizuar dhe të atyre që mund të radikalizohen.

Për të ndërmjetësuar në këtë sfidë, të dhënat janë mbledhur dhe analizuar duke u mbështetur kryesisht në qasjen e Ingramit "e bazuar te lidhjet."⁵⁴ Për këtë arsye, kuadri konceptual i këtij studimi përdor "sistemin konkurrues të të kuptuarit" të Ingramit, i cili është thelbësor për propagandën e ekstremizmit të dhunshëm, dhe përqendrohet në dinamikën brenda grupit dhe jashtë grupit. Zhvillimi i "sistemit konkurrues të të kuptuarit" përqendrohet në vënien e theksit te

⁵⁴ Ingram, H., 2016b. A “Linkage- Based” Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners. *International Centre for Counter-Terrorism*.

rëndësia e një krize identiteti brenda grupit, e cila shkaktohet nga një grup i jashtëm dhe që mund të zgjidhet vetëm nga grupi i brendshëm.




Figura 1: Sistemi i të kuptuarit të ekstremizmit të dhunshëm që përforcohet në mënyrë ciklike ⁵⁵

Propaganda ekstremiste përdor një gamë të larmishme mesazhesh, narrativash dhe imazhesh për të bërë lidhjet midis grupeve ekstremiste dhe zgjidhjeve që ata propozojnë, si dhe armiqve të tyre dhe krizës që ata shkaktojnë, në mënyrë që të formojnë dhe forcojnë një rrjet të "modeleve mendore" i cili përbën "sistemin e të kuptuarit" për ekstremistët e dhunshëm dhe mbështetësit e tyre.⁵⁶ Për shembull, disa mesazhe kanë si qëllim të tregojnë se si armiq të shkaktojnë kriza (lidhja e krizave me të tjerët) ndërsa disa të tjera tregojnë se si grupi në fjalë po ofron zgjidhje për krizat (lidhja e zgjidhjeve me grupin e brendshëm).

⁵⁵ Ingram, H., 2016. Op. cit.

⁵⁶ Norman, D, "Some observations on mental models", in D. Gentner and A. Stevens, eds., *Mental Models* (New York: Psychology Press, 1983), pp. 7-14.




Figura 2. Spektri i audiencave të shënjestruara dhe targetimi në dy nivele

Mbledhja e të dhënave

Hulumtimi është hartuar për të nxjerrë të dhëna që hedhin dritë mbi të gjitha kategoritë e mësipërme të njohjes së “sistemit të të kuptuarit”, duke filluar nga grupi i brendshëm - grupi i jashtëm dhe aspektet e krizës - zgjidhjeve, të dhëna për pesë kategoritë e ndryshme të audiencave në të dy nivelet, si dhe të dhëna në lidhje me mjetet e dërgimit të mesazheve.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshiu shqyrtimin e dokumentacionit dhe punën në terren. Përmes shqyrtimit të dokumentacionit, janë mbledhur të dhënat nga studimet e mëparshme në lidhje me këtë temë, nga artikuj të mediave, medias sociale, si dhe nga legjislacioni, faqet zyrtare në internet dhe nga raportet.

Puna në terren përfshiu mbledhjen e të dhënave sasiore me anë të sondazhit publik dhe të dhënave cilësore nga intervistat dhe diskutimet në grup. Pas përfundimit të rishikimit të literaturës dhe analizës PESTL, u hartua një pyetësor për mbledhjen e të dhënave nga sondazhi publik (Shtojca 2).

Të dhënat e sondazhit u mbledhën nëpërmjet intervistave ballë për ballë përmes një kampioni të shtresëzuar prej 800 të rriturish nga 18 deri në 64 vjeç (Shtojca 1). Në shtresën e parë, sondazhi u shpërnda proporcionalisht në 24 njësitë administrative që janë pjesë e Bashkisë së Tiranës bazuar në popullsinë e tyre të rritur. Në shtresën e dytë, sondazhi u shpërnda proporcionalisht në zonat urbane dhe rurale. Me tej, u hartuan kuotat proporcionale të gjinisë dhe moshës për secilën nënshtresë. Marzhi i gabimit statistikor për të gjithë kampionin përlllogaritet në +/- 3.3%.

Fillimisht u plotësuan disa pyetësorë pilotë për të testuar pyetësorin e sondazhit dhe për të vëzhguar reagimet e anketuesve ndaj intervistave në situata të ngjashme për të bërë modifikimet

e mundshme për të zvogëluar paragjykimin dhe për të rritur saktësinë. Të dhënat e sondazhit u ngarkuan automatikisht në një server pas përfundimit të anketimit, duke përdorur një aplikacion celular të krijuar posaçërisht për regjistrimin e përgjigjeve. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur softuerin statistikor STATA 11.

Pas përfundimit të analizës paraprake të të dhënave të sondazhit, u hartua një pyetësor për të mbledhur informacione nga përfaqësuesit e katër ministrive të përfshira (Shtojca 4).⁵⁷ Intervistat synuan të merrnin të dhëna në lidhje me kuadrin legjislativ dhe atë të politikave P/KEDH, arritjet dhe problematikat për zbatimin e tyre, njohjen dhe rëndësinë e komunikimit në P/KEDH, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe programimin, shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin me publikun dhe së fundmi të dhënat mbi shqiptarët e rikthyer ose që do të rikthehen nga Siria dhe Iraku. Intervistat u hartuan për të nxjerrë të dhëna që lidheshin me fushën specifike të veprimtarisë së secilës ministri.

Intervistat gjysmë të strukturuar dhe diskutimet në grup arritën të përfshinin 123 persona gjithsej. Për shkak të kufizimeve nga pandemia COVID-19, intervistat iu dërguan me shkrim 40 përfaqësuesve të katër ministrive të linjës, prej të cilave 26 intervista u kthyen të përfunduara.

26 intervista gjysmë të strukturuar u zhvilluan me përfaqësues të katër ministrive të përfshira.⁵⁸ Ato u kryen me përfaqësues të institucioneve shtetërore që punojnë në disa çështje si: siguria, arsimit dhe çështjet sociale. Këto ministri dhe agjencitë në varësi të tyre janë institucionet kryesore të përfshira në zbatimin e SKLEDH-së. Intervistat synonin të zbulonin pikëpamjet dhe njohuritë e përfaqësuesve mbi bashkëpunimin ndërinstytucional për P/KEDH, dhe mbi rolin që strukturat qeveritare duhet të luajnë në zhvillimin dhe zbatimin e efektshëm të komunikimit strategjik. Hapi i fundit në procesin e mbledhjes së të dhënave përfshiu gjashtë diskutime në grup me 97 individë. Ato përbëheshin nga 50 mësues që janë koordinatorë të KEDH në shkollat e tyre përkatëse, 23 nxënës, 19 përfaqësues të ministrive dhe agjencive në varësi dhe pesë përfaqësues nga komunitetet fetare. Të dhënat e mbledhura përmes intervistave dhe diskutimeve në grup u përpunuan, koduan dhe analizuan duke përdorur programin softuer MAXQDA. Diskutimet në grup ofruan njohuri të dobishme mbi ndikimin e propagandës së EDH dhe rekomandime mbi qasjen e nevojshme për të trajtuar problemin.

Figura 3 më poshtë paraqet fazat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

⁵⁷ Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

⁵⁸ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Drejtësisë.




Figura 3. Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave

Procesi i hulumtimit u zhvillua në një mënyrë bashkëpunuese me përfaqësuesit e QKEDH-së të cilët nëpërmjet qasjes së të mësuarit-përmes-praktikës u përfshirë në të gjitha fazat e hulumtimit. Për më tepër, u zhvilluan tre seminare rreth metodave të hulumtimit dhe komunikimeve strategjike me stafin e QKEDH-së dhe stafin e katër ministrive të përfshira.

Kapitull V: Radikalizimi në Shqipëri: nxitësit, shkalla e përhapjes dhe përpjekjet për ta luftuar atë



Ndërsa seksioni III i këtij studimi "Termet dhe konceptet kryesore të përdorura në këtë studim" u përqendrua në literaturën dhe praktikën ndërkombëtare mbi fenomenet e radikalizimit dhe EDH, seksioni aktual eksploron tendencat e radikalizimit në Shqipëri. Bazuar në të dhëna empirike dhe studime të mëparshme mbi këtë temë, ky seksion trajton nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm fetar në Shqipëri si dhe qasjet dhe përpjekjet e Shqipërisë për ta trajtuar këtë çështje.

Ai fillon me një nënseksion për kontekstin fetar në Shqipëri, dhe vijon me një nënseksion mbi problemin e EDH dhe radikalizimit në Shqipëri. Nënseksioni i tretë përqendrohet posaçërisht në nxitësit e radikalizimit në vend, ndërsa nënseksioni i katërt shtjellon luftën ndaj EDH në vend. Nënseksioni vijues (i pestë) trajton përpjekjet e shtetit për riatdhesimin e LHT-ve, nënseksioni i gjashtë përqendrohet në "luftën e komunikimit" të EDH në Shqipëri dhe nënseksioni i shtatë trajton prirjet e radikalizimit në Bashkinë e Tiranës. Nënseksioni i fundit (i tetë) përmban një analizë të faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë dhe legjislativë (analiza PEST) në mënyrë që të ndihmojë për të kuptuar mjedisin në të cilin zhvillohet fenomeni i EDH në Bashkinë e Tiranës.

Feja në Shqipëri

Ky nënseksion i parë synon të shtjellojë të dhënat që kanë të bëjnë me demografinë, historinë dhe gjendjen aktuale të fesë në Shqipëri. Sipas censusit të fundit në vitin 2011, Shqipëria ka një popullsi prej 2.8 milionë njerëz, dhe komunitetet më të përhapura fetare janë myslimanët (57%), katolikët (10%), ortodoksët (7%) dhe bektashinjtë (2%).⁵⁹ Grupet e tjera fetare përfshijnë grupet protestante, grupin Bahá'í, Dëshmitarët e Jehovait, Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe një komunitet të vogël hebre.⁶⁰ Pavarësisht nga përbërja fetare, Vurmo dhe të tjerë argumentojnë në studimin *Toleranca Fetare në Shqipëri* se shumica e shqiptarëve jetojnë një jetë laike dhe kanë pak informacion ose njohuri për fenë dhe refuzojnë që konsideratat fetare të formojnë ose kushtëzojnë mënyrën e tyre të jetës.⁶¹ Autorët e studimit të mësipërm argumentojnë se bazat e tolerancës fetare në Shqipëri janë të rrënjosura thellë në traditat dhe kulturën shoqërore, dhe jo në informimin, dijen ose praktikën fetare. Pavarësisht kësaj, mund të thuhet se në lidhje me rolin e udhëheqësve fetarë në vend, situata e përgjithshme e tolerancës fetare në Shqipëri ka mbetur e qëndrueshme, sepse udhëheqësit fetarë u kanë bërë thirrje besimtarëve t'i shmangen konflikteve dhe t'i kushtojnë rëndësi mirëkuptimit dhe dialogut të ndërsjellë.⁶² Ndryshe nga vendet fqinje të cilat e kanë përdorur fenë si bazë për zhvillimin e identitetit të tyre kombëtar, shqiptarët, historikisht, nuk e kanë formësuar apo identifikuar identitetin e tyre kombëtar me

⁵⁹ Instituti i Statistikave, 2011. Instat. Aksuar në 24 qershor 2020.

<https://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

⁶⁰ United States Department of State (2020, June 10) 2019. Report on International Religious Freedom Albania.

<https://www.state.gov/reports/2019-report-on-international-religious-freedom/albania/>.

⁶¹ Gjergji Vurmo dhe të tjerë, "Toleranca Fetare në Shqipëri." Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018).

⁶² Po aty, 21-22.

përkatësinë e tyre fetare. Përkundrazi, baza e identitetit kombëtar shqiptar ka qenë gjuha, kultura dhe tradita. Duke qenë se në Shqipëri ekzistojnë katër fe kryesore, nëse identiteti kombëtar i Shqipërisë do të bazohej thjesht në fe, kjo do të ndizte një rivalitet të ashpër midis feve në vend.⁶³

Feja ka kaluar nëpër luhajtje të mëdha në Shqipëri. Shqipëria është një ish vend ateist, me një shumicë myslimane, por pa një fe zyrtare.⁶⁴ Që nga viti 1967 në Shqipëri u vendos një ndalim i plotë për të gjitha format e adhurimit fetar, si rezultat i të ashtuquajturit "Revolucioni Kulturor", duke e bërë kështu Shqipërinë të vetmin shtet të deklaruar zyrtarisht ateist në botë. Me përfundimin e sistemit njëpartiak, praktikimi i fesë u rikthye gradualisht në shoqërinë shqiptare.⁶⁵ Pasi u informuan rreth ndryshimeve politike dhe lejimin e praktikimit të fesë, misionarët e të gjitha besimeve u dyndën në Shqipëri dhe u përfshinë në procesin e "ringjalljes" fetare. Kjo çoi në një rikthim gradual të praktikës fetare, së bashku me restaurimin dhe rindërtimin e objekteve fetare. Gjatë kësaj periudhe filloi ndërtimi i shkollave myslimane dhe të krishtera, si dhe ofrimi i bursave⁶⁶ për fëmijët dhe të rinjtë që dëshironin të studionin jashtë shtetit lëndët e teologjisë myslimane ose të krishterë.⁶⁷ Që nga mesi i viteve 1990, mijëra shqiptarë të rinj myslimanë udhëtuan drejt Lindjes së Mesme falë këtyre bursave arsimore, të cilët pas shkollimit u rikthyen në Shqipëri me ideologji fetare që i përkasin shkollave të ndryshme të mendimit islam, ndryshe nga shkolla *hanefi*, e cila ka mbizotëruar tradicionalisht në Shqipëri dhe pjesën tjetër të Ballkanit.⁶⁸ Mungesa e burimeve materiale të aktorëve vendas, si dhe liria e veprimit, u dha aktorëve të huaj një rol të rëndësishëm, madje edhe brenda bashkësive fetare "tradicionale", duke qenë se këto bashkësi ishin në hapat e tyre të para të ringritjes. Për shembull, në fillim të viteve 1990, 90% e buxhetit të Komunitetit Islamik (tani Komuniteti Mysliman i Shqipërisë - KMSH) mbulohej nga burimet e huaja. I njëjti fenomen vërehej edhe te Komuniteti Ortodoks dhe Komuniteti Katolik, duke pasur parasysh që në vitin 1995 vetëm 14% e klerikëve katolikë që punonin në vend ishin shtetas shqiptarë.⁶⁹ Për më tepër, gjatë viteve të para të periudhës tranzitore 1992-1998, kur vendi përballlej me probleme të mëdha ekonomike - me shpresën për investime të huaja shtesë - qeveria e Shqipërisë bëri kërkesë për t'u bërë anëtare e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (OBI) në vitin 1992. Ndonëse feja nuk njihet si një nxitës i radikalizimit që çon në EDH,

⁶³ Arben Kullolli, *Proselytization in Albania by Middle Eastern Islamic Organizations*. Master's Thesis, Monterey, California: Naval Postgraduate School (2009)

⁶⁴ Nathalie Clayer, "God in the "Land of the Mercedes" The religious communities in Albania since 1990," Research, Paris: HAL (2007)

⁶⁵ Miranda Vickers, "Islam in Albania", Research, Shrivenham: Defence Academy of the United Kingdom (2008), pp. 1-2

⁶⁶ Për shembull, në vitin 2006 ishin 1, 357 studentë shqiptarë që studionin teologjinë islame në Turqi (350), Arabinë Saudite (350), Egjipt (206), Katar (120), Jemen (78), Liban (70), Malejzi (50), Siri (50), Libi (42), Jordani (20), Oman (17), dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (14). Sidoqoftë, këto janë vetëm numrat e studentëve që kaluan nëpër organizatat dhe jo një tregues i numrit real. Sipas Komitetit Shtetëror të Kulteve të asaj kohe, numri i vërtetë i studentëve shqiptarë që studionin në ato vende ishte shumë më i lartë. Shiko: Mentor Nazarko, 'Historical Background to the Muslim Community in Albania', paper presented at the NATO Advanced Research Workshop: Strengthening and Promoting Religious Tolerance and Co-existence in the Balkans and Beyond, Tirana, September – October 2006, p 3-4.

⁶⁷ Po aty. 1-2

⁶⁸ Po aty. 3

⁶⁹ Nathalie Clayer, "God in the "Land of the Mercedes", The religious communities in Albania since 1990". Research, Paris: HAL (2007) pp. 14-15

keqinformimi dhe/ose shfrytëzimi i fesë për përfitime politike është vërtetuar si nxitës. Në këtë kontekst, nënseksioni vijues trajton shfrytëzimin e fesë për qëllime politike, historinë dhe statusin aktual të EDH, si dhe shkallën e radikalizimit në Shqipëri.

Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi në Shqipëri

Format jo-tradicionale të Islamit u futën në vend pas përfundimit të sistemit njëpartiak. Anëtarësimi i Shqipërisë në OBI u hapi dyert shumë organizatave jo-qeveritare (OJQ) nga vende të ndryshme myslimane, disa prej të cilave u përpoqën ta përdorin këtë mundësi për promovimin e interpretimeve jotradicionale të islamit⁷⁰ nën një “kamufli humanitar.” Gjashtë OJQ kryesore të lidhura me terrorizmin u vendosën në Shqipëri midis viteve 1991 dhe 2005 pa u vënë shumë re nga qeveria.⁷¹ Në vijim, operacionet e suksesshme kundër terrorizmit nga qeveria shqiptare, të realizuara me mbështetjen e shteteve perëndimore, i dhanë fund aktiviteteve të këtyre OJQ-ve.⁷² Në këtë mënyrë u frenua ideologjia e EDH së bashku me mundësinë e pjesëmarrjes së LHT-ve shqiptarë në luftërat ballkanike. Si rezultat i kësaj dinamike historike, mund të thuhet se radikalizimi islamik nuk përbën një fenomen me rrënjë shqiptare.⁷³

Sipas raportit të vitit 2019 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, 144 shtetas shqiptarë iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak, 45 janë rikthyer, 28 besohet se kanë ndërruar jetë dhe 81 janë akoma në fushën e betejës.⁷⁴ Në tetor të vitit 2020 Shqipëria arriti të riatdhesojë katër fëmijë dhe një grua nga kampi i al-Hol në Sirinë veri-lindore, i cili kontrollohet nga forcat kurde. Procesi i riatdhesimit i rreth 75 shtetasve të mbetur është në vijim.⁷⁵

Propaganda në internet, e prodhuar nga makineria e propagandës të ISIS-it, ka luajtur një rol qendror në nxitjen e shtetasve shqiptarë për të luftuar në konfliktin sirian, dhe në disa raste kjo propagandë ka synuar të tërheqë audiencën shqipfolëse duke përzier mesazhet fetare me

⁷⁰ Interpretimet jo-tradicionale të islamit fituan terren në Shqipëri dhe disa vjet më vonë (në vitin 2004) ato çuan në një tentativë nga myslimanët e rinj të arsimuar në universitet jashtë vendit (ku dominon shkolla islame *selefi*) për të propozuar ndryshimin e riteve fetare brenda komunitetit musliman nga shkolla islame *hanefi* në shkollën *selefi* e cila është më radikale. Neni 2 i Statutit të Komunitetit Mysliman përcakton qartë se linja *hanefi* është në traditën shqiptare. Për më shumë shih (Vickers 2008) fq. 6-7.

⁷¹ Arben Kullolli, “Proselytization in Albania by Middle Eastern Islamic Organizations”. Master's Thesis, Monterey, California: Naval Postgraduate School (2009), pp. 42-47

⁷² Po aty. 45-47

⁷³ Endri Hide, “Vlerësimi i rrezeve ndaj sigurisë kombëtare/ aftësia e shtetit dhe shoqërisë për të reaguar: Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi Fetar në Shqipëri,” Raport Vlerësimi, Tiranë: Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (2015), fq. 8-9.

⁷⁴ European Commission, Albania 2019 Report: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>. Clarification: The authors of this study have updated the numbers reported in the EC 2019 report, after the first group of (five) people who were repatriated by Albania on late October 2020 and a woman (MD) was reported dead.

⁷⁵ Voice of America, “Albanian IS Repatriation From Syria Will Be Long Journey, Experts Say” <https://www.voanews.com/extremism-watch/albanian-repatriation-syria-will-be-long-journey-experts-say>

propagandën e ISIS-it.⁷⁶ LHT-ja i parë shqiptar (një ish komando) iu bashkua konfliktit sirian në fillim të vitit 2011, por pjesa më e madhe e LHT-ve udhëtuan drejt Sirisë në vitet 2012 dhe 2013, me rastet përfundimtare në vitin 2014. Periudha e largimit të tyre, e cila është para krijimit të fraksioneve kryesore terroriste, tregon se qëllimi i tyre kryesor ishte të luftonin vullnetarisht kundër regjimit sirian. Gjatë kësaj kohe u bënë disa përpjekje për të portretizuar luftën në Siri si Lufta Civile në Spanjë, dhe në këtë mënyrë ndërtoheshin paralele midis Bashar al-Assad dhe Francisco Franco si një mënyrë për t'i bindur njerëzit që duke shkuar në Siri do të bënin të njëjtën gjë që bënë vullnetarët shqiptarë në vitet 1930 në Spanjë. Për më tepër, disa nga hoxhallarët e burgosur deklarojnë se kryeministri shqiptar i asaj kohe (2012) bëri thirrjen e parë për të shkuar dhe për të ndihmuar popullsinë siriane,⁷⁷ dhe sipas tyre, vetëm për këtë arsye ata nuk mund të akuzohen për një krim të tillë.

Ndërsa konflikti u përshkallëzua dhe opozita siriane u nda në grupe të ndryshme, shqiptarët e gjetën veten duke luftuar për organizata terroriste të tilla si ISIS, Fronti al-Nusra dhe Jaysh al-Islam,⁷⁸ ndonjëherë duke luftuar edhe kundër njëri-tjetrit.⁷⁹ Rreth gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve shqiptarë që iu bashkuan luftës në Siri dhe Irak ishin praktikues të së njëjtës xhami në Tiranë, e cila është jashtë juridiksionit të KMSH, i cili është i vetmi institucion zyrtar në vend që përfaqëson Islamin.⁸⁰ Në vitet e para të rekrutimit, LHT-të shqiptarë besohet të jenë rekrutuar kryesisht në terren, përfshirë edhe në xhami, përmes një grupi rekrutimi prej nëntë personash, të cilët më vonë u burgosën. LHT-të që shkuan për të luftuar në Siri dhe më pas u rikthyen zbuluan se një nxitës i madh për të ndërmarrë vendimin për t'iu bashkuar konfliktit sirian ishin videot dhe pamjet që ata kishin parë në internet.⁸¹ Atyre iu treguan video se si "vëllezërit" dhe "motrat" myslimane vuanin në Siri dhe iu ishin bërë thirrje për t'i ndihmuar ata.

Pas humbjes së kapacitetit të ISIS-it për të rekrutuar në terren në Shqipëri, grupi vazhdoi të rekrutonte në internet, me synimin për të tërhequr audiencën duke përzier mesazhet fetare me propagandën e ISIS-it.⁸² Kjo tendencë reflektohet gjithashtu edhe tek ekstremistët e dhunshëm në Evropë të cilët janë kryesisht të lidhur nëpërmjet rrjeteve të lira të cilat janë më së shumti të vetë-ndërtuara dhe pa lidhje organizative me grupe terroriste si al-Kaeda ose ISIS. Përveç kësaj, disa

⁷⁶ Counter Extremism Report, "Albania: Extremism and Counter-Extremism," Report, New York: Counter Extremism Project (2017).

⁷⁷ Shqiptarja.com, "Imamët e burgosur: Ne u frymëzuam nga Kryeministri," 18 janar 2018. Aksesuar në 4 korrik 2020. <https://shqiptarja.com/lajm/n-euml-burg-p-euml-r-terroriz-euml-m-kuzhinieri-br-u-frym-euml-zuam-nga-berisha-t-euml-vij-euml-n-euml-gjyq-br>.

⁷⁸ Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, "Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri" Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation (2018).

⁷⁹ Telegrafi.com, "Shqiptarët në Siri dhe Irak po vrasin njëri tjetrin" 23 tetor 2014. Aksesuar në 24 qershor 2020. <https://telegrafi.com/shqiptaret-ne-siri-dhe-ne-irak-vrasin-njeri-tjetrin/>

⁸⁰ Counter Extremism Report, "Albania: Extremism and Counter-Extremism," Report, New York: Counter Extremism Project (2017). Shih edhe: Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, "Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri" Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation (2018), fq. 1-2.

⁸¹ Po aty.,

⁸² Po aty.,

individë ose grupe të vogla janë vetë-radikalizuar, kryesisht në internet, pa qenë pjesë e rrjeteve më të gjera.⁸³

Sipas raportit të vitit 2019 të Komisionit Evropian⁸⁴ përmbajtja e radikalizimit në gjuhën shqipe në internet është në rritje.⁸⁵ Si rezultat i kësaj, raporti i KE-së i bën thirrje autoriteteve të rrisin kapacitetet e monitorimit dhe përgjigjes në internet, si dhe të rrisin përpjekjet për të fuqizuar shoqërinë civile për të zhvilluar narrativa pozitive dhe alternative në internet.⁸⁶ Edhe studimet rajonale të kryera në Ballkanin Perëndimor (BP) i rekomandojnë institucioneve të vendit që t'i kushtojnë më shumë vëmendje rrjeteve sociale dhe të krijojnë platforma ku qytetarët mund të adresojnë probleme ose të raportojnë profile që lidhen me propagandën apo ekstremistët e dhunshëm në komunitetet e tyre.⁸⁷ Ndonëse shfrytëzimi i fesë njihet si një nxitës i radikalizimit, tërësia e procesit të radikalizimit është komplekse dhe përfshin një kombinim të faktorëve, të cilët kur zbatohen në një kontekst specifik, mund t'i bëjnë individët e cenueshëm lehtësisht të rekrutueshëm nga ekstremistët e dhunshëm. Në këtë kontekst, nënseksioni i mëposhtëm shqyrton disa nxitës të njohur të radikalizimit në Shqipëri.

Nxitësit e radikalizimit në Shqipëri

Siç u shpjegua më herët në këtë përmbledhje, Shqipëria renditet si vendi i tretë në BP me numrin më të lartë të LHT-ve bazuar në popullsinë e përgjithshme, dhe si eksportuesi më i ulët i LHT-ve bazuar në rekrutimet mes popullatës myslimane.

Janë kryer disa studime mbi nxitësit e radikalizimit të qytetarëve shqiptarë. Një studim i vitit 2015 i ndan këta nxitës në katër grupe:⁸⁸ (a) nxitësit social-ekonomikë – aksesit i kufizuar në punësim, përjashtimi dhe diskriminimi; (b) nxitësit politikë - pamundësia për të ndikuar në vendimmarrjen që perceptohet si e korruptuar dhe e padrejtë, mbrojtja e vlerave dhe dinjitetit fetar konsiderohet

⁸³ Europol, "European Union Terrorism Situation and Trend Report 2020" Report, The Hague: Europol (2020), pp. 33-34.

⁸⁴ Commission, European, "Commission Staff Working Document," Working Document, Strasbourg: European Commission (2019).

⁸⁵ Interneti mund të zmadhojë mundësitë për t'u radikalizuar, për shkak të të qenit i aksesueshëm për një numër të madh njerëzish, pavarësisht nga gjinia ose përkatësia etnike, duke u mundësuar atyre të lidhen me individë me mendime të njëjta nga e gjithë bota. Ky akses mund të ofrojë më shumë mundësi se jashtë internetit për të konfirmuar besimet ekzistuese dhe për të shmangur ballafaqimin me informacionin që do t'i sfidonte ato. Hipoteza që interneti funksionon si një (echo chamber) dhomë jehonë (Ines von Behr et al 2013). Interneti duhet të shihet më shumë si një mënyrë sesa si një metodë unitare e radikalizimit - prandaj, interneti mund të luajë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit të radikalizimit - megjithatë - nuk mund ta kryejë atë i vetëm. Një rast i fundit nga Shqipëria është një 39-vjeçar nga Shijaku i cili u arrestua në 25 Qershor 2020 për "nxitje të urrejtjes dhe thirrje për akte terroriste" pasi ai shpërndau disa postime në llogarinë e tij në Facebook me mbishkrimin "Vritni Hebrenjtë". Për më shumë shih: <https://www.asp.gov.al/drejtoria-e-antiterrorit-vihet-ne-pranga-nje-39-vjecar-i-cili-bente-thirrje-ne-rrjetet-sociale-per-te-vrare-hebrenjte/>

⁸⁶ European Commission. Commission Staff Working Document, Working Document, Strasbourg, (2019).

⁸⁷ Kelmendi, V and Sh. Balaj. New Battlegrounds: Extremist Groups' Activity on Social Networks in Kosovo, Albania and FYROM. Prishtina: Kosovar Center for Security Studies, (2017), pp.24.

⁸⁸ Gjergji Vurmo dhe të tjerë, "Radikalizmi Fetar në Shqipëri" Raport Studimor. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim Tiranë, (2015).

si një detyrë, si dhe shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut; (c) nxitësit kulturorë - një e treta e të anketuarve në studimin në fjalë deklarojnë se dinjiteti i komunitetit të tyre fetar është nën kërcënim të vazhdueshëm dhe se është e vështirë të jesh praktikant mysliman në Shqipëri; dhe e fundit (d) nxitës specifikë për Shqipërinë - më shumë se një e katërta e të anketuarve të studimit në fjalë shfaqen tolerantë ndaj objekteve fetare të paautorizuara, të cilat sipas hulumtimeve janë kryesisht ato objekte ku zhvillohet rekrutimi, dhe një nxitës tjetër është mungesa e ndikimit dhe përgatitjes së klerikëve lokalë.⁸⁹ Ky studim hedh dritë mbi rolin pasiv të shumicës së institucioneve shtetërore në parandalimin e radikalizimit fetar. Në këtë drejtim, autorët e studimit të vitit 2015 argumentojnë se vetëm në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014 debati publik mbi këtë çështje u intensifikua dhe veprimet e autoriteteve shtetërore (kryesisht të sigurisë) evoluuan më tej. Sidoqoftë, përgjigjja e shtetit ka qenë e kufizuar në agjencitë ligjzbatuese kryesisht përmes masave prapavepruese dhe shtrënguese. Sipas këtij studimi, përfshirja në masa parandaluese ndaj këtij fenomeni duhej të ishte kryer nga institucionet e tjera shtetërore, të tilla si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Mirëqenies Sociale, inspektoratet shtetërore dhe ato të shërbimeve, qeveritë lokale, drejtoritë arsimore rajonale dhe të tjerë. Autorët e këtij studimi zhvilluan disa intervista me përfaqësuesit e institucioneve të sipërpërmendura në atë kohë, të cilët tregojnë se radikalizmi ose EDH mbi baza fetare nuk ka qenë në fokusin e punës së tyre.⁹⁰

Në vitin 2018, një studim tjetër rikonfirmoi rolin pasiv të institucioneve shtetërore.⁹¹ Çështja e mosveprimit të shtetit u përmend si një faktor mundësues që iu dha LHT-ve mundësinë për të shkuar drejt zonave të konfliktit si Siria dhe Iraku. Studimi zbulon disa probleme në këtë drejtim, të tilla si: (a) mungesa e konsolidimit të pranisë së shtetit - e cila është thelbësore për parandalimin ose mbrojtjen e individëve nga rekrutimi i grupeve radikale dhe të ekstremizmit të dhunshëm; (b) institucionet 'apatike' të sigurisë - mungesa e vlerësimit të duhur të nivelit të kërcënimit dhe reagimi i ngadaltë, të cilat bënë që shumë njerëz të besonin se mund të largoheshin nga vendi për të luftuar në Siri pa pasoja; (c) institucione joefikase - bashkitë nuk duket se po ndërmarrin hapa proaktivë për uljen e rrezikut të EDH në komunitetet e tyre; dhe (d) korrupsioni dhe pandëshkueshmëria - këto janë faktorë të cenueshmërisë që mund të nxisin mosangazhimin qytetar dhe apatinë politike; dhe që mund të nxisin më tej ndjenjën e zemërimit moral.⁹² Narrativa mbizotëruese mbi faktorët 'shtytës' të radikalizimit për shumë vite ka vënë në pah mungesën e mundësive ekonomike ose kërkimin e përfitimeve financiare. Sidoqoftë, kohët e fundit kjo është hedhur poshtë si nxitësi kryesor i rekrutimit. Nuk ka asnjë lidhje reciproke të qartë midis statusit social-ekonomik dhe demografisë së të rinjve me gjasat e tyre për t'u radikalizuar.⁹³ Ekzistojnë

⁸⁹ Po aty. 38-106

⁹⁰ Po aty. 35

⁹¹ Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, "Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri" Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation (2018)

⁹² Po aty. 21-22

⁹³ Richardson, Berlouis and Cameron, "Radicalization of Young Adults in the Balkan States," Dundee: JD Journal for Deradicalization, pp. 88-89. See also: <https://www.ssoar.info/ssoar/handle/document/61467> and <https://journals.plos.org/plosone/article?id=10.1371/journal.pone.0090718>

faktorë të tjerë, siç janë përfshirja e pamjaftueshme politike, përfaqësimi i dobët dhe mungesa e kanaleve për angazhimin politik, të kombinuara me anominë institucionale (mungesa e aftësisë së shtetit për të ndikuar në jetën e njerëzve) të cilat konsiderohen si faktorë më të rëndësishëm për t'u angazhuar në EDH, veçanërisht për të rinjtë.⁹⁴

Në mënyrë të veçantë, autorët e studimit të vitit 2015 këshillojnë që t'i kushtohet vëmendje "makinerisë" (radikalizimit) së fenomenit dhe jo thjesht "pasojave" (LHT-ve).⁹⁵ Një studim tjetër arrin në të njëjtin përfundim, duke theksuar se fluksi i LHT-ve nuk ishte fillimi i radikalizimit, por më tepër rezultati i një procesi të gjatë. Megjithatë, ky fluks shërbeu për të ilustruar se si rritja e radikalizimit të brendshëm kishte ndodhur pa u vënë re dhe se si qasja e përgjithshme e politikës së Shqipërisë ishte e keqpërgatitur për t'u përballur me natyrën evoluese të kërcënimeve terroriste.⁹⁶ Studimi i parë arriti në përfundimin se nxitës të ndryshëm bashkëveprojnë dhe forcojnë njëri-tjetrin dhe kur këta nxitës të ndryshëm bashkohen, ata promovojnë agjenda fetare proaktive të grupeve radikale.⁹⁷

Një tjetër studim i vitit 2018⁹⁸ rikonfirmoi praninë e ideologjive ekstremiste fetare dhe paralajmëron se gjendja e demokracisë dhe e zhvillimit social-ekonomik në vend, në kombinim me faktorë të tjerë, mund të kërcënojë grupe specifike në shoqëri përmes fuqisë së manipulimit të ideologjive ekstremiste.⁹⁹ Sipas këtij studimi, radikalizimi është me të vërtetë një fenomen shumëdimensional që shfaqet nga ndërveprimi i ideologjive radikale dhe dinamikës sociale dhe që formohet nga faktorë më të mëdhenj strukturorë.¹⁰⁰ Është zhvilluar një sondazh që eksploron opinionin publik rreth EDH, i cili pyeti të anketuarit mbi faktorët kryesorë që mundësojnë ose inkurajojnë radikalizimin fetar të individëve (Shih tabelën 2). Ky sondazh tregon se faktorët kryesorë janë (a) arsimiti i ulët (b) arsyet ekonomike dhe (c) njohuritë e cekëta fetare.

⁹⁴ Engjellushe Morina, Beatrix Austin, Tim Jan Roetman and Véronique Dudouet, "Community Perspectives on Preventing Violent Extremism: Lessons from the Western Balkans," Research Report, Berlin: Berghof Foundation (2019).

⁹⁵ Gjergji Vurmo dhe të tjerë, "Radikalizmi Fetar në Shqipëri" Raport Studimor. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim Tiranë (2015).

⁹⁶ Mandrit Kamolli dhe Arjan Dyrmishi, "Qasja e Shqipërisë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kuadrin e BE-së. Dokument Politikash, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (2018), fq. 32-33.

⁹⁷ Po aty. 114

⁹⁸ Gjergji Vurmo dhe Enis Sulstarova, "Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri," Raport Studimor, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018)

⁹⁹ Po aty. 11-12

¹⁰⁰ Po aty. 113-114

Faktorët	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Arsimi i ulët	1,030	67%
Arsye ekonomike	947	62%
Njohuritë e cekëta fetare	626	41%
Izolimi social	557	36%
Ndikimi i grupeve radikale fetare të huaja	415	27%
E shkuara kriminale	365	24%
Institucione shtetërore të paafta	285	18.5%
Klerikë fetarë të paaftë	230	15%

Tabela 2: Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri 2018.¹⁰¹

Studimi zbulon se një kombinim i faktorëve strukturorë dhe individualë dhe variabla të tjera - të tilla si roli i klerikëve vendas dhe aftësitë e tyre - gjenerojnë procese individuale të radikalizimit. Studimi arriti në përfundimin se bashkëveprimi i nxitësve social-ekonomikë, politikë, kulturorë dhe çështje të tjera specifike të kontekstit sfidojnë realitetin aktual shqiptar.¹⁰² Një studim tjetër i vitit 2018¹⁰³ hedh dritë mbi faktorët dhe aktorët që i bëjnë komunitetet të qëndrueshme ose të cenueshme ndaj EDH dhe ndërveprimin e tyre me njëri-tjetrin. Ndryshe nga shumica e literaturës që përqendrohet në faktorët shtytës dhe tërheqës dhe nxitësit e përgjithshëm të EDH, ky studim shqyrtoi ndryshimet midis komuniteteve të prekura dhe të paprekura, si dhe identifikoi aktorët dhe faktorët në tre qytete: Tiranë, Korçë dhe Kavajë. Secili komunitet ka kontekst të ndryshëm dhe zbatimi i një qasje "një i përshtatet të gjithave" është mjaft e përgjithshme. Prandaj, ky studim sugjeron se nëse vihet theksi në qasjet e përqendruara në komunitet, së pari kuptohet se dobësitë janë koherente brenda secilit komunitet dhe problemet lokale kërkojnë zgjidhje lokale, dhe së dyti, hulumtimi ndihmon në zhvillimin e qasjeve komunitare, të orientuara drejt qeverisjes lokale për forcimin e qëndrueshmërisë ndaj EDH. Autorët i kanë grupuar gjetjet në tre kategori: ideologjike, social-ekonomike dhe strukturore dhe i kanë ndarë ato në faktorë dhe aktorë që favorizojnë cenueshmërinë dhe faktorë dhe aktorë që favorizojnë qëndrueshmërinë (Shih tabelën 3).

¹⁰¹ Shënim: Kjo është një pyetje ku mund të zgjidhen disa përgjigje dhe përqindjet kur mblidhen nuk kanë shumën 100%. Numri i rasteve është 4,455, numri i përgjigjeve është 1,538.

¹⁰² Po aty. 117-118

¹⁰³ Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, "Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri" Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation (2018)

	Faktorët dhe aktorët që favorizojnë cenueshmërinë	Faktorët dhe aktorët që favorizojnë qëndrueshmërinë
Ideologjikë	Identiteti dhe ideologjia Arsimimi (i përgjithshëm ose fetar) jo i duhur ose mungesa e tij Keqinformimi nëpërmjet propagandës fetare Radikalizimi në internet	Vlerat e shëndosha qytetare Edukimi fetar për të ndërgjegjësuar Kultura e përbashkët
Social-ekonomikë	Veçimi, marginalizimi, izolimi, diskriminimi Privimi ekonomik dhe mungesa e mundësive Krijimi i rrjeteve sociale	Lidhja/kohezioni social Mundësitë e barabarta
Strukturorë	Perceptimet e qeverisjes së dobët Mungesa e konsolidimit të pranisë shtetërore Institucionet apatike të sigurisë Institucionet joefikase Korrupsioni dhe pandëshkueshmëria Tensionet brenda fesë	Bashkëpunimi i rritur me institucionet Angazhimi komunitar

Është zbatuar në të tre komunitetet: Tiranë, Korçë dhe Kavajë

Tabela 3. Faktorët dhe aktorët që favorizojnë cenueshmërinë dhe faktorët dhe aktorët që favorizojnë qëndrueshmërinë.¹⁰⁴

Duke analizuar faktorët dhe aktorët e qëndrueshmërisë dhe cenueshmërisë brenda një komuniteti, ky studim arriti në disa përfundime: (a) qëndrueshmëria është një spektër dhe sistemik, ndërsa radikalizimi ndaj EDH është një proces që varet kryesisht nga niveli i qëndrueshmërisë; (b) të dy faktorët që favorizojnë dhe parandalojnë EDH janë prezentë në të dy komunitetet si ata të qëndrueshëm dhe ata të cenueshëm, megjithatë, ka faktorë të tjerë të cilët shkaktojnë cenueshmëri në disa komunitete të rrezikuara; (c) është e rëndësishme të bëhet dallimi midis paprekshmërisë dhe qëndrueshmërisë, pavarësisht se ato mbivendosen dhe janë të ndërlidhura, prekmëria i referohet shenjave të dukshme të EDH, ndërsa qëndrueshmëria i referohet aftësisë për të parandaluar, shmangur dhe reaguar ndaj kërcënimeve përmes masave kolektive; (d) EDH shfaqet në pikën ku bashkohen ideologjia, zemërimi dhe mundësitë, ndikimi i të cilave për t'u bërë një ekstremist i dhunshëm mund të shmanget kryesisht përmes kohezionit shoqëror, forcimit të vlerave qytetare, rritjes së bashkëpunimit midis aktorëve të komunitetit dhe përmirësimit të performancës institucionale; dhe e fundit (f) ekzistenca e faktorëve që favorizojnë qëndrueshmërinë mund të forcojë komunitetet dhe t'i parandalojë ato të preken edhe në rastet kur faktorët e cenueshmërisë janë të pranishëm, sidomos në prani të angazhimit proaktiv nga aktorët që promovojnë qëndrueshmërinë.¹⁰⁵ Përballë sfidës së EDH dhe nxitësve që e mundësojnë atë, qeveria e Shqipërisë ndërmoi masa ligjore, institucionale dhe masa të tjera përkatëse për të

¹⁰⁴ Burimi: Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri, Berghof Foundation, 2018

¹⁰⁵ Po aty. 27-30

luftuar përhapjen e radikalizimit dhe EDH në vend. Nënseksioni i mëposhtëm synon të ofrojë një përmbledhje të përpjekjeve të qeverisë së Shqipërisë në luftën kundër EDH.

KEDH në Shqipëri

Pas rritjes së fenomenit të LHT-ve, qeveria e Shqipërisë ndërmoi masa ligjore dhe institucionale. Në fillim të vitit 2014, qeveria ndryshoi kodin penal, veçanërisht Nenin 265/a "Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj"; Nenin 265/b "Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj" dhe Nenin 265/c "Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj."¹⁰⁶ Si rezultat i këtyre ndryshimeve, në mars të vitit 2015, Shqipëria arriti të shpërbëjë një rrjet prej nëntë personash rekrutues të LHT-ve. Anëtarët u arrestuan me akuzën e nxitjes së akteve të terrorizmit dhe pas një gjykimi një vjeçar grupi u dënua me një total prej 126 vitesh burgim.¹⁰⁷

Shqipëria ishte ndër vendet e para në rajon që miratoi një Strategji Kombëtare për të Luftuar Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Planin e saj të Veprimit (SKLEDH).¹⁰⁸

SKLEDH-ja është dokumenti kryesor i politikave ndaj P/KEDH dhe përcakton katër objektiva strategjike:¹⁰⁹

- Forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, midis agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe medias në hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive në KEDH;
- Nxitja e hulumtimit lokal për të përmirësuar të kuptuarit e kushteve, faktorëve dhe nxitësve të radikalizimit drejt dhunës, si dhe niveleve ekzistuese të qëndresës së komunitetit ndaj EDH;
- Ndërtimi i qëndresës së komunitetit dhe ngushtimi i terrenit për radikalizim dhe EDH përmes programeve dhe politikave të përshtatura për komunitetin në fushën e arsimit, punësimit dhe policimit në komunitet;
- Zvogëlimi i ndikimit të propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit në internet duke përdorur mediat sociale për zhvillimin dhe dërgimin e mesazheve alternative pozitive.

Për të arritur këto objektiva strategjike, SKLEDH-ja parashikon tre përparësi dhe dhjetë masa (tabela 4).

¹⁰⁶ Republika e Shqipërisë, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare (2017), fq. 165-166

¹⁰⁷ Counter Extremism Report, "Albania: Extremism and Counter-Extremism," Report, New York: Counter Extremism Project (2017)

¹⁰⁸ Këshilli i Ministrave, "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit," Vendim i Këshillit të Ministrave, Tiranë: Fletorja Zyrtare (2015)

¹⁰⁹ Strategjia Kombëtare për Luftën ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (2015) https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/strategjia_kombetare_per_luften_kunder_ekstremizmit.pdf

Përparësia 1 Shtirirja dhe angazhimi në komunitet	Përparësia 2 Lufta kundër propagandës së ekstremizmit të dhunshëm, së bashku me përhapjen e vlerave demokratike	Përparësia 3 Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së
1. Nxitja e mendimit kritik, pjesëmarrjes civile dhe përhapja e vlerave të tolerancës përmes arsimit. 2. Trajtimi i nxitësve social-ekonomikë të radikalizimit përmes arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe shërbimeve të punësimit. 3. Ndërtimi i besimit dhe besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet. 4. Fuqizimi i shoqërisë civile për të ndërtuar qëndresën e komunitetit.	5. Propozimi i një strategjie komunikimi krijuese dhe novatore, si plotësuese e SKLEDH-së. 6. Ndikimi i qëndrimeve dhe sjelljeve karshi ekstremizmit të dhunshëm, me anë të fushatave të përshtatura në kontekst dhe nismave të tjera komunikuese.	7. Zhvillimi i njohurive dhe ekspertizës kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes rritjes së ndarjes së informacionit. 8. Rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe punonjësve të vijës së parë. 9. Vlerësimi i politikave të KEDH-së: zbatimi dhe ndarja e mësimeve të nxjerra. 10. Zhvillimi i partneriteteve në nivelet rajonale dhe ndërkombëtare.

Tabela 4. Përparësitë dhe masat e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015

Një veprim tjetër ishte ngritja e QKEDH-së, e cila është përgjegjëse për koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë dhe praktikuesve të vijës së parë, të përfshirë në përpjekjet për të luftuar EDH në Shqipëri dhe rajon, duke ndarë praktikat më të mira dhe duke zhvilluar masa të bazuara në dëshmi efektive për të luftuar kërcënimet nga EDH. QKEDH u krijua në përpunje me vendimin e Këshillit të Ministrave 737 në dhjetor 2017, si një entitet juridik publik.¹¹⁰ QKEDH-ja (e reformuar) po punon me ministri të ndryshme të linjës dhe autoritetet lokale për zbatimin e SKLEDH-së. QKEDH-së duhet t'i sigurohet fondet e mjaftueshme, stafi dhe mbështetja politike për të kryer detyrat e saj në mënyrë efektive.¹¹¹ QKEDH-ja synon të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në nivele të ndryshme koordinimi dhe përveç institucioneve zyrtare qendrore dhe lokale ajo synon të bashkëpunojë me aktorët lokalë që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me të. Për këtë qëllim, QKEDH-ja bashkëpunon me rrjete të bazuara në fusha me interes si Rrjeti i Shoqërisë Civile, Rrjeti i Komuniteteve Fetare, Rrjeti i Gazetarëve; Rrjeti i Grave, Rrjeti i të Rinjve, Rrjeti i Studuesve, dhe Rrjeti i Komunitetit të Biznesit.¹¹²

¹¹⁰ Counter Extremism Report, "Albania: Extremism and Counter-Extremism," Report, New York: Counter Extremism Project (2017)

¹¹¹ European Commission, Commission Staff Working Document. Working Document, Strasbourg: European Commission (2019), pp. 38

¹¹² Mandrit Kamolli dhe Arjan Dyrmishi, "Qasja e Shqipërisë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kuadrin e BE-së. Dokument Politikash, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (2018) fq. 28-29.




Figura 4: Qasja Strukturore e QKEDH-së në Shqipëri

QKEDH-ja ka arritur rezultate të mira në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve lokale, zhvillimit të një rrjeti të palëve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në veprimet e P/KEDH, dhe zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë. Sidoqoftë, QKEDH-ja ka treguar kujdes në zhvillimin e kapaciteteve të saj në lidhje me zbatimin e Masave 5 dhe 6 nën Prioritetin numër dy të Strategjisë, përkatësisht: “Propozimi i një strategjie komunikimi krijuese dhe novatore si plotësuese e Strategjisë Kombëtare”, dhe “Ndikimi i qëndrimeve dhe sjelljeve karshi ekstremizmit të dhunshëm, me anë të fushatave të përshtatura në kontekst dhe nismave të tjera komunikuese.”

Këto dy masa janë cilësuar gjerësisht si objektivat strategjike të komunikimit për të parandaluar dhe luftuar EDH. Megjithëse QKEDH-ja ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, veprimi specifik është i nevojshëm për të adresuar sfidat e nevojshme në disa zona të nxehta të identifikuara, ku mosmarrëveshjet e bazuara në fe kanë nxitur dhe mund të kenë frymëzuar incidente. Një studim¹¹³ konfirmon se për pjesën më të madhe qeveria e Shqipërisë ka luajtur një rol monitorues dhe bashkëpunues, megjithatë, mungesa e shkëmbimit të njohurive me komunitetet lokale ka qenë e theksuar. Për shembull, megjithëse është diskutuar shpesh në literaturë rreth faktorëve që ndikojnë në EDH, disa nga komunitetet dhe institucionet lokale shqiptare, tre ose katër vite pas shfaqjes së fenomenit të LHT-ve ende duket se e kanë lënë çështjen

¹¹³ Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, “Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri” Raport studimor, Berlin: Berghof Foundation. fq. 24-25

afër fundit në listën e prioriteteve.¹¹⁴ Ai gjithashtu tregon se një fushë tjetër me përparësi e qeverisë shqiptare është propozimi i një strategjie krijuese dhe novatore komunikimi për të plotësuar Strategjinë Kombëtare. Megjithatë, pak është bërë për të angazhuar aktorë të ndryshëm si zyrtarët shtetërorë, akademikët, median dhe kompanitë e teknologjisë, shoqërinë civile, komunitetet fetare dhe punonjësit socialë.¹¹⁵ Ndërgjegjësimi rreth strategjisë dhe rreziqeve nga EDH është përgjithësisht i ulët. Edhe pse SKLEDH-ja sugjeron zhvillimin e sistemeve dhe protokolleve të shkëmbimit të informacionit për të arritur parandalimin më efektiv të EDH, institucionet shtetërore ngurrojnë të ndajnë informacione me OSHC-të ose aktorët e tjerë. Për më tepër, këto dhëna shpesh nuk ndahen edhe midis njësive të ndryshme të të njëjtit institucion.¹¹⁶ Kur Qeveria e Shqipërisë filloi përpjekjet KEDH, 145 qytetarë, duke përfshirë fëmijë dhe gra, ishin larguar nga vendi për t'iu bashkuar luftës në Siri. Në këtë fushë, qeveria duhej të punonte drejt përpjekjeve për riatdhesimin e qytetarëve të tij (kryesisht gratë dhe fëmijët) të cilët ishin bllokuar në Siri, pasi lufta civile siriane mori fund me rënien e ISIS-it. Nënseksioni vijues shqyrton përpjekjet e riatdhesimit të qytetarëve të Shqipërisë.

Përpjekjet e riatdhesimit nga Qeveria e Shqipërisë

Për sa i përket riatdhesimit të shtetasve shqiptarë në Siri, qeveria e Shqipërisë ka një vendim politik për kthimin e grave dhe fëmijëve nga zonat e konfliktit në Siri.¹¹⁷ Sidoqoftë, publikut nuk i është ofruar mjaftueshëm informacion për shkak të konfidencialitetit të çështjes dhe pavarësisht shprehjes së vazhdueshme të gatishmërisë për t'i kthyer personat nga Siria, asgjë konkrete nuk ishte arritur deri më 27 tetor 2020,¹¹⁸ kur shteti shqiptar riatdhesoi një grua dhe katër fëmijë nga kampi al-Hol, i kontrolluar nga kurdët në Sirinë veri-lindore. Procesi i riatdhesimit të rreth 75 shtetasve të mbetur është në vijim.¹¹⁹ Koordinatori Kombëtar i QKEDH-së në Shqipëri thekson se qeveria ka gjithçka gati për pritjen dhe riintegrimin e të rikthyerve.¹²⁰

¹¹⁴ Po aty. pp. 23

¹¹⁵ Po aty. pp. 25

¹¹⁶ Po aty. 23-24

¹¹⁷ Sojati, A. (2019, December 23). Të rekrutuarit në Siri, Agron Sojati: Duhet të tregojmë kujdes sepse jemi duke folur për terroristë, jo për turistë. (S. Balla, Intervistues)

¹¹⁸ A2CNN "PM Rama: Kemi regjistruar e të gjithë shqiptarëve në Siri" Link: <https://a2news.com/2020/05/12/shqiptaret-ne-siri-a2-pyet-kryeministrin-rama-kemi-regjistruar-e-te-gjithe-personave/>. Shih edhe: A2 CNN "Shqiptarët në Siri / MEPJ: Jemi angazhuar me partnerët që në pranverë për riatdhesim" Link: <https://a2news.com/2019/11/13/shqiptaret-ne-siri-ministria-e-jashtme-jemi-angazhuar-me-partneret-ge-ne-pranvere-per-riatdhesimin/>

¹¹⁹ Voice of America, "Albanian IS Repatriation From Syria Will Be Long Journey, Experts Say"

<https://www.voanews.com/extremism-watch/albanian-repatriation-syria-will-be-long-journey-experts-say>

¹²⁰ A2CNN "Të rikthyerit nga Siria, Dervishi: Janë ngritur grupet e punës që do të japin asistencë të çfarëdollojshme." <https://a2news.com/2020/10/30/te-riatdhesuarit-nga-siria-dervishi-jane-ngritur-grupe-ge-do-te-japin-asistence-te-cfare-dollojshme/>.

Ndërsa BIRN ka identifikuar gjithsej 52 shtetas shqiptarë në kampin al-Hol, 11 gra dhe 41 fëmijë, 13 prej të cilëve kanë lindur në Siri,¹²¹ nuk dihet shumë rreth LHT-ve meshkuj. Në lidhje me këtë, Raporti i Departamentit të Shtetit për Terrorizmin në vitin 2019 nënvizoi se LHT-të që rikthehen nga Iraku dhe Siria dhe të rinjtë shqiptarë që radikalizohen në terrorizëm paraqesin kërcënimet kryesore të terrorizmit në Shqipëri.¹²² Po ashtu, raporti i vitit 2019 i KE-së thekson se qeveria duhet të (a) zhvillojë programe për të riintegruar LHT-të e rikthyer dhe familjet e tyre, (b) të përmirësojë programet për të parandaluar radikalizimin në burgje dhe (c) të forcojë mekanizmat e monitorimit që përfshijnë shoqërinë civile dhe komunitetet fetare.¹²³ Një rol kryesor në vendimin e qytetarëve për t'iu bashkuar luftës në Siri ishte propaganda ekstremiste, e përhapur kryesisht përmes internetit. Në këtë kontekst, nënseksioni i mëposhtëm analizon luftën ndaj propagandës ekstremiste në Shqipëri.

“Lufta e komunikimit” e ekstremizmit të dhunshëm

Deri më tani, Shqipëria nuk e ka trajtuar mjaftueshëm "luftën e komunikimit" për të luftuar propagandën ekstremiste. Ashtu si në shumë vende të tjera, shumica e theksit është vënë në luftimin e financimit dhe kërcënimeve të terrorizmit, si dhe marrjen e masave kufizuese, të tilla si heqja e përmbajtjes ekstremiste nga interneti ose monitorimi i aktiviteteve jashtë internetit (shih: Shtojca 3). Sidoqoftë, masa të tilla nuk reflektojnë shkallën e propagandës ekstreme në shoqëri dhe as nuk adresojnë problemin në mënyrë efektive.

Përhapja e ideve ekstremiste në Shqipëri lidhet kryesisht me komunikimin ndërmjet miqve, duke përdorur rrjete të ngushta personale. Ndër vite, kanalet e komunikimit në internet dhe jashtë tij janë cilësuar si një mjet i rëndësishëm në duart e ekstremistëve të dhunshëm për të përhapur propagandën dhe ideologjinë e tyre. Çështjet e hershme gjyqësore të vitit 2009, e kanë trajtuar përhapjen e propagandës së ekstremizmit në internet. Gjatë largimit të LHT-ve në vitin 2014 rrjetet e internetit luajtën një rol kryesor në radikalizimin dhe rekrutimin e individëve. Si pasojë e kësaj, autoritetet shqiptare ndryshuan Kodin Penal në vitin 2014, për të luftuar përhapjen e propagandës ekstremiste dhe për të rritur kapacitetet e mbikëqyrjes në internet.

Shqiptarët ishin një nga grupet ku u përqendrua propaganda në internet e ISIS-it gjatë viteve 2015-2017, gjë që rezultoi efektive në radikalizimin dhe rekrutimin e rreth 500 luftëtarëve shqiptarë dhe familjeve të tyre nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës. Një studim i vitit 2015 zbuloi

¹²¹ Fatjona Mejdini, "Families of Albanian ISIS fighters face long road home," Balkan Insight (2019). April 18. Accessed June 26, 2020. https://balkaninsight.com/2019/04/18/families-of-albanian-isis-fighters-face-long-road-home/?fbclid=IwAR31NBcXjTfHOUgKEXImvr_LgM4ARGYADqkAxULN8JNO_D8tldckPzygQ5s

¹²² US Department of State, "Country Reports on Terrorism. Report, Washington D.C.: US Department of State (2020) pp. 61-62

¹²³ European Commission, 2019. Commission Staff Working Document. Working Document, Strasbourg: European Commission. pp. 38

një strategji të sofistikuar të komunikimit publik të ISIS-it në gjuhën shqipe,¹²⁴ e cila synonte rekrutimin e tyre si luftëtarë në zonat e konfliktit. Për më tepër, gjuha shqipe është gjithashtu një nga pesë gjuhët e përdorura për komunikim, në atë që konsiderohet si faqja zyrtare në internet e ISIS-it (<https://hilafeti.wordpress.com>), duke treguar rrezikun që mund të paraqesë propaganda e këtij grupi terrorist në radikalizimin e shqiptarëve.

Sipas statistikave të INSTAT-it, 82.2% e familjeve shqiptare kishin akses në internet në vitin 2019, duke shënuar një shkallë më të lartë të depërtimit të internetit sesa mesatarja botërore (vlerësuar me 58.8 përqind).¹²⁵ Për shkak të popullsisë së re, vendi ynë përdor gjerësisht telefonat inteligjentë, të cilët ofrojnë shërbim të internetit kudo me kosto të ulët në bazë të infrastrukturës solide 4G. Të dhënat e INSTAT-it zbulojnë gjithashtu se përdorimi i "përditshëm/pothuajse ditor" i internetit ka regjistruar përqindjet më të larta ndër vite për të gjitha grupmoshat. Përdoruesit kryesorë i përkasin grupmoshës 16-24 vjeç me rreth 93.1% dhe grupmoshës 25-34 vjeç me 92.4%.

Në lidhje me LHT-të, shpërndarja e mesazheve radikale ka ndodhur si në internet por edhe jashtë tij nga të ashtuquajturit "imamë të vetëshpallur", disa prej të cilëve u arrestuan në vitin 2015. Këta imamë përdornin xhami të cilat ishin jashtë juridiksionit të KMSH. Të dhënat demografike tregojnë se në shënjestrën e rekrutuesve ishin individët me arsim të ulët (fetar) dhe ata me të ardhura të ulëta. Masat dhe kufizimet e miratuara nga autoritetet ligjzbatuese ndikuan që rekrutuesit ta zhvendosin komunikimin e tyre në internet.

Disa studime të tjera tregojnë se përfshirja e klerikëve fetarë të moderuar është e rëndësishme kur bëhet fjalë për të kundërshtuar narrativat e ekstremistëve fetarë dhe për të ndaluar shtrirjen e tyre te besimtarët e ndjeshëm fetarë, veçanërisht tek ata që kanë e filluar praktikimin e fesë rishtazi.¹²⁶ Puna me individët e prekur kërkon përfshirjen e klerikëve të KMSH-së me njohuri të thella fetare dhe me ndikim te besimtarët.

Përshkallëzimi i konflikteve fetare, teknologjia e përhapur që përçon mesazhe në kohë reale, shtimi i grupeve terroriste, si dhe aktorë dhe faktorë të shumtë ndikues kanë ndikuar në rritjen e propagandës së EDH në Shqipëri, ndërkohë që asnjë veprim proporcional nuk është ndërmarrë për ta adresuar atë. Ndërkohë që propaganda ekstremiste luajti një rol të rëndësishëm në radikalizimin e qytetarëve, faktorë të tjerë ishin gjithashtu të rëndësishëm. Është e rëndësishme të theksohet se faktorët që favorizojnë cenueshmërinë nuk janë të njëjtë, por specifikë për

¹²⁴ Academy of Political Studies, (2015) Public relation online strategies of ISIS in Albania:

http://www.asp.al/pdf/Working_paper-Public_relation_strategies_of_ISIS_in_Albania.pdf

¹²⁵ STATISTA, Global Internet Penetration Rate (2020): <https://www.statista.com/statistics/269329/penetration-rate-of-the-internet-by-region/#:~:text=This%20statistic%20shows%20the%20internet,from%2035%20percent%20in%202013.>

¹²⁶ Për më shumë informacion rreth rolit të komuniteteve fetare rreth P/KEDH shih: <https://www.cfr.org/event/engaging-religious-communities-counteracting-violent-extremism;> <https://www.mv.undp.org/content/maldives/en/home/presscenter/speeches/2019/TheRoleofReligiousLeadersinPreventingExtremism.html>; and <https://berghof-foundation.org/library>. Për një këndvështrim të veçantë rreth rolit të komuniteteve fetare në P/KEDH shih: [https://idmalbania.org/reconsidering-the-role-of-civil-society-and-religious-authorities-in-building-community-resilience-in-albania/.](https://idmalbania.org/reconsidering-the-role-of-civil-society-and-religious-authorities-in-building-community-resilience-in-albania/)

kontekste të ndryshme. Kjo është arsyeja pse nënseksioni tjetër diskuton prirjet e radikalizimit vetëm në Bashkinë e Tiranës, e cila prodhoi gati gjysmën e LHT-ve të Shqipërisë.

Prirjet e Radikalizimit në Bashkinë e Tiranës

Bashkia e Tiranës është kryeqyteti i Shqipërisë dhe qendra kryesore administrative dhe ekonomike e vendit. Në Tiranë ndodhen selitë e partive kryesore politike dhe është vendi ku shumica e komuniteteve fetare kanë selitë e tyre dhe zhvillojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve. Tirana është qyteti më i madh për nga popullsia në Shqipëri, sipas statistikave zyrtare, në janar 2020 rreth 31% e 2.85 milion qytetarëve të Shqipërisë banonin në Tiranë. Këto shifra mund të rriten deri në 50% duke marrë parasysh dinamikën jozyrtare demografike dhe studentët e universiteteve. Që kur filloi fenomeni i luftëtarëve të huaj në vitin 2014, Tirana është identifikuar nga QKEDH-ja si një nga pikat e nxehta të radikalizimit dhe ekstremizmit në vend.

Tirana është bashkia nga ku u largua numri më i madh i luftëtarëve të huaj të Shqipërisë për t'u bashkuar me luftërat në Lindjen e Mesme; 70 nga 144 personat që u bashkuan me organizatat terroriste në Siri dhe Irak (ISIS/al-Nusra/al-Kaeda). Është e rëndësishme të theksohet se të gjithë qytetarët e përfshirë në procesin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm kanë hasur në një doktrinë të tillë në vende të ndryshme adhurimi, të tilla si "xhami informale" dhe institucione arsimore në të cilat shpërndareshin haptazi materiale dhe ligjërata radikalizuese. Një dokument konfidencial që adresonte fenomenin e "xhamive informale" u ishte dërguar anëtarëve të Parlamentit ku u vërejt se 89 xhami nuk kishin asnjë lidhje me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Imamët e vetëshpallur të arrestuar, Z. Balla dhe Z. Hysa, ushtruan pikëpamjet dhe aktivitetet e tyre radikale në xhamitë përkatëse "Unaza e Re" dhe "Mëzez" që ndodhen në Bashkinë e Tiranës. Këto dhëna tregojnë se Tirana është e vetmja bashki ku ideologjia e EDH nuk ka qenë sporadike, por përkundrazi është përqendruar në zona të veçanta, gjë që tregon se faktorët mund të jenë të lidhur me komunitetin, duke u përqendruar në vendndodhjet periferike të Tiranës. Gjithashtu, qyteti ka përjetuar tensione ndërfaqetare dhe shfaqjen e narrativave armiqësore gjatë viteve të fundit që nuk ishin vërejtur më parë. Në këtë kuadër, udhëheqësit fetarë në Tiranë ndajnë mendimin se ka pasur një "keqinterpretim të misionit të islamit" ose një "mungesë të kuptimit të saktë". Në vijim të kësaj, myftiu¹²⁷ i Tiranës në atë kohë deklaroi se disa xhami ishin plotësisht të izoluara dhe praktikonin islamin jashtë juridiksionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dhe kjo mund të ketë qenë një nga arsyet që bëri të mundur indoktrinimin e besimtarëve (jo vetëm 70 LHT-të) gjatë kësaj periudhe.

Edhe pse qeveria shqiptare ka shprehur gatishmërinë për t'iu përgjigjur këtyre tensioneve dhe krizave të papritura, vërehet mungesa e hulumtimit të mirëfilltë për të udhëhequr procesin e zhvillimit të mesazheve dhe narrativave efektive P/KEDH si dhe për të përshtatur mjetet dhe

¹²⁷ Myfti quhet drejtuesi i komunitetit mysliman në një rajon ose qytet të një vendi.

mënyrat më të besueshme për t'i dërguar ato përmes një qasjeje strategjike që ndërton një narrativë të fortë dhe të qëndrueshme.

Në vijim të këtij nënseksioni, ai i radhës (nënseksioni i fundit i seksionit V) synon po ashtu të shpjegojë kontekstin lokal ku janë rekrutuar gjysma e LHT-ve të Shqipërisë, duke marrë në shqyrtim disa faktorë.

Analiza PESTL

Ky seksion analizon shkurtimisht faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë dhe ligjorë (PESTL) me qëllim për të kuptuar mjedisin në të cilin ndodh fenomeni i EDH. Analiza PESTL është një mjet i përdorur për të identifikuar faktorët makro që ndikojnë në një fushë të veçantë.¹²⁸

Faktorët Politikë

Parlamenti shqiptar përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur përmes sistemit zgjedhor proporcional rajonal me një mandat katër vjeçar. Zgjedhjet e fundit parlamentare u zhvilluan në 25 qershor 2017, në të cilën Partia Socialiste siguroi një mandat të dytë me 74 deputetë në Parlament, duke e lejuar atë të qeverisë e vetme vendin. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë planifikuar të zhvillohen në 25 prill 2021. Viti 2019 u shoqërua me një situatë të tensionuar politike, ku partitë opozitare (Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim) në shenjë proteste kundër qeverisë hoqën dorë nga mandatet e tyre parlamentare, duke hapur kështu rrugën për një sërë ndryshimesh politike. Më e rëndësishmja ishte që zgjedhjet vendore të zhvilluara në qershor 2019 u bojkotuan nga partitë e opozitës. Partia Socialiste, e cila ishte në pushtet fitoi 60 nga 61 bashki, përfshirë Bashkinë e Tiranës ku Z. Erion Veliaj u zgjodh për mandatin e dytë radhazi.

Popullsia e Shqipërisë në 1 janar 2020 ishte 2.845.955 banorë,¹²⁹ e cila tregon një rënie me 0.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të dhënat tregojnë se në llogaritjet e popullsisë të 1 janarit 2020, vetëm dy rajone të vendit shënuan rritje të popullsisë krahasuar me vitin 2019, ndërsa dhjetë prej tyre shënuan rënie. Rritja më e madhe është vërejtur në rajonin e Tiranës (+ 1.2%). Si i tillë, në rajonin e Tiranës jeton 31.8% e popullsisë e ndarë në 5 bashki.

Besimi në politikë, institucionet shtetërore dhe dëshira e qytetarëve për t'u përfshirë në aktivizëm politik është përkeqësuar gjatë viteve të fundit,¹³⁰ të cilat së bashku me qeverisjen e dobët cilësohen si faktorë të përmendur shpesh si ndikues në rritjen e radikalizimit.

¹²⁸ Ho, Joseph Kim-Keung. "Formulation of a systemic PEST analysis for strategic analysis." *European academic research* 2.5 (2014): 6478-6492.


¹²⁹ [Institute of Statistics. Population of Albania in 2020. http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf](http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf)

¹³⁰ Sondazhi i Opinioneve Publikë rreth Angazhimit Politik në Shqipëri 2020, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Instituti Demokratik Kombëtar < <https://idmalbania.org/survey-of-political-engagement-in-albania-2020/> >

Faktorët ekonomikë

EDH u shfaq si një kombinim i ideologjisë, zemërimeve dhe mundësive, të cilat lindin nga ndërveprimi midis faktorëve ideologjikë, strukturorë dhe socio-ekonomikë të cenueshmërisë. Faktorë të tillë si varfëria absolute dhe relative, fragmentimi shoqëror, përjashtimi dhe diskriminimi social dhe aktiviteti ekonomik i paligjshëm, njihen si shoqëruese të zhgënjimit me sistemin ekonomik dhe politik. Megjithëse nuk ka ndonjë korrelacion të thjeshtë midis statusit socio-ekonomik apo demografisë së të rinjve, me gjasat e tyre për t'u radikalizuar, të rinjtë e papunë dhe individët e izoluar nga rajone të pazhvilluara mund të jenë veçanërisht të cenueshëm nga propaganda e ideologjive ekstremiste që justifikojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të arritur ndryshime të dëshiruara, si dhe përfitime personale. Prania e ekstremistëve fetarë dhe individëve që ushtrojnë presion mbi besimtarët fetarë për t'u bashkuar me kauzat ekstremiste është konfirmuar edhe në bashkinë e Tiranës.

Niveli i papunësisë në Shqipëri (2015-2019)



Grafiku 1. Burimi i informacionit: Instituti i Statistikave, Anketa e Forcave të Punës 2015-2019

Privimi ekonomik dhe izolimi mund të formojnë një rreth vicioz i cili e bën edhe më të vështirë për individët të dalin prej tij. Edhe nëse individët nuk identifikohen me EDH, dëshira për të "shpëtuar" nga realiteti i tyre i marginalizimit mund të jetë një faktor i lidhur me përfshirjen në EDH. Privimi ekonomik e bën të vështirë që individët të ruajnë lidhjen e tyre me shoqërinë, dhe akoma më të vështirë që të sigurojnë jetesën. Për më tepër, mungesa e vazhdueshme e mundësive ekonomike sjell zemërim dhe humbje të shpresës.

Ndërkohë që shumë prej luftëtarëve të huaj dhe rekrutuesit e dënuar e kanë origjinën nga zona më të largëta (zona rurale të Librazhdit, Pogradecit, Dibrës, etj.), ata banonin dhe vepronin në periferi të qendrave kryesore urbane, si p.sh. Tirana.

Të rinjtë, grupi më i cenueshëm nga radikalizimi, janë të mbi-përfaqësuar në statistikat e papunësisë. Në vitin 2019, papunësia e të rinjve vlerësohej të ishte 21.5 përqind, nivel i ngjashëm me atë të vitit 2020. Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 vlerësojnë se zonat më të varfra janë rajonet malore rurale. Personat e arsimuar mirë nuk janë në gjendje të gjejnë punë që përshtaten me kualifikimet e tyre. Një pabarazi e tillë midis arsimit dhe punësimit mund të jetë një burim zhgënjimi për shumë të rinj. Privimi nga nevojat socio-ekonomike, veçanërisht kur ato bashkohen me faktorë të tjerë si korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor i shfrytëzueshëm nga grupet e EDH.

Faktorët socialë

Llogaritjet e popullsisë në vitin 2020 tregojnë se Tirana pësoi një rritje të popullsisë prej 1.2% krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2019, në Shqipëri kanë lindur 28,561 foshnja, një rënie me 1.3% krahasuar me një vit më parë. Në tremujorin e parë të vitit 2020 vlera më e lartë e lindjeve është regjistruar në rajonin e Tiranës, ku numri i lindjeve është 2,059. Numri i vdekjeve për vitin 2019 në Shqipëri është 21,937 persona, një rritje prej 0.6% krahasuar me një vit më parë. Në tremujorin e parë të vitit 2020 numri më i lartë i vdekjeve është regjistruar në Tiranë, me 1,499 vdekje. Sa i përket përbërjes fetare të Tiranës, 55.7% e qytetarëve të saj janë myslimanë, 6.4% janë ortodoksë, 5.4% janë katolikë dhe 3.4% janë bektashinj.¹³¹ Grupet etnike në Shqipëri përfshijnë 82.6% shqiptarë, 0.9% grekë dhe 1% të tjerë (përfshirë vllahët, romët, maqedonasit, malazezët dhe egjiptianët).¹³² Numri i emigrantëve për vitin 2019 në Shqipëri ishte 43,835 persona, një rritje prej 13.3% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa në vitin 2019 numri i imigrantëve ishte 20,753 persona, një rënie prej 12.3% krahasuar me një vit më parë.

¹³¹ Instituti i Statistikave. 2011. Instat. Aksuar në 24 qershor 2020

<https://instatgis.gov.al/#/!//prefectures/population/prefpop1>

¹³² Po aty. Sqarim: 15.5% e popullsisë nuk u përgjigj për grupin e tyre etnik në censusin e vitit 2011.


Faktorët teknologjikë

Një nga faktorët kryesorë që kontribuuan në rritjen e ISIS-it ishte përdorimi i mediave sociale për të përhapur propagandën e tij dhe për të rekrutuar militantë nga vendet arabe dhe nga e gjithë bota.¹³³

Përmbajtja e radikalizimit në gjuhën shqipe në internet është në rritje. Siç u përmend edhe më herët, ky shqetësim është deklaruar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2019, i cili nënvizon se përmbajtja e radikalizimit në gjuhën shqipe në internet është në rritje.¹³⁴

Ndërkohë që mediat sociale u mundësojnë njerëzve të komunikojnë dhe të qëndrojnë në kontakt me të afërmit në të gjithë botën, të bashkohen ose të promovojnë kauza të vlefshme dhe të rrisin ndërgjegjësimin për çështje të rëndësishme, nga ana tjetër ato mund të shërbejnë edhe si një mundësi e rrezikshme për vetë-radikalizim, veçanërisht për të rinjtë, sepse frekuenca ditore/javore e përdorimit të internetit nga kjo kategori është shumë e lartë.

Shpërndarja e frekuencës së përdorimit të TIK sipas grupmoshave në vitin 2019 në %




Grafiku 2. Burimi i informimit: Instituti i Statistikave, shpërndarja e frekuencës së përdorimit të TIK (teknologjisë së informacionit dhe komunikimit) sipas grupmoshave në vitin 2019 në%

¹³³ Badawy, A and Emilio Ferrara, "The Rise of Jihadist Propaganda on Social Networks" (Cornell University, 2017) Available at: <https://arxiv.org/abs/1702.02263>.

¹³⁴ European Commission, Albania 2019 Report: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Megjithëse radikalizimi në internet nuk mund të përbëjë kërcënim të menjëhershëm, ai mund të rrezikojë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e vendit në të ardhmen. Kanalet e komunikimit mund të shërbejnë si faktorë mundësues të EDH.

Sipas një studimi të vitit 2020 nga Akademia e Studimeve Politike¹³⁵, Facebook është platforma më e përdorur nga personat që përhapin propagandën ekstremiste në gjuhën shqipe, megjithëse përmbajtja ekstremiste vërehet edhe në platformat e tjera si YouTube, Twitter, Telegram dhe Instagram. Forma kryesore e përmbajtjes së EDH në mediat sociale është propaganda fetare.¹³⁶



Grafiku 3. Numri i adresave të gjetura, përhapja e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm

¹³⁵ Akademia e Studimeve Politike, Raport Monitorimi “Mbi elementët e ekstremizmit të dhunshëm që qarkullojnë në platformat online në Shqipëri”

¹³⁶ Po aty, Fig 1.

Faktorët legjislativë

Si një nga vendet që është prekur nga EDH që shpie në terrorizëm, Shqipëria është e angazhuar për të përmbushur qëllimet e sigurisë kombëtare duke parandaluar dhe luftuar EDH. Për këtë qëllim, kuadri ligjor dhe institucional është zhvilluar dhe konsoliduar në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare kundër terrorizmit, në të njëjtën kohë duke forcuar mekanizmat e brendshëm institucionalë dhe duke investuar në partneritetet rajonale dhe ndërkombëtare të kësaj fushe.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë veprime institucionale dhe ligjore në fushën KEDH. Në shkurt të vitit 2014 qeveria shqiptare ndryshoi kodin penal (nenet 265/a dhe 265/b) për të lejuar interpretimin më fleksibël të akteve terroriste, ndërkohë që vendosi dënime më të ashpra për autorët. Shqipëria ishte një nga vendet e para në rajon që miratoi SKLEDH-në dhe Planin e saj përkatës të Veprimit 2015-2020. Shqipëria emëroi një Koordinator Kombëtar për KEDH i cili është përgjegjës për zbatimin e strategjisë dhe koordinimin e drejtpërdrejtë me Kryeministrin. Shqipëria krijoi në dhjetor të vitit 2017 QKEDH-në. Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2020-2025¹³⁷ (Për më shumë informacion mbi veprimet legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë shih Shtojcën 3).

Sidoqoftë, pavarësisht përpjekjeve, Shqipëria ka ende një rrugë të gjatë për të bërë në luftën kundër EDH. Siç thuhet në raportin e KE-së¹³⁸ QKEDH-ja duhet të ketë financim të mjaftueshëm, staf dhe mbështetje politike për të përmbushur detyrat dhe duhet të bëhet më shumë në lidhje me riintegrimin dhe risocializimin e të rikthyerve dhe për parandalimin e radikalizimit në burgje.

I gjithë ky seksion (V) ishte përqendruar në literaturën ekzistuese në Shqipëri. Seksioni vijues VI (Analiza e Audiencës së Shënjestruar) ofron të dhëna parësore nga sondazhi i kryer në Tiranë, në kuadër të këtij studimi.

¹³⁷ www.cesk.gov.al/legjislacioni/2020/strategjia_kombetare_sigurise_kibernetike.pdf.

¹³⁸ European Commission, Albania 2019 Report: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Kapitull VI: Analiza e Audiencës së Shënjestruar



Bazuar në gjetjet nga rishikimi i literaturës, analiza PESTL, dhe në përputhje me supozimet teorike në lidhje me nxitësit e EDH, u hartua një pyetësor me 105 pyetje për të mbledhur të dhëna nga qytetarët e Bashkisë së Tiranës. Ky seksion ofron rezultatet e sondazhit dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura.

Të dhënat e sondazhit u mbledhën përmes intervistave ballë për ballë nga një kampion i rastësishëm i shtresuar prej 800 të rriturish nga 18 deri në 64 vjeç. Në shtresat e para, anketimi u shpërnda proporcionalisht në 24 njësitë administrative që janë pjesë e Bashkisë së Tiranës, bazuar në popullsinë e tyre. Në shtresat e dyta, anketimi u shpërnda proporcionalisht në zonat urbane dhe rurale. Më tej, u shpërnda anketimi me kuotat proporcionale të gjinisë dhe moshës për secilën nënshtresë. U krye edhe anketimi pilot për të testuar pyetësorin e sondazhit dhe për të vëzhguar reagimet e anketuesve në situatat reale të intervistimit, për të bërë modifikimet e mundshme për të zvogëluar paragjykimet dhe për të rritur saktësinë.

Sondazhi publik synoi të eksplorojë perceptimet dhe opinionet e ndryshme të publikut të gjerë në lidhje me njohjen e EDH dhe mjetet për ta luftuar atë, me fokus të veçantë në qasjen komunikuese. Qasja metodologjike sasiore siguroi të dhëna studimore që janë veçanërisht të dobishme për të hartuar gjetjet dhe për të ndërtuar një qasje politike. Për këtë qëllim, u hartua, pilotua dhe u administrua një pyetësor. Marzhi i gabimit statistikor për të gjithë kampionin llogaritet në +/- 3.3%. Kampioni u përzgjedh që të ishte përfaqësues për të gjithë popullsinë. Sidoqoftë, saktësia e përfaqësimit duhet të gjykohet me kujdes duke marrë parasysh madhësinë e kampionit dhe popullatën e vlerësuar.

Demografia

Nënseksioni i parë ofron të dhëna rreth demografisë së të anketuarve. Shumica e të anketuarve: 75% banojnë në zonat urbane, ndërsa 25% banojnë në zonat rurale. Lidhur me arsimimin, 60% kanë diplomë të shkollës së mesme, 27% kanë diplomë universitare, gati 8% e të anketuarve kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm (8-9-vjeçar) dhe 5.5% kanë diplomë pas-universitare. Për sa i përket punësimit, gati 42% e të anketuarve punojnë në sektorin privat, 22% deklarohen si të vetëpunësuar, gati 12% deklarohen të papunë dhe 10% punojnë në sektorin publik.

Niveli i papunësisë është pothuajse identik me raportin e tremujorit të dytë të vitit 2020 nga Instituti i Statistikave, i cili e rendit nivelin e papunësisë në 11.9%.¹³⁹ Prandaj, kampioni mund të jetë përfaqësues i popullatës. Nënseksioni i mëposhtëm tregon besimet fetare të të anketuarve në sondazh.

¹³⁹ Instituti i Statistikave 2020, <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsime-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2>

Besimet fetare


Pothuajse të gjithë të anketuarit (92%) besojnë në Zot ose në një frymë mbinjerëzore. Kur u pyetën se sa të sigurt janë në lidhje me besimin e tyre në Zot ose në frymën mbinjerëzore, shumica (52.5%) u përgjigjën "absolutisht të sigurt" dhe 37% u përgjigjën "pak a shumë të sigurt."

Të anketuarit u pyetën se në cilën fe besonin dhe shumica (64%) ishin myslimanë, 12% të krishterë ortodoksë, gati 10% bektashinj, dhe 5% të krishterë katolikë, e njëjta përqindje si ateistët. Siç u shpjegua më herët në këtë studim, në seksionin "Feja në Shqipëri" Shqipëria ka gati 2.8 milion banorë, ku tre komunitetet më të mëdha fetare në vend janë myslimanë (56.7%), katolikët (10%) dhe ortodoksët (6.8%). Për sa i përket përbërjes zyrtare fetare të Tiranës, 55.7 përqind e qytetarëve janë myslimanë, 6.4% janë ortodoksë, 5.4% janë katolikë dhe 3.4% janë bektashinj. Sidoqoftë, përqindjet në raportin e INSTAT kishin vlera të përafërta, duke marrë parasysh që 13.8% e popullsisë së përgjithshme nuk preferuan t'i përgjigjen pyetjes mbi fenë, dhe se për 2.4% të personave që u përgjigjën, informacioni i dhënë nuk ishte i rëndësishëm ose i deklaruar.¹⁴⁰

Kur u pyetën se sa të rëndësishme e konsiderojnë fenë, 43% e të anketuarve deklaruan se është e rëndësishme, gati 24% deklaruan se është shumë e rëndësishme dhe 18% deklaruan se është disi e rëndësishme. Vetëm 6.6% e të anketuarve deklarojnë se feja nuk është aspak e rëndësishme. Për ata që banojnë në zonat rurale, feja është shumë e rëndësishme për 36.8% të tyre dhe e rëndësishme për 46.6%. Në përgjithësi, të anketuarit e zonave rurale duket se i kushtojnë një rëndësi më të lartë fesë.

¹⁴⁰ Instituti i Statistikave. (n.d.). INSTAT. Nga Censusi i vitit 2011: <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1> (aksesuar në 10 tetor 2020).

Sa e rëndësishme është feja për ty?




Grafiku 4 - Rëndësia e fesë

Lidhur me frekuentimin e shërbimeve fetare, 31% deklaruan rrallë, 28% disa herë në vit, 22% asnjëherë dhe 11% një herë në javë.

Megjithatë, niveli i frekuentimit të shërbimeve fetare ve në dukje disa ndryshime në lidhje me vendbanimin dhe arsimin. Vetëm 1.5% e atyre që banojnë në zonat rurale deklaruan se nuk marrin pjesë kurrë në shërbime të tilla ndërsa 29.9% e atyre me arsim të lartë deklaruan të njëjtën gjë. Ata që banojnë në zonat rurale kanë nivelin më të lartë të frekuentimit javor 29%, krahasuar me 11.1% të të gjithë kampionit dhe 3.3% të atyre me arsim të lartë

Sa shpesh merrni pjesë në shërbime/ceremoni fetare?



	Kampioni i plotë	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë	Zona rurale	Zona urbane
■ Asnjëherë	21.70%	18.10%	29.30%	1.50%	28.40%
■ Rrallë herë	31%	27.90%	37.50%	20.90%	34.30%
■ Disa herë në vit	27.90%	30.50%	22.20%	38.20%	24.40%
■ Një herë ose dy herë në muaj	5.60%	5.60%	5.60%	8.10%	4.80%
■ Një herë në javë	11.10%	14.70%	3.30%	29.50%	4.90%
■ Më shumë se një herë në javë	2.90%	3.20%	2.20%	1.90%	3.20%


Grafiku 5. Niveli i frekuentimit të shërbimeve fetare

Përvoja dhe njohja e të anketuarve më ekstremizmin e dhunshëm

Ky nënseksion eksploron përvojën dhe njohjen e të anketuarve me EDH. Duke qenë se EDH është një term i ri i futur në ligjërimin publik shqiptar, të anketuarit u pyetën sa e njohin këtë term. Shumica dërrmuese e të anketuarve, 73%, deklaruan se e njohin termin ekstremizëm i dhunshëm, ndërsa 24% deklaruan se nuk ishin në dijeni. Megjithatë, ekziston një ndryshim i konsiderueshëm për ata që jetojnë në zonat rurale. Ndërkohë që 81% e të anketuarve në zonat urbane deklaruan se e njihnin termin, vetëm 48% e të anketuarve në zonat rurale e njihnin atë.

Të anketuarit u pyetën për kohën kur filluan të dëgjojnë rreth ekstremizmit të dhunshëm. Një e treta e të anketuarve kanë dëgjuar rreth ekstremizmit gjatë pesë viteve të fundit, një e pesta e të anketuarve kanë dëgjuar rreth ekstremizmit gjatë dhjetë viteve të fundit, një e gjashta e të anketuarve kanë dëgjuar rreth tij gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë, gati një e pesta e të anketuarve deklaruan se nuk kishin dëgjuar kurrë rreth ekstremizmit. Vlen të përmendet se dy kategoritë me përqindjen më të lartë të të anketuarve që nuk kanë dëgjuar kurrë rreth ekstremizmit janë zonat rurale, 48%, dhe të anketuarit pa arsim të lartë 27%.

Kur ke dëgjuar fillimisht për ekstremizmin e dhunshëm?




Grafiku 6 - Kur filluan të dëgjojnë rreth ekstremizmit të dhunshëm

Në mënyrë që të anketuarit të ofronin përgjigje në përputhje me qëllimin e sondazhit, atyre iu ofrua përkufizimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe ekstremistëve të dhunshëm gjatë plotësimit të sondazhit.¹⁴¹

Pavarësisht se fokusi i hulumtimit ishte Bashkia e Tiranës, të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre se sa është përhapur ekstremizmi i dhunshëm në Bashkinë e Tiranës, por edhe në zonat e tjera të Shqipërisë. Shumica e të anketuarve (60%) deklaruan se ai nuk është shumë i përhapur në Bashkinë e Tiranës, ndërsa 31% e të anketuarve deklaruan se është shumë i përhapur.

Opinion i ngjashëm u dha edhe për praninë e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri pasi shumica e të anketuarve deklaruan se nuk është shumë i përhapur (62%), ndërsa rreth një e treta e të anketuarve deklaruan se është shumë i përhapur.

Në përgjithësi nuk vërehet ndonjë ndryshim ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe gjithë vendit.




Grafiku 7 - Prania e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe në Bashkinë e Tiranës

¹⁴¹ Ekstremizmi i dhunshëm i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunë të motivuar ideologjikisht me qëllim arritjen e objektivave politike, fetare ose ideologjike. Ai përfaqëson fazën përfundimtare të procesit të radikalizimit. Ekstremistët e dhunshëm nuk janë vetëm individët që janë të gatshëm të përqafojnë dhunën fizike, por edhe individët që mbështesin, rekrutojnë ose advokojnë në mënyrë aktive në favor të një ideologjie ekstremiste të dhunshme.

Përveç bashkisë së Tiranës dhe Shqipërisë në tërësi, qytetarëve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për praninë e ekstremizmit të dhunshëm në 12 qarqet e vendit. Të anketuarve iu kërkua që fillimisht të ofronin përgjigjen për qarkun në të cilën ata mendonin se ekstremizmi i dhunshëm ishte më i përhapur dhe më pas iu kërkua që të përgjigjeshin për qarkun e dytë me ekstremizmin e dhunshëm më të përhapur. Kjo pyetje kishte për qëllim të vërtetonte supozimet e mëparshme mbi të ashtuquajturat zona të nxehta në vend.

Sipas përgjigjeve, qarqet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës, Fierit dhe Kukësit, vlerësohen se kanë një prani më të lartë të ekstremizmit të dhunshëm, ku Tirana renditet më lart se të tjerat.

Qarqet ku ekstremizmi i dhunshëm është më i përhapur




Grafiku 8 - Përhapja e ekstremizmit të dhunshëm në 12 qarqet e vendit

Përveç pyetjes për praninë e ekstremizmit të dhunshëm, qytetarëve iu kërkua të ofrojnë pikëpamjen e tyre për qarqet ku ata mendonin se ekstremizmi i dhunshëm është më shqetësues.

Qarku i Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës dhe Durrësit theksohen më së shumti, ku Tirana është më lart se të tjerët. Gati një në dy të anketuar besojnë se ekstremizmi i dhunshëm është më shqetësues në qarkun e Tiranës. Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për një qark të dytë ku ata e konsideronin ekstremizmin e dhunshëm më shqetësues. Gati 18% e të anketuarve besojnë se ekstremizmi i dhunshëm është më shqetësues në Elbasan, 14% në Durrës, 12% në Tiranë dhe 11% në Shkodër.


Qarqet ku ekstremizmi i dhunshëm është më shqetësues



Grafiku 9 - Në cilin qark është më shqetësuese përhapja e ekstremizmit të dhunshëm

Qytetarëve u kërkua gjithashtu të paraqisnin pikëpamjet e tyre se sa shqetësues mendonin se është fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm për stabilitetin social të Shqipërisë. Shumica e të anketuarve, 57%, e shohin fenomenin shumë shqetësues, 38% mendojnë se nuk është shumë shqetësues, ndërsa gati 3% deklaruan që nuk është aspak shqetësues.

Sa shqetësues është ekstremizmi i dhunshëm për kohezionin social dhe stabilitetin në Shqipëri




Grafiku 10 - Sa shqetësues është ekstremizmi i dhunshëm për stabilitetin social në Shqipëri

Aktorët që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm

Ky nënseksion i katërt ofron të dhëna mbi perceptimin e të anketuarve për aktorët që promovojnë EDH. Të anketuarit u pyetën se cilët aktorë mendojnë se nxisin ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. 45% besojnë se ekstremizmi i dhunshëm nxitet nga grupe fetare që nuk kanë lidhje me komunitetet zyrtare fetare. Gati një e treta e të anketuarve besojnë se ai nxitet nga partitë politike.

Megjithatë, 61% e të anketuarve nga zonat rurale i konsiderojnë partitë politike si nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm. Vetëm 29% e të anketuarve nga zonat rurale besojnë se ekstremizmi i dhunshëm nxitet nga grupet fetare që nuk kanë lidhje me komunitete zyrtare fetare. Vlen të përmendet se të anketuarit me arsim të lartë janë kategoria me përqindjen më të lartë, 11.5%, që beson se komunitetet zyrtare fetare nxisin ekstremizmin e dhunshëm.


Cilët aktorë nxisin ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?



Grafiku 11 - Cilët aktorë nxisin EDH në Shqipëri

Kur u pyetën rreth aktorëve që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri, 35% e të anketuarve etiketojnë individët ose grupet shqiptare, dhe 19% e të anketuarve etiketojnë individët ose grupet e huaja. 44% e të anketuarve besojnë se individët dhe grupet shqiptare apo të huaja promovojnë ekstremizmin e dhunshëm. Vlen të përmendet se të anketuarit nga zonat rurale kanë përqindjen më të ulët, 7.7%, që etiketojnë grupet ose individët e huaj si promovuesit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.

Cilët mendoni se nxisin ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri




Grafiku 12 - Aktorët që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri

Shumica e të anketuarve besojnë se mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm përhapen nga njerëz që kanë mendime ekstreme se si duhet të organizohet dhe funksionojë shoqëria. Një e pesta e të anketuarve besojnë se mesazhe të tilla përhapen nga njerëz që kanë pikëpamje të forta politike dhe një e pesta e të anketuarve besojnë se mesazhet përhapen nga njerëz që kanë pikëpamje ekstreme nacionaliste. Vetëm 7% e të anketuarve besojnë se mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm përhapen nga njerëzit fetarë. Ndryshe nga të gjitha kategoritë e tjera, të anketuarit nga zonat rurale, 42% e tyre, besojnë se njerëzit që kanë pikëpamje të forta politike janë aktorët kryesorë që përhapin mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm.

Qytetarët që jetojnë në zonat rurale tregojnë një nivel të lartë ndikimi të njerëzve me pikëpamje të forta politike si përgjegjës për propagandimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ky perceptim mund të lidhet me mungesën e njohurive të duhura rreth ekstremizmit të dhunshëm (48% nuk e kanë dëgjuar më parë) dhe atribuimin e tij në politikë, e cila mund të lidhet me faktin se këto zona janë më të varfra nga ana ekonomike dhe sociale dhe besimi në politikë është më i ulët.


Cila nga kategoritë e mëposhtme mendoni se përhapin mesazhe të ekstremizmit të dhunshëm



Grafiku 13 - Njerëzit që përhapin EDH


Grafiku i mëposhtëm tregon përgjigjet e dhëna nga të anketuarit në lidhje me mënyrat që përdoren për të ndikuar në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm. Shumica dërrmuese (68.7%) besojnë se stimujt financiarë dhe materialë janë të rëndësishëm në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.

Vetëm 23.8% e të anketuarve besojnë se propaganda ndikon në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm. Për të anketuarit që jetojnë në zonat rurale, stimujt financiarë dhe materialë vlerësohen si më me ndikim për 84.2% të tyre dhe vetëm 15.8% e tyre e konsiderojnë propagandën si një instrument të radikalizimit.



Grafiku 14 - Mjetet që ndikojnë në përhapjen e EDH


Pothuajse gjysma e të anketuarve pajtohen plotësisht që ekstremistët e paraqesin veten si zgjidhës të problemeve, ofrues të shërbimeve dhe plotësues të nevojave, ndërsa 34.6% e të anketuarve pajtohen deri diku. Kur u pyetën se sa pajtoheshin me deklaratën “ekstremistët e shohin civilizimin perëndimor si një kërcënim për shoqërinë shqiptare”, 41% e të anketuarve ishin deri diku dakord, 32% ishin plotësisht dakord, ndërsa 22% ose nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord.



Grafiku 15 - Ekstremistët e dhunshëm e paraqesin veten si zgjidhës të problemeve, ofrues të shërbimeve dhe plotësues të nevojave të njerëzve

Pothuajse gjysma e të anketuarve janë plotësisht dakord se ekstremistët i përdorin tensionet shoqërore për t'i radikalizuar njerëzit, dhe 47% të tjerë janë deri diku dakord me këtë deklaratë. Kur u pyetën se në çfarë mase e shfrytëzojnë ekstremistët përbërjen e ndryshme fetare të popullsisë shqiptare, pothuajse gjysma e tyre ishin deri diku dakord, ndërsa gati një e katërta e tyre ishte plotësisht dakord, dhe 22% nuk ishin aspak dakord.

Opinionimi rreth ndikimit të tensioneve sociale dhe ndarjeve fetare në radikalizim




Grafiku 16 - Ekstremistët e dhunshëm shfrytëzojnë tensionet shoqërore dhe ndarjet fetare për radikalizimin e njerëzve

Toleranca fetare vlerësohet si një vlerë themelore e shqiptarëve në ligjërimin publik. Sidoqoftë, është e rëndësishme që të eksplorohet sa qëndron kjo vlerë te të anketuarit e këtij studimi. Për të zbuluar këtë, qytetarëve iu kërkua të ofronin mendimin e tyre rreth deklaratës "toleranca fetare është një cilësi e shoqërisë shqiptare që nuk mund të mposhtet nga ekstremistët e dhunshëm".

Të dhënat e sondazhit tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve e konfirmojnë këtë vlerë, edhe pse niveli i tyre i konfirmimit ndryshon. Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) ishin plotësisht dakord, ndërsa 32% të tjerë ishin deri diku dakord. 12% ose nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord. Të anketuarit nga zonat rurale ishin ata që ishin dakord më së shumti (80.8%).

Pjesa më skeptike e popullsisë ishin ata me arsim të lartë. Vetëm 44% e tyre ishin plotësisht dakord me deklaratën se toleranca fetare është një cilësi e shoqërisë shqiptare që nuk mund të mposhtet nga ekstremistët e dhunshëm dhe 5.9% e tyre nuk janë aspak dakord. Të anketuarit e moshave 18 - 34 vjeç janë disi më shumë dakord me deklaratën se kampioni i plotë i sondazhit.


Sa pajtoheni me deklaratën: toleranca fetare është një cilësi e shoqërisë shqiptare që nuk mund të mposhtet nga ekstremistët e dhunshëm



Grafiku 17 - Opinioni i qytetarëve nëse tolerance fetare në Shqipëri mund të mposhtet nga ekstremistët e dhunshëm

Qytetarëve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre mbi ndikimin e grupeve fetare ekstremiste në Bashkinë e Tiranës. 25.6% e të anketuarve mendojnë se grupet ekstremiste fetare kanë ndikim ose kanë shumë ndikim në Tiranë, ndërsa 55.6% të tjerë mendojnë se ndikimi i tyre është i vogël. Vetëm 16% deklarojnë se ndikimi i tyre është i papërfillshëm.

Sa ndikim kanë grupet ekstremiste fetare në Tiranë




Grafiku 18 - Ndikimi i grupeve ekstremiste të dhunshme në Tiranë

Ata mendojnë se anëtarët e grupeve ekstremiste mundohen të njohin njerëz të rinj për t'u promovuar atyre ideologjinë e tyre dhe për të fituar mbështetjen e tyre (51.9%), për të rekrutuar anëtarë të rinj (37%) dhe për të zvogëluar numrin e njerëzve që i kundërshtojnë ata (8.2%).

Një përqindje më e madhe e banorëve të zonave rurale (65%) mendojnë se anëtarët e grupeve ekstremiste mundohen të njohin njerëz të rinj për t'u promovuar atyre ideologjinë e tyre dhe për të fituar mbështetjen e tyre.


Si mendoni, pse anëtarët e grupeve ekstremiste mundohen të njohin njerëz të rinj?



Grafiku 19 - Motivimi i anëtarëve të ekstremizmit të dhunshëm për të njohur njerëz të rinj

55.7% e të anketuarve janë të mendimit se ata që përpiqen të njohin njerëz për qëllime rekrutimi janë shqiptarë që jetojnë në Shqipëri, ndërsa 24.8% mendojnë se ata janë kryesisht të huaj që jetojnë në Shqipëri.

Në dijeninë tuaj, anëtarët e grupeve ekstremiste që mundohen të njohin njerëz të rinj në Shqipëri janë:




Grafiku 20 - Personat që mundohen të rekrutojnë qytetarë shqiptarë për qëllime radikalizimi

Sa i përket përvojave personale, vetëm 2.1% thonë se ju është ofruar të konsumojnë materiale propagandistike që nxisin ekstremizmin, ndërsa 12.7% thonë se kjo u ka ndodhur miqve ose të afërmeve.

Përqindja e të anketuarave femra të cilave u është ofruar të konsumojnë materiale të tilla është më e lartë (18.3%) sesa te meshkujt (12.9%).


Përvoja me ekspozimin ndaj materialeve me përmbajtje të ekstremizmit të dhunshëm



Grafiku 21 - Ekspozimi ndaj materialeve me përmbajtje ekstremiste të dhunshme

Shumica dërmuese e të anketuarve, 71.4%, besojnë se rekrutuesit kanë më shumë gjasa ta kthejnë një individ në një ekstremist të dhunshëm në zonat që jetojnë në varfëri. Mjedise të tjera më pak të rrezikuara janë familja dhe rrethet miqësore (5.7%), interneti dhe mediat sociale (5.4%) dhe ambientet e arsimit (4.5%). Komunitetet fetare gjithashtu konsiderohen si të qëndrueshme, pasi vetëm 3.1% e të anketuarve mendojnë se rekrutuesit kanë gjasa ta kthejnë një individ në një ekstremist të dhunshëm në ato ambiente.


Në cilat ambiente/kontekste ka më shumë gjasa që një individ të bjerë pre e ekstremizmit të dhunshëm?



Grafiku 22 - Mjediset ku rekrutuesit janë më të suksesshëm

Në lidhje me vendet specifike të ekspozuara ndaj radikalizimit, një pjesë e madhe e qytetarëve (35.1%) mendojnë se vendet fetare të paautorizuara janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të radikalizimit. Ky fenomen është i ndërlidhur me ngjarjet e dekadës së fundit që ndodhën në Shqipëri. Xhamitë dhe vendet fetare jashtë autoritetit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë shërbyen si qeliza radikalizimi dhe rekrutimi për luftëtarët e huaj që më vonë u bashkuan me luftën në Siri dhe Irak, ose u arrestuan nga autoritetet ligjzbatuese. Lagjet dhe vendet private fetare (përkatësisht 20.2% dhe 21.7%) ishin gjithashtu me rëndësi për sa i përket rrezikut për radikalizim.

Cilat nga këto vende mendoni se janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të radikalizimit?




Grafiku 23 - Cilat ambiente janë më të ekspozuara ndaj kërcënimit të radikalizimit

Qytetarëve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse grupet radikale vazhdojnë akoma të rekrutojnë njerëz. 68.8% e qytetarëve janë të mendimit se radikalizimi është një proces i vazhdueshëm dhe grupet vazhdojnë të rekrutojnë njerëz. Vetëm 9.6% nuk besojnë kështu, ndërsa 21.6% të tjerë nuk kanë mendim.

Në lidhje me mënyrat se si ekstremistët i etiketojnë dhe u qasen personave që duan të rekrutojnë, 59.3% besojnë se kontaktet personale janë mënyra më e zakonshme për përhapjen e mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm, e ndjekur nga komunikimi përmes internetit (34.5%).


Cilat janë mënyrat më të përdorura për të përhapur mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm?



Grafiku 24 - Cilat janë mënyrat më të shpeshta për të shpërndarë mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm?

Në lidhje me ata që janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të radikalizimit, shumica e të anketuarve (71.1%) besojnë se të rriturit e moshës 16-25 vjeç janë më të rrezikuar nga radikalizimi, ndërsa 18.5% besojnë se edhe të rriturit në moshën 26-45 vjeç janë gjithashtu të rrezikuar nga radikalizimi. Perspektiva gjinore mbi rreziqet e radikalizimit nxori të dhëna interesante. Një shumicë domethënëse e të anketuarve (83.9%) në kampionin e plotë besojnë se meshkujt janë më të ekspozuar ndaj radikalizimit. Sidoqoftë, të analizuar veçmas, të anketuarat femra kanë një përqindje më të lartë (23.3%) sesa kampioni i plotë që besojnë se ato janë më të ekspozuara ndaj radikalizimit kur krahasohen me përgjigjet e përgjithshme.

Cilët janë më të rrezikuar nga radikalizimi?




Grafiku 25 - Cilat grupe janë më të rrezikuar nga radikalizimi

Shumë organizata të huaja fetare dhe fondacione humanitare mbërritën në Shqipëri që nga tranzicioni i hershëm për të mbështetur rikthimin e fesë. Disa prej këtyre organizatave u është atribuar përgjegjësia e promovimit të ideve ekstremiste fetare, shpesh duke ofruar privilegje financiare dhe materiale në këmbim të përthithjes së pozicioneve radikale.

28% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord me deklaratën "në komunitetin tim ka grupe fetare që ofrojnë privilegje ekonomike ose përfitime materiale për ata që praktikojnë fenë e tyre", ndërkohë që pothuajse gjysma e të anketuarve (46%) ose nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë.

Të pyetur nëse këto organizata i bëjnë komunitetet të cenueshme nga radikalizimi, 61% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord me këtë deklaratë.

Roli dhe ndikimi i organizatave të huaja në procesin e radikalizimit




Grafiku 26 - Roli dhe ndikimi e organizatave fetare të huaja në procesin e radikalizimit

Faktorët që ndikojnë te njerëzit për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm

Në vijim të aktorëve që nxisin EDH, ky nënseksion i pestë shfaq perceptimet e të anketuarve mbi faktorët që ndikojnë te njerëzit për të përqaftuar EDH. Të anketuarve ju kërkua të vlerësonin në çfarë mase besonin se secili faktor ndikon te njerëzit për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm. Shumica dërrmuese e të anketuarve besojnë se faktorët kryesorë ndikues për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm janë kushtet e vështira ekonomike dhe mungesa e mundësive (84%), arsimi i dobët (80%), korrupsioni dhe keqqueverisja (72%), si dhe shtrembërimi dhe keqpërdorimi i besimeve (58%). Më pak se gjysma e të anketuarve besojnë se faktorët e mëposhtëm ndikojnë gjithashtu shumë te njerëzit për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm: marginalizimi dhe diskriminimi (49%), e kaluara dhe motivimi i individit (42%), propaganda fetare (34%) dhe konfliktet e armatosura jashtë vendit (34%).


Faktorët që ndikojnë te njerëzit që përqafojnë ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri



Grafiku 27 - Faktorët që ndikojnë te njerëzit që përqafojnë EDH në Shqipëri

Vlen të përmendet se përkundër rëndësisë që i atribuohet në literaturë propagandës fetare, të shkuarës dhe motivimit të individit, përqindja e atyre që mendojnë se këto nuk ndikojnë aspak te njerëzit për të përqaftuar ekstremizmin e dhunshëm është më e larta, përkatësisht 13.5% dhe 13.7%.

Faktorët që ndikojnë te njerëzit që përqafojnë ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri




Grafiku 28 - Faktorët që ndikojnë te njerëzit që përqafojnë EDH në Shqipëri

Të anketuarve iu ofrua një deklaratë për të cilën ata mund të binin dakord ose jo (në një shkallë nga 1 në 5) mbi faktorë të ndryshëm që njihen gjerësisht nga studimet e mëparshme si nxitës të radikalizimit.

Ekziston një korrelacion i fortë me rezultatet e përgjigjeve të mëparshme. Kushtet e dobëta ekonomike dhe mungesa e arsimit të duhur konsiderohen si nxitësit më të fortë nga numri më i madh i të anketuarve, të ndjekur nga qeverisja e dobët, mungesa ose drejtësia selektive dhe diskursi negativ politik, të cilat gjithashtu kontribuojnë në radikalizim.


Opinionet rreth faktorëve që kontribuojnë në radikalizim



Grafiku 29 - Faktorët që kontribuojnë në radikalizim

Nevoja për identitet dhe perceptimi i përfaqësimit jo të duhur politik identifikohen në literaturë si nxitës të radikalizimit. Rreth 50% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord se nevoja për identitet dhe përkatësi i bën individët më të cenueshëm ndaj radikalizimit. Nga ana tjetër, një përqindje e ngjashme është dakord ose plotësisht dakord se feja e tyre ka përfaqësim të mirë në politikë. Rreth 30% nuk kanë mendim të qartë për të dyja pyetjet, ndërsa rreth 20% deklarojnë se komuniteti i tyre fetar nuk është i përfaqësuar në mënyrë të duhur në politikë. 15% ose nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord se nevoja për identitet dhe përkatësi i bën individët më të cenueshëm nga radikalizimi.

Identiteti dhe përfaqësimi politik si nxitës të radikalizimit



Grafiku 30 - Identiteti dhe përfaqësimi politik si nxitës i radikalizimit

Pozicionimi në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm

Nëseksioni i gjashtë është përqendruar në njohjen e audiencave të Ingram-it në Bashkinë e Tiranës, e cila është thelbësore për konceptimin dhe përshtatjen e mesazheve për të luftuar narrativat dhe mesazhet që promovojnë EDH. Në mënyrë që të grumbulloheshin të dhëna për të kuptuar këto audienca, të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre mbi një sërë pyetjesh që mund të ndihmojnë në vlerësimin e qëndrimit të këtyre audiencave rreth ekstremizmit.

Disa nga çështjet e diskutuara në kontekstin aktual përfshijnë kontrollimin e grupeve dhe individëve të radikalizuar nga shteti, lirinë për të shprehur dhe përhapur mendimet dhe ideologjinë e tyre si pjesë të lirisë së fjalës që mbështetet nga të drejtat kushtetuese dhe mohimi i radikalizmit duke e përshkruar atë si liri fetare, e cila mund të mbrohet edhe duke u përfshirë në veprime të dhunshme, nëse është e nevojshme. Të anketuarve iu ofruan një sërë deklaratash me të cilat ata mund të pajtoheshin ose të mos pajtoheshin.

Gjetjet tregojnë se 68.6% e të anketuarve mendojnë se ata që kanë pikëpamje radikale duhet të ndalohen plotësisht. Nga ana tjetër, 5.8% nuk janë dakord ose priren të mos jenë dakord, ndërsa 22.5% të tjerë priren të jenë dakord se grupet që promovojnë ide radikale duhet të ndalohen.


Rreth një e treta e të anketuarve (32.5%) mendojnë se grupet e radikalizuara duhet të kenë të drejtën të shprehin mendimet dhe ideologjinë e tyre, por duhet të kontrollohen nga institucionet qeveritare. Bashkuar me numrin e njerëzve (27.7%) që priren të jenë dakord me garantimin e lirisë së kontrolluar të shprehjes për grupet e radikalizuara, një numër i madh i qytetarëve të Tiranës ia besojnë shtetit rolin për të kontrolluar grupet e radikalizuara.

12.3% e qytetarëve mendojnë se grupet e radikalizuara duhet të jenë të lira të shprehin mendimet dhe ideologjinë e tyre, dhe se i takon çdo qytetari të vendosë t'i ndjekë apo jo ato, kurse 25.7% priren të pajtohen me këtë. Megjithëse nuk ka ndryshime të dukshme midis kategorive të ndryshme të të anketuarve, këta të fundit, brenda secilës kategori janë shumë të ndarë në përgjigjet e tyre. Për shembull, në kampionin e plotë, 38% e të anketuarve ose priren të jenë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën, 59% të tjerë ose priren të mos jenë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën. Mospërputhje të tilla brenda grupit janë vërejtur në të gjitha kategoritë e të anketuarve. Mungesa më e lartë e konsensusit brenda grupit është te ata me arsim të lartë ku ndryshimi midis atyre që priren të jenë dakord/plotësisht dakord atyre që priren të mos jenë dakord/aspak dakord është vetëm 11% në favor të këtyre të fundit.

9.5% e qytetarëve janë plotësisht dakord se ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi është liri fetare e shprehjes, ndërsa 11.9% priren të mendojnë të njëjtën gjë. 7% e qytetarëve janë plotësisht dakord ose priren të jenë dakord se është detyrimi i të gjithëve të luftojnë për fenë e tyre, edhe duke u përfshirë në veprime të dhunshme nëse është e nevojshme, për të mbrojtur bindjet fetare.

Grafiku më poshtë jep në hollësi spektrin e plotë të opinionëve rreth këtyre çështjeve.

Perceptimi i radikalizimit në Tiranë



Grafiku 31 - Perceptimet rreth radikalizimit në Tiranë

Sistemi i të kuptuarit si baza e radikalizimit


Një grup tjetër pyetjesh u hartuan për të mbledhur të dhëna rreth shkallës në të cilin audiencat e perceptojnë krizën e identitetit që ekstremistët e dhunshëm i përçojnë këtyre audiencave. Pyetjet u hartuan për t'u njohur me mendimin e qytetarëve mbi një sërë çështjesh që janë promovuar nga ekstremistët, të tilla si portretizimi i Perëndimit si një armik i islamit, delegjtimimi i institucioneve shtetërore shqiptare dhe promovimi i përgjithshëm i krizës brenda grupit.

Narrativa se Perëndimi është armiqësor ndaj fesë islame, dhe për këtë arsye është detyrim për myslimanët që të pozicionohen kundër Perëndimit apo edhe ta luftojnë atë, është identifikuar si një nga narrativat dominuese nga një sërë studimesh. Sondazhi u përpoq të kuptojë shkallën e kësaj narrative në audiencën e Bashkisë së Tiranës duke shtruar pyetjen nëse Perëndimi është armiqësor me vendet dhe kulturën myslimane dhe në lidhje me orientimin politik perëndimor të Shqipërisë.

81.5% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord se Shqipëria duhet të ketë një orientim politik perëndimor ndërsa 6.2% nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë. 12.3% kanë qëndrim neutral për këtë pyetje. Megjithëse ekziston një konsensus i gjerë i të anketuarve nga të gjitha kategoritë që Shqipëria duhet të ketë një orientim politik perëndimor, ku vetëm 6% priren të mos jenë dakord ose të mos jenë aspak dakord me këtë, është interesante që një në dhjetë të anketuar nga moshat 18-34 vjeç ose priret të mos jetë dakord ose nuk është aspak dakord me deklaratën.

Përqindja e atyre që janë dakord se Perëndimi është armiqësor ndaj vendeve dhe kulturës myslimane është më e lartë, pasi gati 20% e të anketuarve mendojnë kështu, ndërsa 23% të tjerë janë të pavendosur. Rreth 57% nuk janë dakord me deklaratën.

Opinioni rreth Perëndimit, Islamit dhe Shqipërisë




Grafiku 32 - Opinioni në lidhje me Perëndimin, Islamin dhe Shqipërinë

Duke pasur parasysh ndikimin dhe rolin e ISIS-it në promovimin e radikalizmit dhe tërheqjen e shtetasve shqiptarë për t'iu bashkuar atyre, qytetarët u pyetën nëse pajtoheshin ose jo me deklaratën se ISIS ishte përfaqësuesi i vërtetë i islamit, përgjigje e cila ndihmon në përcaktimin e pozicionimit të të anketuarve.

Më shumë se dy të tretat e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë. Megjithatë, 8% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord se ISIS ishte përfaqësuesi i vërtetë i islamit (5.5% janë dakord dhe 2.5% janë plotësisht dakord), ndërsa rreth 15% kanë qëndrim neutral. Përqindje pak më të larta që e perceptojnë ISIS-in si përfaqësuesin e vërtetë të islamit vërehen te meshkujt midis moshave 18 deri në 34 vjeç dhe personat me arsim të lartë.

"Shteti Islam në Siri dhe Irak ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit"




Grafiku 33 - Opinioni rreth Shtetit Islamik

Në vitin 2014, autoritetet shqiptare arrestuan nëntë persona, dy prej të cilëve ishin imamë të vetë-shpallur në dy xhami të zonave periferike të Tiranës. Të arrestuarit u akuzuan për "rekretim e personave për kryerjen e akteve terroriste ose financimin e terrorizmit", "nxitje, thirrje publike dhe propagandë për kryerjen e veprimeve kriminale me qëllime terroriste" dhe "nxitje të urrejtjes ose grindjeve midis kombësive, racave dhe feve". Më pas, të arrestuarit u dënuan nga gjykata me burgim, i cili varionte nga 5 në 18 vjet.

Sondazhi tregon se 7.6% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord se këta persona u arrestuan padrejtësisht për shkak të fesë së tyre. 28.3% të tjerë kanë qëndrim neutral për këtë çështje, ndërsa gati dy të tretat e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord që këta persona janë arrestuar padrejtësisht.

Një opinion i ngjashëm është dhënë rreth paanësisë së institucioneve të zbatimit të ligjit të cilat vlerësohen si më të ashpra me praktikuesit fetarë të "fesë sime."

Opiniononi rreth paanësisë së institucioneve të zbatimit të ligjit në lidhje me radikalizmin fetar




Grafiku 34 - Sa dakord jeni me deklaratën: "Autoritetet shqiptare arrestuan padrejtësisht nëntë myslimanë shqiptarë në vitin 2014 për shkak të besimit të tyre fetar"

Duke qenë se grupet radikale tentojnë të krijojnë një lidhje të fortë brenda grupit, e cila përdoret për të nxitur ndarjen me ata që janë jashtë grupit, të anketuarit u pyetën nëse ishin dakord që një besimtar i vërtetë nuk duhet të denoncojë anëtarët e bashkësisë së tij fetare të cilët kanë pikëpamje ekstremiste të dhunshme.

Shumica dërrmuese, 90%, janë dakord ose plotësisht dakord se ata që kanë pikëpamje ekstremiste të dhunshme duhet të dënohen. Megjithatë, 5.3% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë, ndërsa 5.4% kanë qëndrim neutral.

Opinionimi rreth fesë dhe radikalizimit



Grafiku 35 - Opinioni i të anketuarve rreth fesë dhe radikalizimit

Të anketuarve ju kërkua gjithashtu të jepnin mendimin e tyre për shkallën në të cilën ata mendonin se besimtarët duhet të mbrojnë dinjitetin e tyre fetar në çdo mënyrë. 63.5% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën se është detyra e besimtarëve të mbrojnë dinjitetin e tyre fetar në çdo mënyrë. Nga ana tjetër, 16.2%, janë dakord ose plotësisht dakord me deklaratën se një besimtar e ka për detyrë të mbrojë dinjitetin e tij/saj fetar me çdo mënyrë, ndërsa 20% kanë një qëndrim neutral.

Të anketuarve iu kërkua gjithashtu të jepnin mendimin e tyre mbi praninë e individëve radikalë në komunitetet e tyre që kërkonin të ndikonin te njerëzit e tjerë për t'u bashkuar me kauzat e tyre ekstreme. Dy të tretat mendojnë se nuk ka besimtarë të tillë radikalë në komunitetet e tyre. Vetëm 10% janë dakord ose plotësisht dakord me këtë deklaratë, ndërsa 24.6% kanë një qëndrim neutral.

Një pyetje tjetër kishte për qëllim të adresonte prirjen e narrativave të ekstremizmit të dhunshëm për të sfiduar diversitetin fetar dhe harmoninë në Shqipëri. Të anketuarit u pyetën nëse Shqipëria do të ishte një vend më i mirë nëse më shumë njerëz do të bashkoheshin me fenë e tyre.

23% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord me këtë deklaratë, ndërsa 23% të tjerë kanë qëndrim neutral në lidhje me këtë pyetje. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve 53.6%, nuk janë aspak dakord ose nuk janë dakord.

Tensionet fetare si nxitës potencialë të ekstremizmit

Një nga masat e ndërmarra për të parandaluar radikalizimin ka qenë kriminalizimi i pjesëmarrjes në konfliktet e huaja. Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për mbështetjen e kësaj mase ligjore. 60% e qytetarëve mendojnë se angazhimi i shtetasve shqiptarë në konflikte të huaja nuk duhet të lejohet. 12% e qytetarëve nuk janë dakord me deklaratën dhe mbështesin idenë se qytetarët shqiptarë duhet të jenë të lirë të marrin pjesë në konfliktet e huaja. Në një studim tjetër rreth 21% e të anketuarve ose nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me deklaratën "Nxitja ose përfshirja në konflikte të armatosura jashtë vendit nuk duhet të lejohet."¹⁴²

Të pyetur nëse autoritetet shqiptare duhet të riadhesojnë shtetasit shqiptarë të cilët pas kapitullimit të ISIS-it kanë mbetur në kampet e Irakut dhe Sirisë, shumica janë dakord (25.7%) ose plotësisht dakord (47.6%). Vetëm 12.3% nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord.


Përgjigjet tregojnë se publiku është i ndarë në këtë çështje, prandaj institucionet shtetërore duhet të luajnë një rol në rritjen e ndërgjegjësimit dhe për të sqaruar qytetarët mbi kërcënimet reale të radikalizimit dhe nevojën për të integruar një individ të caktuar në shoqëri.

Opinionet janë të fragmentuara në lidhje me kërcënimin e perceptuar të sigurisë nga të rikthyerit. 41% e të anketuarve besojnë ose besojnë plotësisht se të rikthyerit nga Siria do të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e komuniteteve të tyre, ndërsa 33% e të anketuarve ose besojnë ose besojnë plotësisht se të rikthyerit nga Siria nuk do të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e komuniteteve të tyre. Një e katërta e audiencës ka qëndrim neutral.

Vetëm 19% e të anketuarve nga zonat rurale janë dakord ose janë plotësisht dakord që të rikthyerit nga Siria do të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e komuniteteve të tyre. Ndërsa të anketuarit me arsim të lartë kanë përqindjen më të lartë (52.5%) që janë dakord ose plotësisht dakord me deklaratën. Duke pasur parasysh përqindjen e lartë të të anketuarve që besojnë se të rikthyerit nga Siria do të përbëjnë një kërcënim për sigurinë, kjo do të thotë se ka ende punë për t'u bërë nga ana e qeverisë në mënyrë që të sigurohet që të rikthyerit nuk do të përbëjnë kërcënim për komunitetet pritëse, të bindin publikun se ata nuk përbëjnë një kërcënim për komunitetet e tyre dhe të dëgjojnë shqetësimet dhe ankesat e mundshme të publikut në këtë kuadër.

¹⁴² Vurmo, Gj. dhe të tjerë. (2018). Toleranca Fetare në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe UNDP. <http://idmalbania.org/religious-tolerance-albania/> (aksesuar në 10 tetor 2020).

Opinioni rreth pjesëmarrjes në konflikte të huaja si dhe rreth të rikthyerve nga Siria dhe Iraku




Grafiku 36 - Opinioni rreth pjesëmarrjes në konflikte të huaja dhe të rikthyerve nga Siria dhe Iraku

Meqenëse donacionet nga organizatat e ndryshme fetare të huaja janë përdorur për të promovuar narrativa ekstremiste të dhunshme, disa vende evropiane kanë ndërmarrë masa për të kontrolluar ose ndaluar krejtësisht këto donacione. Në vitin 2004 Shqipëria miratoi ligjin "Masat kundër Financimit të Terrorizmit" dhe ngriu pasuritë e financuesve të terrorizmit duke kufizuar aktivitetet e OJQ-ve islamike të dyshimta.

Të pyetur nëse komunitetet fetare të Shqipërisë duhet të pranojnë donacione të huaja, gati gjysma e të anketuarve (46%) ose ishin dakord ose plotësisht dakord që komunitetet fetare mund të pranojnë donacione të tilla, ndërsa 28% ose nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord. Të anketuarit nga zonat rurale kishin prirjen më të lartë për të mos rënë dakord (33.3%).

“Komunitetet fetare në Shqipëri duhet të pranojnë donacione të huaja”




Grafiku 37 - Sa dakord jeni me deklaratën: “Komunitetet fetare në Shqipëri duhet të pranojnë donacione të huaja”

Në rast se komunitetet fetare do të financohen vetëm nga fondet brenda Shqipërisë, të anketuarit u pyetën se nga duhet të vijnë këto fonde. 78% u përgjigjën se nëse komunitetet fetare do të financoheshin vetëm nga fonde brenda Shqipërisë, ato fonde duhet të vijnë nga kontributet vullnetare të ndjekësve të tyre. Vetëm 16% e të anketuarve mendojnë se këto fonde duhet të vijnë nga buxheti i shtetit.

Të anketuarit e zonave urbane dhe rurale kishin përgjigje të ndryshme. 21% e të anketuarve nga zonat urbane mendojnë se këto fonde duhet të vijnë nga buxheti i shtetit, ndërsa vetëm 3% e të anketuarve nga zonat rurale mendojnë kështu.

Nëse komunitetet fetare financohen vetëm nga fondet brenda Shqipërisë, nga duhet të vijnë këto fonde?




Grafiku 38 - Nëse komunitetet fetare financohen vetëm nga fondet brenda Shqipërisë, nga duhet të vijnë këto fonde?

Një çështje tjetër e diskutuar që konsiderohet si një burim i përçarjes shoqërore që mund t'i bëjë njerëzit të përqafojnë radikalizmin është mbajtja e simboleve të dukshme fetare. Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre se sa ishin dakord me deklaratën “Mjekra për burrat ose shamia për gratë nënkuptojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.”

Më shumë se 75% nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën, ndërsa 14% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord. Të anketuarit me arsim të lartë dhe të anketuarat femra perceptojnë një ndërlidhje më të lartë të simboleve fetare me ekstremizmin. Megjithatë shumica e kategorive të të anketuarve kanë përgjigje të ngjashme, është interesante që të anketuarit e moshave nga 18-34 vjeç kanë përqindjen më të ulët (10%) të atyre që bien dakord ose plotësisht dakord me deklaratën, ndërsa të anketuarit e moshave nga 34-64 vjeç kanë përqindjen më të lartë (17%) të atyre që bien dakord ose plotësisht dakord me deklaratën.

“Mjekra për burrat ose shamia për gratë nënkuptojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë”



Grafiku 39 - Opinioni rreth simboleve fetare dhe ekstremizmit


Një temë tjetër, e cila lidhet me debatin shqiptar në lidhje me rolin e shtetit dhe marrëdhëniet midis shtetit dhe feve, pretendohet si e drejtë nga grupet e ndryshme fetare për të kryer veprimtari fetare në objekte që nuk janë në juridiksionin e komuniteteve fetare të ligjshme, i tillë është rasti i atyre që njihen si "xhami të paligjshme."

Xhamitë e Shqipërisë që veprojnë jashtë standardeve ligjore dhe autoritetit të KMSH janë bërë vende potenciale për mbjelljen e ideve radikale islamike dhe qendra të radikalizimit.¹⁴³ Shumica e luftëtarëve të huaj nga Shqipëria që iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak kishin lidhje me një xhami në periferi të Tiranës që vepronte jashtë autoritetit të KMSH. Shumë qytetarë ende i konsiderojnë të dyshimta vendet e adhurimit që funksionojnë jashtë juridiksionit të komuniteteve zyrtare fetare.

¹⁴³ Fatjona Mejdini. Uncontrolled Mosques Proliferate in Albania. BIRN December 17, 2015. <https://balkaninsight.com/2015/12/17/state-slams-albanian-muslim-over-uncontrolled-mosques-12-17-2015/>

Shumica e të anketuarve, 74.5% janë të mendimit se objektet fetare pa lejen e komunitetit fetar përkatës duhet të ndalohen. Sidoqoftë, rreth 5.7% nuk janë aspak dakord ose nuk janë dakord me këtë deklaratë, ndërsa 7.3% kanë qëndrim neutral. Numri i të anketuarve që banojnë në zonat rurale që janë dakord ose plotësisht dakord është shumë më i lartë (96.2%), që mund të lidhet me faktin se problemi i institucioneve dhe objekteve fetare që funksionojnë pa lejen e komunitetit fetar përkatës ka qenë i pranishëm vetëm në zonat urbane.

“Objektet fetare pa lejen e bashkësisë fetare përkatëse duhet të ndalohen”



	Kampioni i plotë	18-34 vjeç
■ Aspak dakord	3.80%	4.20%
■ Nuk jam dakord	1.90%	4.20%
■ Neutral	7.30%	8.70%
■ Dakord	12.50%	13.90%
■ Plotësisht dakord	74.50%	69%

Grafiku 40 - Sa dakord jeni me deklaratën: "Objektet fetare pa lejen e bashkësisë fetare përkatëse duhet të ndalohen"?

Sipas një sondazhi tjetër kombëtar, 22% e të anketuarve nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me ndalimin e objekteve të paligjshme fetare.¹⁴⁴

Argumenti kryesor që ka shërbyer për justifikimin e pranisë së klerikëve të huaj në Shqipëri, ka qenë mungesa e klerikëve shqiptarë të kualifikuar. Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse klerikët fetarë të institucioneve zyrtare në Shqipëri kanë kualifikimin e duhur fetar.


¹⁴⁴ Gjergji Vurmo dhe të tjerë. (2018). Toleranca Fetare në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. <http://idmalbania.org/religious-tolerance-albania/> (aksesuar në 10 tetor 2020).

Përgjigjet tregojnë një fragmentim të madh rreth kësaj teme, ndryshime midis banorëve urbanë dhe rurale, si dhe atyre me arsim të lartë.

16% e kampionit të plotë të të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë, ndërsa vetëm gati 2% e banorëve nga zonat rurale ndajnë të njëjtin mendim.

Personat me arsim të lartë përfaqësojnë përqindjen më të lartë (21%) të atyre që nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën se klerikët fetarë të institucioneve zyrtare në Shqipëri kanë kualifikimin e duhur fetar.


“Klerikët fetarë të institucioneve zyrtarë në Shqipëri kanë kualifikimin e duhur fetar”



Grafiku 41 - Opinioni rreth kualifikimit të klerikëve fetarë

Në rastin e Shqipërisë, objektet fetare jozyrtare, kanë qenë një burim radikalizimi.¹⁴⁵ Të pyetur nëse njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime jozyrtare fetare nëse nuk pajtohen me interpretimin e komunitetit zyrtar të fesë të tyre, një në katër të anketuar ose është dakord ose është plotësisht dakord. Ndërkohë, nga ata me arsim të lartë, pothuajse një në tre ose është dakord ose është plotësisht dakord me deklaratën. Një përqindje e konsiderueshme kanë qëndrim neutral. Vetëm 45% e të gjithë kampionit nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord se njerëzit duhet të ndjekin interpretime jozyrtare fetare.

Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me interpretimin e bashkësive zyrtare të feve të tyre”




Grafiku 42 - Opinioni rreth të drejtës për të ndjekur interpretimet fetare jozyrtare

¹⁴⁵ Çobo, S, 2016, "Imamët rekrutuan edhe nëna me fëmijë, dërguan në Siri 70 luftëtarë." Gazeta Shqip: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2015/02/26/imamet-rekrutuan-edhe-nena-me-femije-derguan-ne-siri-70-luftetare/>.

Lidhur me rolin e shtetit në monitorimin e veprimtarive fetare, tre të katërtat e të anketuarve (75.1%) janë dakord ose plotësisht dakord, ndërsa 11% kanë qëndrim neutral për këtë çështje. 14% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord që shteti duhet të monitorojë aktivitetet fetare. Në mesin e të anketuarve, meshkujt 14.6% dhe ata që banojnë në zonat rurale 18.3% përbëjnë pjesën më të madhe të atyre që kanë një mendim të tillë.

"Aktivitetet fetare duhet të monitorohen nga shteti"




Grafiku 43 - Opinioni rreth rolit të shtetit në monitorimin e aktiviteteve fetare

Qasjet për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm

Në përgjithësi, ekstremizmi i dhunshëm shihet me shqetësim nga shumica e qytetarëve të anketuar. Të pyetur nëse mendojnë se anëtarët e grupeve ekstremiste të dhunshme mund të kryejnë akte të dhunshme/terroriste në Shqipëri, 73% janë të mendimit se ky rrezik ekziston, ndërsa 19.1% besojnë të kundërtën. Perceptimi se një rrezik i tillë ekziston është më i lartë te femrat e anketuara (77.4%).

A mendoni se anëtarët e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm mund të kryejnë akte të dhunshme/terroriste në Shqipëri?



Grafiku 44 - Opinioni rreth mundësisë të kryerjes së akteve terroriste në Shqipëri nga grupet e EDH

Ekstremizmi i dhunshëm konsiderohet si një kërcënim edhe për demokracinë, kohezionin social dhe sigurinë nga shumica e qytetarëve.


42% e të anketuarve janë plotësisht dakord se ekstremizmi i dhunshëm përbën një kërcënim për kohezionin social të Shqipërisë dhe 44% të tjerë janë dakord. Të anketuarit nga zonat rurale kanë përqindjen më të ulët (3%) të personave që nuk janë aspak dakord me deklaratën.

54% e të anketuarve janë plotësisht dakord se ekstremizmi i dhunshëm përbën një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë dhe 28.7% të tjerë janë dakord. Të anketuarit nga zonat urbane (21%) dhe

ata me arsim të lartë (22%) përbëjnë dy kategoritë që kanë përqindjen më të lartë të personave që nuk janë aspak dakord me deklaratën, ndërsa vetëm 1% e të anketuarve nga zonat rurale nuk janë aspak dakord me të.

48.7% janë plotësisht dakord se ekstremizmi i dhunshëm përbën një kërcënim për demokracinë e Shqipërisë, ndërsa 28.1% e të anketuarve nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë.

Opinioni rreth kërcënimeve që paraqiten nga ekstremizmi i dhunshëm



Grafiku 45 - Sa dakord jeni me deklaratën: ekstremizmi i dhunshëm përbën një kërcënim për kohezionin social, sigurinë dhe demokracinë e Shqipërisë?

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre rreth rolit të institucioneve ligjzbatuese në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe rolit të komunikimit dhe mesazheve.


Vërehet se në përgjithësi ka një prirje për t'i kushtuar më shumë rëndësi institucioneve ligjzbatuese sesa komunikimit të mesazheve dhe narrativave alternative.

62.3% e të anketuarve mendojnë se monitorimi më i kujdesshëm i grupeve ekstremiste nga policia dhe shërbimet informative do të zvogëlonte shumë kërcënimin nga ekstremizmi i dhunshëm. Vetëm 36.2% mendojnë se komunikimi i mesazheve alternative do të ketë të njëjtin ndikim në uljen e kërcënimit nga ekstremizmi i dhunshëm.

Të anketuarit e zonave rurale janë kategoria me përqindjen më të lartë (79.2%) të atyre që mendojnë se monitorimi nga policia dhe shërbimet informative do të kontribuonte shumë në uljen e rrezikut nga ekstremizmi i dhunshëm. Megjithatë, ata mbështesin edhe komunikimin, pasi 56.7% shprehen se edhe komunikimi do të kontribuonte shumë.

Të anketuarit e moshave 18 deri 34 vjeç janë më skeptikë në lidhje me komunikimin dhe vetëm 35.8% deklarojnë se ai mund të kontribuojë shumë në uljen e rrezikut nga ekstremizmi i dhunshëm.

Mënyrat për të zvogëluar kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm




Grafiku 46 - Mënyrat për të zvogëluar kërcënimin nga ekstremizmi i dhunshëm

Riintegrimi në shoqëri është identifikuar si një mënyrë e zbatueshme e parandalimit pasi kërkon të luftojë ndarjen shoqërore që promovohet nga ekstremistët e dhunshëm, prandaj ky studim u përpoq të eksploronte opinionet e qytetarëve në lidhje me këtë qasje.

Rezultatet tregojnë se të anketuarit nuk janë aq të sigurt për efektshmërinë e riintegrimit të ekstremistëve të dhunshëm në shoqëri. Vetëm 24% u përgjigjën se janë shumë dakord që ish-ekstremistët të riintegrohen në shoqëri, ndërsa 31.7% nuk është dakord, dhe 38.5% të tjerë janë disi dakord.

Kur u pyetën nëse riintegrimi është i mundur, vetëm 15% ishin shumë dakord ndërsa 23.9% nuk ishin dakord.


Mbështetja dhe besimi te ri-integrimi i ish ekstremistëve



Grafiku 47 - Mbështetja dhe vetëbesimi për integrimin e ish ekstremistëve

Të anketuarit u pyetën gjithashtu se deri në çfarë mase e vlerësonin efektshmërinë e përpjekjeve të përgjithshme të ndërmarra në Shqipëri për të kundërshtuar EDH. Shumica më e madhe e të anketuarve (64%) mendojnë se masat e ndërmarra janë deri diku të efektshme. Rreth 15.8% i konsiderojnë ato të efektshme ose shumë të efektshme dhe e njëjta përqindje (16%) mendojnë se ato nuk janë aspak të efektshme.

Deri në çfarë mase vlerësoni efektshmërinë e përpjekjeve të përgjithshme të ndërmarra deri tani për të kundërshtuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?




Grafiku 48 - Deri në çfarë mase vlerësoni efektshmërinë e përpjekjeve të përgjithshme të ndërmarra deri tani për të kundërshtuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?

Burimet e informimit

Media njihet si një faktor i fuqishëm, që mund të kontribuojë në parandalimin dhe kundërshtimin e EDH. Megjithatë, media mundet të luajë edhe rolin e kundërt me ose pa qëllim. Qytetarëve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre mbi rolin e medias në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe mbi ndikimin e tij të mundshëm negativ.

Të anketuarit e vlerësojnë rolin e medias si të rëndësishëm në përpjekjet për parandalimin, por edhe në nxitjen e ekstremizmit të dhunshëm përmes raportimit të pasaktë. Vetëm rreth 10% e të anketuarve mendojnë se media nuk mund të luajë asnjë rol.




Grafiku 49 - Roli i medias në nxitjen ose parandalimin e ekstremizmit

Në mënyrë që të identifikohen kanalet më të shpeshta të informimit, që mund të përdoren për të dërguar narrativat parandaluese dhe kundër-narrativat, të anketuarve iu kërkua të tregonin burimet e informimit që ata përdornin. Atyre iu kërkua të tregonin burimin e tyre më të shpeshtë të informimit, burimin e dytë më të shpeshtë të informimit dhe burimin e tretë më të shpeshtë të informimit.

Shumica e të anketuarve (58%) renditën internetin si burimin e tyre më të shpeshtë të informimit. Kjo përqindje është e ngjashme me të dhënat e publikuara nga Data Report 2019.¹⁴⁶ Më shumë se dy milion qytetarë të Shqipërisë, 69% e popullsisë së përgjithshme, janë përdorues të internetit.

39% e të anketuarve renditën televizionin si burimin e tyre më të shpeshtë të informimit. Shumica e të anketuarve e renditën televizionin si burimin e tyre të dytë më të shpeshtë të informimit, ndërsa 29% renditën internetin. Së fundmi, 20% e të anketuarve i renditën gazetatat si burimin e tyre të tretë më të shpeshtë të informimit, 17% e renditën radion, 14% televizionin dhe 11% e të anketuarve e renditën internetin si burimin e tyre të tretë më të shpeshtë të informimit.




Grafiku 50 - Burimet e informimit (kampioni i plotë)

Rezultatet e sondazhit tregojnë se megjithëse interneti dhe televizioni mbeten burimet kryesore të informimit, madje edhe për grupmoshën nga 18 deri në 34 vjeç, interneti është shumë më i përdorur si burimi kryesor prej tyre dhe në mënyrë të ngjashme televizioni si burimi i dytë (Shih grafikun më poshtë).

¹⁴⁶ Digital Around the World in 2019, Albania <https://www.slideshare.net/DataReportal/digital-2019-albania-january-2019-v01>


Burimet e informimit për moshat 18-34 vjeç



Grafiku 51 - Burimet e informimit (grupmosha 18-34 vjeç)

Për banorët e zonave rurale, televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informimit, për shkak të aksesit të kufizuar në internet në ato zona. Gjithsesi, edhe aty interneti është burimi i dytë më i rëndësishëm.

Burimet e informimit për zonat rurale




Grafiku 52 - Burimet e informimit (banorët e zonave rurale)

Përdorimi i rrjeteve sociale

Sipas të dhënave të janarit 2020, në Shqipëri ka rreth 2.07 milion përdorues të internetit dhe 1.40 milion përdorues të mediave sociale.¹⁴⁷ Të anketuarve iu kërkua të renditnin rrjetet sociale që ata përdorin më shpesh. Në përputhje me të dhënat ekzistuese të mediave sociale për vendin, dy rrjetet sociale më të shpeshta të raportuara nga të anketuarit e këtij sondazhi ishin Facebook (38%) dhe Instagram (37%).

¹⁴⁷ The Global Digital Report 2020, Albania. <https://datareportal.com/reports/digital-2020-albania>.

Përdorimi i rrjeteve sociale




Grafiku 53 - Përdorimi i mediave sociale

YouTube u raportua si rrjeti social i parë vetëm nga 8% e të anketuarve në sondazh. Vetëm 14% e të anketuarve deklaruan se nuk përdorin asnjë rrjet social. Në lidhje me rrjetin e dytë social më të përdorur, 32% deklaruan Facebook, 24% Instagram, 20% YouTube. 20% e të anketuarve deklaruan se nuk përdorin asnjë rrjet social të dytë. Në lidhje me rrjetin e tretë social më të përdorur, 39% deklaruan YouTube, 9% Facebook, 6% Instagram. 29% e të anketuarve thanë se nuk përdorin asnjë rrjet social të tretë. Gjetjet nga sondazhi reflektojnë ato të Global Digital Report 2019, të cilat tregojnë se në Shqipëri janë 1.3 milion (46% e popullsisë) përdorues aktivë të Facebook çdo muaj dhe 900,000 (32% e popullsisë) përdorues aktivë të Instagram në muaj.¹⁴⁸

Për grupmoshën 18-34 vjeç, Instagram, Facebook dhe YouTube shfaqen si rrjetet sociale më të përdorura, por në nivele më të larta se mesatarja (Shih grafikun më poshtë).

¹⁴⁸ The Global Digital Report 2019, Albania. <https://www.slideshare.net/DataReportal/digital-2019-albania-january-2019-v01>


Përdorimi i rrjeteve sociale për moshat 18-34 vjeç



Grafiku 54 - Përdorimi i mediave sociale (grupmosha 18-34 vjeç)

Për banorët e zonave rurale Facebook është rrjeti social më i përdorur, i ndjekur nga Instagram dhe YouTube. 42% deklarojnë se nuk përdorin fare rrjete sociale, e cila është mjaft domethënëse dhe në përpjesëtim me përdorimin më të kufizuar të internetit nga banorët e zonave rurale.

Përdorimi i rrjeteve sociale në zonat rurale




Grafiku 55 - Përdorimi i mediave sociale (banorët e zonave rurale)

Shumica dërrmuese e të anketuarve (81%) përdorin celularin si mjetin e tyre të parë të komunikimit. Ndërsa, një në dhjetë të anketuar përdor WhatsApp si mjetin e tyre të parë të komunikimit. 69% e të anketuarve përdorin WhatsApp si mjetin e tyre të dytë të komunikimit, ndërsa 14% e të anketuarve përdorin celularin si mjetin e tyre të dytë të komunikimit. Afërsisht një në tre të anketuar përdorin Viber si mjetin e tyre të tretë të komunikimit, 14% përdorin celularin si mjetin e tyre të tretë dhe 13% përdorin WhatsApp. Telegrami, i cili është identifikuar si një mjet shumë i preferuar i komunikimit nga ISIS,¹⁴⁹ për shkak të kriptimit të tij të sigurt, përdoret si mjeti i tretë dhe i katërt i komunikimit përkatësisht me 3.5% dhe 3.8%. Vetëm 0.2% dhe 0.5% e përdorin atë si mjetin e parë dhe të dytë të komunikimit.

¹⁴⁹ Bloom, Mia, Hicham Tiflati, and John Horgan. "Navigating ISIS's preferred platform: Telegram1." *Terrorism and Political Violence* 31.6 (2019): 1242-1254.

Mjetet më të shpeshta të komunikimit



Grafiku 56 - Cilat janë mjetet më të shpeshta të komunikimit që përdorni?

Aktorët e besueshëm dhe qasjet e komunikimit të mesazheve

Të dhënat e studimit tregojnë se të anketuarit besojnë se aktorët më të besueshëm për të përcjellë mesazhe kundër radikalizimit janë: (1) njerëzit me popullaritet të lartë që mund të përçojnë mesazhet në audiencën e gjerë (65%), (2) personalitet kulturore (63%) dhe përfaqësuesit e institucioneve fetare zyrtare (57%). Vlen të përmendet fakti se personalitetet politike ose përfaqësuesit e shtetit kanë numrin më të ulët të përgjigjeve (23% janë dakord).

Shumica e të anketuarve (57%) ose janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën "përfaqësuesit e institucioneve zyrtare fetare janë aktorë të besueshëm për ofrimin e mesazheve kundër radikalizimit". Vetëm 17% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën. Shumica e të anketuarve (63%) ose janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën "agjentët kulturorë (akademikët, artistët, udhëheqësit komunitarë dhe qytetarët aktivë) janë aktorë të besueshëm për ofrimin e mesazheve kundër radikalizimit". Vetëm 13% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë. Shumica e të anketuarve (65%) ose janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën "njerëzit me popullaritet të lartë janë aktorë të besueshëm për ofrimin e mesazheve kundër radikalizimit". Vetëm 16% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën.

Mënyrat më të përshtatshme për përcjelljen e mesazheve pozitive janë identifikuar fushatat e ndërgjegjësimit (82% janë dakord ose plotësisht dakord), ligjëratat fetare (80% janë dakord ose plotësisht dakord), mediat sociale (58% janë dakord ose plotësisht dakord) dhe masmedia (50% janë dakord ose plotësisht dakord).¹⁵⁰


¹⁵⁰ "Masmedia është platformë; e besueshme dhe e efektshme e informimit"

"Ligjëratat fetare kanë një ndikim pozitiv për besimtarët e komuniteteve të tyre"

"Mediat sociale janë platforma më të efektshme informimi krahasuar me masmedian për të dërguar mesazhet e tolerances dhe bashkëjetesës"

"Fushatat ndërgjegjëse mund të kenë ndikim të suksesshëm për promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës"


Aktorët më të besueshëm për të përcjellë mesazhet P/LKEDH



Grafiku 57 - Deri në çfarë mase jeni dakord me secilën deklaratë?

Të anketuarit u pyetën në çfarë mase ishin dakord me secilën deklaratë. Gjysma e të anketuarve ose janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën "masmediat janë një platformë e besueshme dhe efektive e informimit." Sidoqoftë, një në pesë të anketuar ose nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën. Shumica dërrmuese e të anketuarve (80%) ose janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën "ligjëratat fetare kanë një ndikim pozitiv për besimtarët e komuniteteve të tyre." Një përqindje e vogël prej 5% ose nuk është dakord ose nuk është aspak dakord me deklaratën. Një në dhjetë të anketuar me arsim të lartë nuk është aspak dakord me deklaratën. Shumica e të anketuarve (58%) ose janë dakord ose aspak dakord me deklaratën "media sociale është një platformë më e efektshme e informacionit në krahasim me masmedian për përcjelljen e mesazheve të tolerancës dhe bashkëjetesës." 16% e të anketuarve ose nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë deklaratë. Shumica dërrmuese e të anketuarve (82%) ose janë dakord ose plotësisht dakord me deklaratën "fushatat e ndërgjegjësimit mund të kenë një ndikim të suksesshëm në promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës." Vetëm 4% e të anketuarve nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratën.

Opinioni rreth mënyrave për të përcjellë mesazhet dhe narrativat



Grafiku 58 - Mënyrat më të përshtatshme për të komunikuar mesazhet pozitive

Spektri i Audiencës në Shqipëri

Sipas Ingram-it,¹⁵¹ në mënyrë që të nxirret një qasje strategjike për të parandaluar dhe kundërshtuar propagandën e ekstremizmit të dhunshëm, është e rëndësishme që së pari të njihet **logjika strategjike që e mundëson këtë përmbajtje** si dhe **audiencat te të cilat do të përcillet**.

Siç u përmend në seksionin e mësipërm: Lufta ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe propagandës së tij, Ingram mendon se mënyra e saktë për të sfiduar "sistemin e të kuptuarit" ekstremist është të sulmohen ndërlidhjet që ndihmojnë ciklin e tyre vetë-përforsues, duke përdorur një strategji me dy nivele. Prandaj, ky seksion do të eksplorojë spektrin e audiencave duke nxjerrë përfundime nga pikat kryesore të analizës së studimit.

Sa i përket spektrit të audiencës, Ingram thekson nevojën për të adresuar spektrin e plotë të audiencave të shënjestruara që mund të jenë të cenueshme nga propaganda e dhunshme ekstremiste, ose që mund të jenë të dobishme për t'iu kundërvënë asaj. Siç u përshkrua më herët në këtë raport, Ingram i ndan audiencat e shënjestruara në pesë kategori:

1. **Kundërshtarët:** ata që janë kundër grupeve të ekstremizmit të dhunshëm;
2. **Kureshtarët:** ata që konsumojnë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm;
3. **Të angazhuarit:** ata që besojnë "sistemin e të kuptuarit" të grupeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe/ose që janë të angazhuar me rrjetet e ekstremistëve të dhunshëm;
4. **Mbështetësit e heshtur:** ata që shprehin mbështetje për grupet e ekstremizmit të dhunshëm, shpërndajnë mesazhet e tyre dhe rregullisht angazhohen me këto rrjete; dhe
5. **Mbështetësit aktivë:** ata që planifikojnë ose që janë përfshirë në veprime, duke përfshirë ato të dhunshme, për të mbështetur grupet e ekstremizmit të dhunshëm.¹⁵²

Bazuar në analizën e të dhënave të sondazhit, pikat kryesore të mëposhtme mund t'i shërbejnë studimit për të identifikuar me afërsi ndarjen e audiencave në Bashkinë e Tiranës bazuar në kategoritë e Ingram-it. Figura 5 tregon shpërndarjen e audiencave të shënjestruara në përqindje, të nxjerra në bazë të rezultateve të sondazhit.

Spektri i audiencave të shënjestruara, të ndara si më poshtë, është i natyrës hulumtuese bazuar në të dhënat e gjeneruara nga analiza e studimit. Sidoqoftë, këto përqindje nuk janë eksploruar më tej, por gjithsesi ato përmbajnë elemente që ia vlen të merren parasysh.

¹⁵¹ Ingram, H., 2016. A "Linkage- Based" Approach to Combating Militant Islamist Propaganda: A Two-Tiered Framework for Practitioners. *International Centre for Counter-Terrorism*.

¹⁵² Po aty.

Bazuar në analizën e të dhënave të sondazhit, pikat kryesore të mëposhtme mund t'i shërbejnë studimit për të identifikuar përfaqësuesit ndarjen e audiencave në Bashkinë e Tiranës bazuar në kategoritë e Ingram-it. Disa pyetje në pyetësonin e sondazhit u hartuan si të tilla me synim që të kuptohej numri i njerëzve që mbështesin plotësisht grupet e EDH, grupi i shënjestruar i quajtur "mbështetësit aktivë." Këto pyetje përfshinin elementë të tillë si mbështetja e plotë për EDH, përdorimi i dhunës për të mbështetur kauzën e tyre, mbështetja për ISIS-in, etj. Nga të dhënat e sondazhit përqindja e të anketuarve që mbështesin këto elemente shkon nga 2.5% në 3.8%.

Mbështetësit aktivë

- 2.5% e të anketuarve nuk janë aspak dakord me idenë për të ndaluar plotësisht grupet e radikalizuara, gjë që mund të jetë një tregues përfaqësues për mbështetjen për këto grupe.
- 3.8% e të anketuarve besojnë se është detyrimi i të gjithëve të luftojnë për fenë e tyre, midis tyre edhe përfshirjen në veprime të dhunshme nëse është e nevojshme, për të mbrojtur bindjet e tyre fetare. Në mënyrë të ngjashme, 4.2% priren të mendojnë se janë të gatshëm të justifikojnë dhe të përdorin dhunën për të mbrojtur bindjet e tyre fetare.
- 3.5% e të anketuarve janë plotësisht dakord që një besimtar i vërtetë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tyre që kanë pikëpamje ekstremiste të dhunshme.
- 3.1% e të anketuarve janë plotësisht dakord se në komunitetin e tyre ka besimtarë radikalë që ushtrojnë ndikim të njerëzimit të tjerë për t'u bashkuar me kauzat e tyre ekstreme.
